

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**I N F O R M A T Ë  
PËR PUNËN E BORDIT TË DREJTORËVE  
PËR VITIN 2007**

**PRISHTINË, maj 2008**

# P Ë R M B A J T J A

## I. RAPORTI VJETOR I BORDIT TË DREJTORËVE PËR VITIN 2007

### H y r j e

#### KRYESHEFI DHE ZËVENDËSKRYESHEFI I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS

|                                                                 |    |
|-----------------------------------------------------------------|----|
| Integrimet evropiane.....                                       | 7  |
| Zyra ligjore .....                                              | 9  |
| Departamenti i prokurimit .....                                 | 9  |
| Zyra pritëse .....                                              | 10 |
| Zyra për marrëdhënie me publikun.....                           | 13 |
| Zyrtarja për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta.....      | 14 |
| Zyrtari për kthim.....                                          | 14 |
| Auditori i brendshëm.....                                       | 15 |
| Zyra për teknologji informative .....                           | 16 |
| <br>1. DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME               |    |
| Spektori i punëve juridike dhe të përgjithshme .....            | 17 |
| Spektori për punë të Kuvendit dhe të Bordit të drejtorëve ..... | 20 |
| Spektori teknik .....                                           | 21 |
| Spektori i bashkësive lokale .....                              | 21 |
| Spektori i gjendjes civile .....                                | 22 |
| <br>2. DREJTORATI I EKONOMISË                                   |    |
| Spektori i biznesit dhe i planifikimit.....                     | 23 |
| <br>3. DREJTORATI I FINANCAVE DHE PRONËS                        |    |
| Spektori i buxhetit .....                                       | 25 |
| Spektori i pronës .....                                         | 26 |
| Spektori i taksës në pronë.....                                 | 29 |
| <br>4. DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE         |    |
| Spektori i shëndetësisë.....                                    | 30 |
| Spektori i mirëqenies sociale.....                              | 31 |
| <br>5. DREJTORATI I ARSIMIT DHE SHKENCËS .....                  | 32 |
| <br>6. DREJTORATI I KULTURËS DHE GJINISË.....                   | 38 |
| <br>7. DREJTORATI I RINISË DHE SPORTIT                          |    |
| Spektori i sportit.....                                         | 42 |
| Spektori i rinisë.....                                          | 43 |

|                                                                                                                                                                                                                  |       |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 8. DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE NDËRTIMTARISË                                                                                                                                                       |       |
| Sektori i planifikimit .....                                                                                                                                                                                     | 44    |
| Sektori i urbanizmit.....                                                                                                                                                                                        | 46    |
| Sektori i ndërtimit.....                                                                                                                                                                                         | 47    |
| 9. DREJTORATI I INSPEKSIONIT                                                                                                                                                                                     |       |
| Sektori i inspektionit të tregut, Sektori i inspektionit sanitar, Sektori i inspektionit komunal dhe i komunikacionit, Sektori i inspektionit të bujqësisë dhe mbrojtjes së ambientit , Sektori i ndërtimit..... | 51    |
| 10. DREJTORATI I ZHVILLIMIT RURAL.....                                                                                                                                                                           | 54    |
| 11. DREJTORATI I KADASTRIT DHE GJEODEZISË.....                                                                                                                                                                   | 55    |
| 12. DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT MBROJTJËS SË AMBIENTIT DHE TOKËS NDËRTIMORE                                                                                                                     |       |
| Shërbimi juridik .....                                                                                                                                                                                           | 59    |
| Sektori i shërbimeve publike .....                                                                                                                                                                               | 59    |
| Sektori i tokës ndërtimore .....                                                                                                                                                                                 | 63    |
| Sektori i transportit dhe mbrojtjes së ambientit .....                                                                                                                                                           | 67    |
| 13. DREJTORATI I SIGURISË DHE EMERGJENCËS                                                                                                                                                                        |       |
| Sektori i mbrojtjes civile.....                                                                                                                                                                                  | 60-62 |
| Sektori i emergjencës .....                                                                                                                                                                                      | 63-64 |
| 14. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE.....                                                                                                                                                                            | 75    |
| II. PASQYRA E REALIZIMIT TË BUXHETIT .....                                                                                                                                                                       | 81    |
| ANALIZA EKONOMIKE E BUXHETIT.....                                                                                                                                                                                | 82    |
| Pagesat dhe mëditjet                                                                                                                                                                                             |       |
| Mallrat dhe shërbimet                                                                                                                                                                                            |       |
| Shpenzimet komunale                                                                                                                                                                                              |       |
| Subvencionet dhe transferet                                                                                                                                                                                      |       |
| Arkëtimi dhe shpenzimet e të hyrave vetanake komunale                                                                                                                                                            |       |
| III.SHTOJCË                                                                                                                                                                                                      |       |
| Realizimi i buxhetit për vitin 2007                                                                                                                                                                              |       |

## **H Y R J E**

Në bazë të dispozitave të nenit 42, pika 42.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45, për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, të dispozitave të nenit 70, shkronja \_ të Statutit të Komunës, të dt. 31.3.2008, të shqyrtimit të Raportit të Bordit të Drejtorëve të përbërjes së kaluar për vitin 2007, Këshilli i Drejtorëve, më \_\_\_\_\_, propozoi që të njëjtin t'ia përcjellë Kuvendit të Komunës për miratim .

### **Bordi i drejtorëve**

Bordi i drejtorëve ka ushtruar pushtetin ekzekutiv, duke zbatuar kompetencat e tij të përcaktuara me Statutin e Komunës, rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, e të fuqizuara me nënshkrimin e tyre nga ana e PSSP-së.

Skema organizative e organeve të Administratës është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 14. 2. 2007, Vendimi 01. nr. 400 - 65, në pajtim me dispozitat e Statutit të Komunës së Prishtinës të dt. 16.3.2001. Në bazë të skemes është bërë organizimi i detyrave dhe punëve për vitin 2007. Në përberje të Bordit të drejtorëve ishin: kryeshefi i Ekzekutivit, zëvendskryeshefi i Ekzekutivit, drejtorët e 13 drejtorive, udhëheqësi i Zyrës për Komunitete në Graçanicë. Bordi i drejtorëve përmes punës së tij, ka siguruar që edhe institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjet komunale: "Trafiku Urban", "Hortikultura" dhe "Sport-Marketingu", të qeverisen në mënyrë efikase në të gjitha sferat.

Puna e kryeshefit dhe e zëvendeskryeshefit të Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës është orientuar në:

- kujdesin për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit,
- dhënien e ndihmës kryetarit dhe zëvendëskryetarit,
- zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve të miratuara nga Kuvendi,
- iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve komunale dhe vendimeve me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës,
- ngritjen e nivelit në punë, me qëllim të arritjes së efikasitetit sa më të mirë në punë,
- ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike, në pjesën urbane dhe në viset rurale,
- iniciimin e procedurës për miratimin e planeve-projekteve: planet detale rregulluese, projektet në lëmin e kulturës, të gjinisë, të rinisë dhe të sportit, miratimin e rregullativës, në mënyrë që ndërmarrjet komunale të kenë mbarëvajtje në punë në fushat që janë në kompetencë të tyre,
- kujdesin për ligjshmërinë e punëve të organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore, ligjshmërinë e çështjeve financiare të Komunës,
- lëshimin e urdhërësave administrative, me të cilat janë rregulluar fushëveprimet e disa organeve (kufizimi i përdorimit të sasisë së ujit, vendosja e stendave në hapësira publike, ndalimi i keqpërdorimit të sipërfaqeve të gjelbëruara, ndalimi i

- përdorimit të mjeteve ndezëse, nga të cilat do të mund të shkaktohej zjarri në sipërfaqet e pyllëzuara),
- ngritjen e transparencës në Komunë, që është arritur përmes futjes së të dhënave në “Web-faqen” e Komunës, përgatitjet e bëra për botimin e Raportit të punës për vitin 2006, botimin e fletëshpalosjeve për qytetarët e Prishtinës – taksa në pronë dhe Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale,
  - pjesëmarrjen aktive në takimet e organizura për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga planet e veprimit për integrimet evropiane dhe
  - pjesëmarrjen në kolegjiun e kryeshefave të ekzekutiveve të komunave në një rol të rëndësishëm dhe duke marrë pjesë aktive, në mënyrë që të kenë qasje në të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen komunat,
  - ngritjen e realizimit të të hyrave vetanake etj.

Gjatë periudhës raportuese, rol i rëndësishëm i është kushtuar edhe obligimeve që ka pasur Komuna me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe atyre në nivel lokal, të mbajtura më 17 nëntor 2007.

Gjatë tërë vitit, përparësi u është dhënë këtyre veprimeve:

1. Në krijimin e politikave:

- ndihmës së ofruar Grupit punues për hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të Komunës për periudhën 2007-2011,
- kompletimit të planeve rregulluese dhe inicimit të hartimit të planeve të reja detale rregulluese,
- ndërtimeve ilegale,
- planifikimit të infrastrukturës dhe realizimit të këtij planifikimi,
- përkujdesejs parësore shëndetësore,
- mbrojtjes së konsumatorëve dhe të shëndetit publik,
- parandalimit dhe luftimit të diskriminimit,
- ngritjes së nivelit të të hyrave vetanake,
- sigurimit të donacioneve për realizim të projekteve, të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të burimeve publike, duke përcaktuar edhe rregullat që do të zbatohen dhe
- qasjes në dokumentet zyrtare.

2. Në procesin e vendimmarrjes:

- caktimit e saktë të kompetencave të Komunës dhe drejtorive mes tyre,
- sigurimit të transparencës dhe
- aftësisë të kapaciteteve njerëzore, sidomos të kuadrit profesional menaxhues.

3. Në lëmin e transparencës:

- mbajtjes së takimeve me media,
- shpërndarjes së të dhënave përmes “Web-faqes”, publikimit të Raportit të punës dhe fletëshpalosjeve për banoret e komunës së Prishtinës dhe
- debateve publike me qytetarë të komunës së Prishtinës, të organizuara nga niveli komunal në objektet e Komunës dhe të bashkësive lokale.

4. Në ngritjen e kapaciteteve funksionale:

- levizshmërisë së të punësuarëve në bazë të kërkesave të drejtorëve të drejtorive, duke pasur parasysh se duhet zbatuar me përpikëri Udhëzimin administrative nr. 2006/08 për ngrirjen e posteve në Shërbimin Civil,
- aftësimin profesional përmes trajnimeve dhe
- ngritjes së postit.

5. Në procesin e integritimeve evropiane:

- Përmbylljes së detyrave dhe përgjegjësi që kanë të bëjnë me realizimin e Planit të veprimit për integritime evropiane, të cilat i janë shtruar si nevojë Komunës së Prishtinës nga organet e Qeverisë së Kosovës apo subjektet tjere.

Vlen të theksohet se gjatë avancimit të çështjeve të mësipërme, janë paraqitur vështirësi, siç janë:

- paqartësitë e përgjegjësi (kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal), prezente edhe sot,
- problemet financiare,
- kapacitetet njerëzore,
- kushtet e punës,
- besueshmëria e ulët e mediave,
- niveli i ultë i bashkëpunimit me shoqërinë civile,
- zhvillimet demografike dhe
- vetëdija e pamjaftueshme e rëndësisë së pjesëmarrjes në vendimmarrje nga ana e qytetarëve.

Të arriturat e kryeshefit dhe të zëvendskryeshefit të Ekzekutivit, janë bërë me një përkushtim dhe bashkëpunim me nëpunësit e Shërbimit Civil, organet e Administratës, Zyrën komunale në Graçanicë, Avokaturën Publike, institucionet arsimore dhe shëndetësore, komitetet obliguese dhe joobliguese si trupa të Kuvendit, pjesën politike të Komunës, ndërmarrjet publike komunale që qeverisen nga Komuna, IPVQ-të, OJQ-të, përfaqësues të SHPK-së, të UNMIK-ut, të KFOR-it dhe të AKM-së.

Ky raport pasqyron punën dhe aktivitetin e të cituarve më lart, ku theksohen veprimet dhe angazhimet konkrete të drejtorëve, të drejtorive, gjegjësisht sektorëve – zyrave.

## **INTEGRIMET EVROPIANE**

Plani i veprimit për integritime evropiane për Kosovën, ka qenë dhe do të mbetet prioritet në angazhimin e Bordit të drejtorëve, si dhe i angazhimit të drejtpërdrejtë të grupeve të caktuara, apo që do të caktohen për implementimin e tyre.

Gjatë viti 2007, ndaras nga angazhimet rreth përmbylljes së detyrave të përcaktuara me planin e veprimit, zbatimi i planit të veprimit ka qenë një nga prioritet kryesorë në agjendën e tij.

Komuna ka formuar Grupin punues për implementimin e Planit të veprimit dhe gjatë punës ai ka punuar edhe me nëngrupet e caktuara të shërbyesve civilë të Komunës. Për punën e vet grupi ka bashkëpunuar, ka raportuar dhe ka qenë përgjegjës për detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara.

Katër vite pas, në komunë ka të kthyer, është përmirësuar dukshëm liria e lëvizjes, nuk ka pasur ekcese në baza nacionale. Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të rregulloreve në fuqi, të cilat janë të harmonizuara me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

### **Institucionet demokratike komunale**

Në institucionet komunale janë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në territorin e komunës së Prishtinës. Janë të përfaqësuara në mënyrë proporcionale në Kuvend dhe në trupat ndihmëse të Kuvendit – në komitete. Me përpjekje të udhëheqjes komunale, është arritur që edhe këtë vit komuniteti serb të marrë pjesë aktive në Komitetin për Komunitete dhe në Komitetin për Ndërmjetësim.

- Gjuhët zyrtare, respektohen në të gjitha organet, institucionet dhe ndërmarrjet e Komunës.
- Shërbimi civil është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, i përfaqësuar nga të gjitha komunitetet në komunën e Prishtinës, përfshirë këtu numër të theksuar të gjinisë femërore.
- Të gjitha komunitetet kanë qasje të drejtë në punësim në organet komunale dhe institucionet publike komunale.
- Propozimvendimet dhe rregulloret e Kuvendit të Komunës shqyrtohen nga komitetet përkatëse dhe organizmat tjerë para se të miratohen në Kuvend.
- Është duke u bërë përpjekje për zhbërjen e strukturave paralele, duke i siguruar komunitetit serb shërbimet e nevojshme në : administratë, arsim, shëndetësi, transport etj.

### **Sundimi i ligjit**

Ligji dhe të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, zbatohen njësoj ndaj të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore etj..

### **Liria e lëvizjes**

Liria e lëvizjes është në nivelin e duhur. Të gjithë qytetarët e komunës së Prishtinës janë të lirë të udhëtojnë, të punojnë dhe të jetojnë të sigurtë, të pafrikësuar prej ndonjë sulmi apo keqtrajtimi, pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre.

Të gjithë qytetarët janë të lirë të përdorin gjuhën e tyre, përfshirë këtu edhe vendet publike, dhe është e sigurtë liria e lëvizjes së tyre. Ata shkojnë pa pengesë në vendet e tyre të punës, në shkollë, në tregje, kryejnë shërbimet publike sociale dhe shërbimet komunale.

Në komunën e Prishtinës përcjellja e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë nga policia është e panevojshme. Gjithashtu, ata e kanë të siguruar transportin publik. Punonjësit publikë, pjesëtarët e komunitetit joshumicë të punësuar në organet e Komunës së

Prishtinës, janë në gjendje të punojnë bashkë me pjesëtarët e komunitetit shumicë pa ndonjë vështirësi.

Numri i incidenteve që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes së pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Prishtinës, viteve të fundit është shumë i rrallë, apo nuk ekziston fare.

Udhëheqësit komunalë pa hezitim do t'i dënojnë aktet eventuale të dhunës ndaj pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Komuna ka siguruar shërbime përkatëse të përkthimit për të gjitha bashkësitë, duke përfshirë përkthimin e dokumenteve zyrtare, si dhe përkthimin simultan në gjuhët përkatëse gjatë mbledhjeve zyrtare. Kjo është bërë nga Shërbimi i përkthimeve i Drejtoratisë së Administratës së Përgjithshme.

### **Kthimi i qëndrueshëm dhe të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre**

Të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit, të cilët dëshirojnë të kthehen në pronat e tyre në territorin e komunës së Prishtinës, do të jenë të papenguar për t'u kthyer dhe këtë mund ta bëjnë pa problem.

Në Komunë ekzistojnë mekanizma përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, si: zyrtarët komunalë, Zyra komunale për komunitete në Graçanicë dhe komitetet e Kuvendit të Komunës.

Është bërë shpërndarje e drejtë e resurseve komunale për të gjitha komunitetet.

### **Ekonomia**

Të hyrat nga tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale janë duke e mbushur buxhetin e Komunës. Arkëtimi i tyre nga Komuna është duke u bërë pa ndikim politik, duke u bazuar vetëm në Rregulloret e licencuara nga Komisioni miks MEF – MAPL.

### **Të drejtat pronësore**

Zbatimi i drejtë i të drejtave pronësore është synimi i përhershëm i Komunës për të inkurajuar kthimin, dhe për të siguruar trajtim të barabartë të bashkësive etnike. Është krijuar dhe funksionon regjistri i të drejtave pronësore.

### **Trashëgimia kulturore**

Trashëgimia kulturore respektohet si trashëgim i të gjitha bashkësive etnike, fetare dhe gjuhësore të qytetarëve të saj.

Të gjitha bashkësitë kanë të dejtë ta ruajnë dhe t'i mbrojnë vendet që janë të rëndësishme për trashëgimin e tyre kulturore, historike dhe fetare, me ndihmën e autoriteteve komunale, në pajtim me standardet evropiane.

### **Bashkëpunimi**

Duhet theksuar se Komuna vazhdimisht ka bashkëpunuar me nivelin qendror, sidomos me Ministrinë e Shërbimeve Publike, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe organet qëndrore, obligim ky i përhershëm për ne.

## **ZYRA LIGJORE**

Gjatë periudhës raportuese, Zyra ligjore ka vazhduar me:

- dhënien e këshillave, shërbimeve për sektorë - zyra, drejtori, institucione komunale, trupat e Kuvendit dhe Kuvndin e Komunës;
- shqyrtimin e të gjitha projektpropozimeve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve për miratim në Kuvend;
- shqyrtimin dhe përpilimin e vendimeve lidhur me ankesat e drejtuara kryeshefit të Ekzekutivit nga ana e personave fizikë dhe juridikë;
- përpilimin e urdhëresave administrative që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve të organeve administrative, institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- përfaqësuesin e saj që ka marrë pjesë aktive në grupin për ndryshime dhe plotësime të Statutit të komunave, në kuadër të MAPL-së dhe OSCE-së. Në Grupin Punues për Integritet Evropian, shefi i saj ka kryesuar kolegjiun e zyrtarëve ligjor, i krijuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- hartimin e Raportit të punës për vitin 2006, pjesëmarrje në botimin e fletëshpalosjeve për qytetarët e Komunës së Prishtinës – tatimi në pronë dhe Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale etj.

## **DEPARTAMENTI I PROKURIMIT**

Gjatë vitit në raportim, Departamenti i prokurimit ka zhvilluar 290 aktiviteti të prokurimit, për dallim nga viti paraprak që ka pasur 200 aktivitete, në shumën e përgjithshme prej 15 075 475, 21 €, duke i përfshirë këto procedura:

1. Kontrata për punë – procedurë e hapur;
2. Kontrata për punë – procedurë e kufizuar;
3. Kontrata për furnizim – procedurë e hapur;
4. Kontrata për furnizim – kuotim i çmimeve;
5. Kontrata për shërbime – procedurë e hapur;
6. Kontrata për shërbime – kuotim i çmimeve;
7. Kontrata për mallra – vlera minimale dhe
8. Kontrata për shërbime – vlera minimale.



Në procedurë të hapur janë menaxhuar rreth 94 % të mjeteve, në procedurë të negociuar 3% dhe me kuotim të çmimeve 3 %.

Nga 290 aktivitetet e lartcekura vetëm në një rast, një shoqëri tregtare ka ushtruar ankesë përmes KRPP-së. Ankesa nga organi kompetent për shqyrtimin e ankesave, është vlerësuar si e pa bazë.

## **ZYRA PRITËSE**

Pasqyra tabelare e numrit të kërkesave, mënyra e zgjidhjes së tyre dhe numri i lëndëve që janë në procedurë.

| DREJTORATET                                        | Pranuara     | Refuzuar   | Miratuar     | Hedhura<br>poshtë | Kushte<br>Urbanistik | Njoftim     | Informim   | Përgjigje | Leje<br>ndërtimi | Konkluzë  | Pakryera    |
|----------------------------------------------------|--------------|------------|--------------|-------------------|----------------------|-------------|------------|-----------|------------------|-----------|-------------|
| <b>1.Administrata</b>                              | <b>1630</b>  | <b>19</b>  | <b>1557</b>  | <b>19</b>         | -                    | -           | <b>1</b>   | -         | -                | -         | <b>34</b>   |
| - Kuvendi                                          | 31           | -          | 1            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 30          |
| - Kryetari                                         | 99           | -          | 2            | -                 | -                    | 2           | 1          | -         | -                | -         | 94          |
| - Kryesia                                          | 3            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 3           |
| - Ekzekutivi                                       | 177          | 43         | 10           | -                 | -                    | 10          | 1          | -         | -                | 1         | 112         |
| - Avokatura<br>komunale                            | 2            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 2           |
| - Depart. i<br>prokurimit                          | 164          | 4          | 157          | 1                 | -                    | 1           | -          | -         | -                | -         | 1           |
| - Zyra për<br>marrëdh. me<br>publikun              | -            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | -           |
| - Zyra legale                                      | 2            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 2           |
| - Zyra për<br>kthim                                | 7            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 7           |
| - UNMIK-u                                          | 1            | -          | -            | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | 1           |
| <b>2. Ekonomi</b>                                  | <b>1910</b>  | <b>131</b> | <b>1299</b>  | -                 | -                    | <b>1</b>    | -          | -         | -                | -         | <b>479</b>  |
| <b>3. Shëndëtsi dhe<br/>Mirëqenje Sociale</b>      | <b>410</b>   | <b>38</b>  | <b>219</b>   | -                 | -                    | <b>117</b>  | -          | <b>15</b> | -                | -         | <b>21</b>   |
| <b>4. Zhvillim Rural</b>                           | <b>45</b>    | <b>5</b>   | <b>7</b>     | -                 | -                    | <b>30</b>   | <b>3</b>   | -         | -                | -         | -           |
| <b>5. Planifikim<br/>Urbanizëm dhe<br/>Ndërtim</b> | <b>818</b>   | <b>176</b> | <b>101</b>   | <b>6</b>          | <b>91</b>            | <b>45</b>   | <b>211</b> | -         | <b>59</b>        | <b>9</b>  | <b>120</b>  |
| <b>6. Arsime dhe Shkencë</b>                       | <b>446</b>   | <b>147</b> | <b>160</b>   | -                 | -                    | <b>106</b>  | <b>23</b>  | <b>8</b>  | -                | -         | <b>2</b>    |
| <b>7. Kulturë dhe Gjini</b>                        | <b>161</b>   | <b>40</b>  | <b>116</b>   | -                 | -                    | -           | -          | -         | -                | -         | <b>5</b>    |
| <b>8. Mbrojtje Civile dhe<br/>Emerg.</b>           | <b>90</b>    | -          | <b>86</b>    | -                 | -                    | <b>1</b>    | -          | -         | -                | -         | <b>3</b>    |
| <b>9. Inspektion</b>                               | <b>3179</b>  | <b>2</b>   | <b>2637</b>  | <b>5</b>          | -                    | <b>318</b>  | <b>11</b>  | <b>12</b> | -                | -         | <b>194</b>  |
| <b>10. Financa dhe Pronë</b>                       | <b>13367</b> | <b>199</b> | <b>13137</b> | <b>25</b>         | -                    | <b>5</b>    | -          | <b>1</b>  | -                | -         | -           |
| <b>11. Kadastër dhe<br/>Gjeodezi</b>               | <b>4759</b>  | <b>5</b>   | <b>4742</b>  | <b>11</b>         | -                    | <b>1</b>    | -          | -         | -                | -         | -           |
| <b>12. Shërbime Publike</b>                        | <b>706</b>   | <b>24</b>  | <b>229</b>   | <b>1</b>          | -                    | <b>379</b>  | <b>7</b>   | -         | -                | -         | <b>66</b>   |
| <b>13. Sport dhe Rini</b>                          | <b>88</b>    | <b>4</b>   | <b>24</b>    | -                 | -                    | <b>1</b>    | -          | -         | -                | -         | <b>59</b>   |
| <b>Gjithsej :</b>                                  | <b>28099</b> | <b>837</b> | <b>24485</b> | <b>68</b>         | <b>91</b>            | <b>1017</b> | <b>258</b> | <b>36</b> | <b>59</b>        | <b>10</b> | <b>1238</b> |



Në bazë të kërkesave të pranuar gjatë vitit 2007, Zyra pritëse ka lëshuar - regjistruar :

|                                                             |      |
|-------------------------------------------------------------|------|
| ▪ Vërtetime për mbajtës familjeje dhe ndihmë juridike ..... | 959  |
| ▪ Libri i ekspedicionit në vend .....                       | 1694 |
| ▪ Libri i dorëzimit të postës personalisht .....            | 1492 |
| ▪ Libri i faturave hyrëse .....                             | 1398 |
| ▪ Libri i Protokollit (konkurse, DZ, etj) .....             | 2148 |
| ▪ Qasje mbi dokumente zyrtare (kërkesa) .....               | 51   |

---

Gjithsej = 7742

### **Zyra për marrëdhënie me publikun**

Zyra për marrëdhënie me publikun e njësisë monitoruese të kryeshefit të Ekzekutivit, gjatë periudhës janar - dhjetor 2007, ka pasur këtë aktivitet:

- Takime ditore me shtëpi mediash, të cilat rregullisht raportojnë për aktivitetet e Komunës;
- Plotësimin e “Web-faqes”;
- Distribimin e informatave për mediat – për vendimet e marra, lajmet, ftesat, reagimet dhe kumtesat për opinion, shpalljen e pozicioneve të ndryshme përmes “Web-faqes” zyrtare të Komunës, [www.prishtina-komuna.org](http://www.prishtina-komuna.org);
- Organizmin e konferencave për media ( elektronike dhe të shkruara), së bashku me kryeshefin e Ekzekutivit, drejtorët e drejtorive dhe zyrtarë të tjerë etj.;
- Përcjelljen e takimeve protokollare të kryetarit, të zëvendëskryetarit të Kuvendit të Komunës dhe të mbledhjeve të Bordit të drejtorëve, të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të mbledhjeve të Kuvendit;
- Përcjelljen e përhershme të shtypit ditor, duke veçuar tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për Komunën e Prishtinës. Puna dhe mos puna e organeve të Komunës dhe, në të njëjtën kohë, informon përgjegjësit e atakuar në shkrime dhe, në marrëveshje me ta, lëshon reagime dhe sqarime;
- Reagimin me kohë ndaj të gjitha atyre shkrimeve, në të cilat shtrembërohet e vërteta dhe deklaratat e zyrtarëve komunalë;
- Bashkëpunimi me të punësuarit në Shërbimin Civil;
- Ndihmë në publikimin e Raportit të punës së Bordit të drejtorëve, të fletëshpalosjeve – taksa në pronë dhe Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale.

Transparenca e Komunës së Prishtinës me qytetarët e saj është e kënaqshme, por analizat e bëra deri më tani tregojnë se duhet të përmirësohet qasja e saj në shpërndarjen e të dhënave, krahas metodave tjera që ka siguruar Komuna për transparencë: “Web – faqja”, gjatë vitit 2007 Zyra për marrëdhënie me publikun ka bërë publikimin e fletëshpalosjeve që kanë të bëjnë me taksën në pronë dhe taksat, ngarkesat dhe gjopat komunale.

Komuna ka një “Plani masash” për forcimin e transparencës në Komunë, e që publikut do t’i mundësojë monitorimin publik të pajtushemërisë me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë ndër të tjera legjislacionin për financat publike dhe përgjegjësitë, prokurorimin, shërbimin civil, qasjen në dokumentet zyrtare, Ligjin mbi ndërtimet, Ligjin për planifikimin hapësinor etj..

## **Zyrtarja për çështje gjinore dhe mundësi të barabarata**

Zyrtarja për çështje gjinore dhe mundësi të barabarta, gjatë vitit 2007, përmes strategjisë së miratuar për vitin 2007, i ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet për një respektim dhe zbatim të plotë të të drejtave të njeriut, për të gjitha kategoritë e qytetarëve të komunës, pa dallim gjinie, përkatësie fetare etj., përmes:

- hulumtimit, grumbullimit të të dhënave për problemet me të cilat ballafaqohen,
- statistikave të të punësuarve, në aspektin gjinor: Shërbimi Civil komunal, Arsimi, Shëndetësia,
- rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna për krijimin e kushteve të barabarta për punësim dhe përfaqësim institucional,
- takimeve me Agjencionin për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit,
- bashkëpunimit dhe kooperimit të ndërsjellë me Qendrën për Punë Sociale, policinë - Njësi për dhunë familjare, rreth shqyrtimit të rasteve,
- kontakteve me OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare rreth zbatimit të projekteve të ndryshme,
- pjesëmarrjes në seancat e Komisionit të ankesave,
- takimeve me përfaqësuesit e OSBE-së në fushën e bashkëpunimit dhe përkrahja në shumë projekte.

## **Zyrtari për kthim**

### **Aktiviteti i zyrtarit për kthim në vitin 2007:**

#### **- Takimet me përfaqësuesin e UNMIK-ut për Komunën e Prishtinës;**

Ne këto takime është raportuar mbi punën dhe aktivitetet javore të zyrtarëve të Zyrës komunale për kthime, është raportuar për punën e Zyrës së komuniteteve në Graçanicë: infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, çështjet ekonomike, sociale dhe sigurisë në mjediset shumetnike dhe çështjet e kthimit.

#### **- Takimet e Grupit komunal punues për kthimet;**

#### **- Takimet e zyrtarëve komunalë për kthime me zyrtarët e UNHCR-së;**

#### **- Takimet me Komitetin për Komunitete;**

#### **- Takimet e zyrtarëve për kthime me përfaqësues të organeve dhe organizatave të ndryshme;**

#### **- Vizitat familjeve të zhvendosura.**

Zyrtarët komunalë për kthime kanë vizituar familje të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

#### **- Vizitat e bëra familjeve të kthyera :**

Janë vizituar familjet e kthyera të komuniteteve të ndryshme.

- Nëngrupi punues për kthimin e të zhvendosurve në qytetin e Prishtinës dhe në pjesët rurale, në veri dhe në jug të Prishtinës.
- Nëngrupi punues për shqyrtimin dhe elaborimin e Draftstrategjisë komunale për kthim, si dhe shqyrtimin e propozimprojekteve të ndryshme.

### **Trajnimet**

Zyrtarët për kthime kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga UNHCR-ja dhe OSCE-ja, dhe në dy komitete të përbashkëta për koordinim.

### **Auditori i brendshëm**

Në pajtueshmëri me autoritetin dhe përgjegjësitë e auditorit të brendshëm, të përcaktuara në kornizat rregullative:

### **LIGJI Nr. 2003/2**

### **PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË**

### **Pjesa XI - Komunat**

### **Neni 55**

Zbatimi i këtij ligji në komuna.

### **RREGULLORJA nr. 2000/45, 11 gusht 2000,**

### **MBI VETËQEVERISJEN E KOMUNAVE TË KOSOVËS, KONTROLI I PAVARUR FINANCIAR**

### **STATUTI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Shtojca katër-faqe 4 ,

Procedurat financiare në lidhje me shërbimin publik të Komunës  
REVIZIONI FINANCIAR

### **KORNIZA PUNUESE PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE**

### **STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR PRAKTIKAT PROFESIONALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

### **Rregullorja nr. 2007/19, për auditin e brendshëm**

**Komisioni për audit dhe auditori i brendshëm, kanë ushtruar aktivitete auditimi me qëllim të:**

- ofrimit të sigurisë së arsyeshme të sistemit të kontrollit të brendshëm, të themeluar nga menaxhmenti, ka dhënë apo është duke dhënë rezultate në arritjen e objektivave të përgjithshme që konsistojnë me misionin e organizatës buxhetore,
- ofrimit të një mendimi mbi përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm,
- nxjerrjes së rekomandimeve praktike për t'u përmirësuar aty ku është e nevojshme,
- sigurimit për zbatimin e rekomandimeve të akorduara.

## **Auditimet e zbatuara**

**1**

**Nr. i auditimit 03/2006**

**Komuna e Prishtinës**

**Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë**

**-Sektorët:Planifikimi, Urbanizmi dhe Ndërtimtaria**

**2**

**Nr. i auditimit 01/2007**

**Komuna e Prishtinës**

**Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës**

**Menaxhimi i buxhetit, të hyrat dhe shpenzimet**

**3**

**Nr. i auditimit 02/2007**

**Komuna e Prishtinës**

**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**-Menaxhimi i të hyrave vetanake**

### **Trajnimi**

- Njohuritë audituese nga ofrues nderkombetarë;
- Perkrashja e mëtejme për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe auditimin e brendshëm.

## **ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE**

Zyra për teknologji informative, edhe gjatë vitit 2007 ka:

- udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe shpërndarjes së informimit mbi teknologjinë informative,
- mbikëqyrur planin për organizimin dhe funksionimin e sistemit të teknologjisë informative në Komunë,
- ndihmuar në aftësimin e personelit për punë në lëmin e teknologjisë informative,
- vënë kontakte me organizata dhe shoqata të ndryshme, me qëllim të këmbimit të informatave dhe zhvillimit sa më të mirë të teknologjisë informative në Komunë,
- zbatuar politikat e Zyrës për TI,
- bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet - intranet, shtrirjen e kablllove, kyçjen e tyre në kabinetet e "switch"-ve, dhe përcaktimi i porteve,
- kryer shërbime "softwerike" dhe "hardwerike", ndihma për shfrytëzuesit komunalë për zgjidhjen e problemeve.

## **I. DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**

Kryerja e detyrave dhe punëve është bazuar në Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe është kryer përmes:

- Sektorit të punëve të përgjithshme dhe juridike,
- Sektorit për punë të Kuvendit dhe të Bordit të drejtorëve,
- Sektorit teknik,
- Sektorit të bashkësive lokale dhe
- Sektorit të gjendjes civile.

### **Sektori i punëve të përgjithshme dhe juridike**

#### **a). Personeli**

Personeli i Administratës komunale është angazhuar në kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësi për shërbyesit civil, e që parashihen me dispozitat e Rregullores nr. 2001/36, për shërbimin civil në Kosovë, dispozitat e Urdhërësës administrative, nr. 2003/02, për implementimin e Rregullores nr. 2001/36 dhe dispozitat e udhëzimeve apo instruksioneve të cilat janë të miartuara nga Pushteti Qendror.

Shërbimi civil i Administratës komunale në vitin 2007, është përmbyllur me 721 të punësuar, që, krahasur me vitin paraprak, është për 10 të punësuar më pak. Zvogëlimi i numrit të të punësuarëve është bërë sipas këtyre bazave: 1 (një) të punësuar i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve ligjore – pensionimit, 4 (katër) punëtorëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për shërbyesit civilë, dhe 7 (shtatë) shërbyes civilë kanë bërë kërkesë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me vetëdëshirë, të cilat kërkesa janë miratuar. Personeli duke respektuar dispozitat e Urdhërësës administrative nr. 2006/8 të MSHP-së, nuk ka publikuar plotësimin e vendeve të reja të punës pasi që urdhëresa ndalon punësimin e shërbyesve të rinj civilë për organet e pushtetit lokal (postet e lejuara u takojnë ministrive).

Përkujtojmë se përkundër nënshkrimit të Kontratës kolektive dhe Anekskontratës nga: Qeveria, Oda Ekonomike dhe Sindikata, përveç pjesës që ka të bëjë me pushimin e lehonisë, e cila është e zbatueshme me Vendimin e Kryeministrit nr. 02/201, të dt. 31.5.2006 dhe Udhëzimit administrative nr. 2006/6 të MAPL-së për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të pagesës për pushimin e lehonave në Shërbimin Civil të Kosovës, pjesa tjetër e saj nuk është zbatuar as në periudhën për të cilën po raportohet. Personeli ka bashkëpunuar me drejtoritë, institucionet arsimore dhe ato shëndetësore, MAPL-në dhe MSHP-në përmes formave të ndryshëm të komunikimit.

Numri i të punësuarëve në organet e Administratës përmes tabelës së mëposhtme, pasqyron këtë gjendje: numrin e përgjithshëm, kualifikimet, strukturën etnike dhe strukturën gjinore, sipas drejtorive:

| Nr. | DREJTORITË                    | Nr.<br>i<br>pergj | Kualifikimet |             |           |           | Struktura etnike |      |      |         | Struktura gjinore |    |
|-----|-------------------------------|-------------------|--------------|-------------|-----------|-----------|------------------|------|------|---------|-------------------|----|
|     |                               |                   | Fak.         | Shk e lartë | Shk. mes. | Stafi mbë | Shqiptar         | Serb | Turq | Tetjerë | M                 | F  |
| 1.  | Drejtoria e Administratës     | 138               | 16           | 10          | 92        | 20        | 129              | 2    | 6    | 2       | 105               | 33 |
| 2.  | Drejtoria e Inspeksionit      | 64                | 29           | 3           | 32        | -         | 63               | -    | -    | 1       | 46                | 18 |
| 3.  | Drejtoria e Fin. dhe Pronës   | 58                | 10           | 7           | 40        | 1         | 51               | 6    | 1    | -       | 39                | 19 |
| 4.  | Drejtoria e Urbanizmit        | 31                | 18           | 2           | 10        | 1         | 29               | -    | 1    | 1       | 14                | 17 |
| 5.  | Drejtoria e Shërb.Publike     | 27                | 9            | 3           | 15        | -         | 28               | -    | -    | 1       | 20                | 7  |
| 6.  | Drejtoria e Shendetësisë      | 12                | 8            | -           | 4         | -         | 12               | -    | 1    | -       | 6                 | 6  |
| 7.  | Drejtoria e Kad. dhe Gjeod.   | 29                | 3            | 2           | 23        | 1         | 29               | -    | -    | -       | 16                | 13 |
| 8.  | Drejtoria e Ekonomisë         | 13                | 8            | -           | 5         | -         | 12               | -    | 1    | -       | 8                 | 7  |
| 9.  | Drejtoria e Ars. dhe Shken.   | 24                | 21           | 1           | 2         | -         | 23               | -    | 1    | 1       | 12                | 12 |
| 10. | Drejtoria e Zhvill.Rural      | 8                 | 7            | -           | 1         | -         | 8                | -    | -    | -       | 5                 | 3  |
| 11. | Drejtoria e Kult. dhe Gjinisë | 5                 | 5            | -           | -         | -         | 5                | -    | -    | -       | 1                 | 4  |
| 12. | Drejtoria e Sport. dhe Rinisë | 4                 | 4            | -           | -         | -         | 4                | -    | -    | -       | 1                 | 3  |
| 13. | Drejtoria e MCE-së            | 146               | 9            | 9           | 128       | -         | 120              | 26   | -    | -       | 140               | 6  |
| 14. | Njësia e monit me zyrat       | 30                | 19           | -           | 11        | -         | 29               | 1    | -    | -       | 17                | 13 |
| 15. | Kryesia e Komunes             | 5                 | 5            | -           | -         | -         | 4                | 1    | -    | -       | 5                 | -  |
| 16. | Pilot projekti - Financa      | 37                | 1            | -           | 36        | -         | 37               | -    | -    | -       | 19                | 18 |

Të punësuarit në institucionet kulturore:

| Nr. rend. | Emri i Institucionit                                    | Nr. i përgj. | Fak. | Elartë | Emesme | Eulët | Shqiptarë | Serbë | Turq | Tetjerë | M  | F |
|-----------|---------------------------------------------------------|--------------|------|--------|--------|-------|-----------|-------|------|---------|----|---|
| 1.        | Instituti i Monument. dhe Muzeu Raj. Prishtinës         | 6            | -    | -      | 3      | 3     | 6         | -     | -    | -       | 3  | 3 |
| 2.        | Arkivi Historik i Qytetit të Prishtinës                 | 8            | 1    | -      | 7      | -     | 8         | -     | -    | -       | 4  | 4 |
| 3.        | Biblioteka ndërkomunal e "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë | 15           | 1    | 2      | 11     | 1     | 15        | -     | -    | -       | 7  | 8 |
| 4.        | Qendra e Pionerëve Prishtinë                            | 7            | 3    | -      | 4      | -     | 7         | -     | -    | -       | 4  | 3 |
| 5.        | Teatri "Dodona" Prishtinë                               | 18           | 3    | -      | 13     | 2     | 18        | -     | -    | -       | 14 | 4 |
| 6.        | Shtëpia e Kulturës në Graçanicë                         | 10           | -    | 2      | 8      | -     | 10        | -     | 1    | 9       | 2  | - |
| 7.        | Sh. K. Haj.                                             | 1            | -    | -      | 1      | -     | 1         | -     | -    | 1       | 1  | - |

Të punësuarit në Zyrën e komuniteteve në Graçanicë:

| Nr.<br>Rend | Zyra e<br>komuniteteve<br>në Graçanicë | Nr.<br>P<br>E<br>R<br>Gj<br>I<br>Th | S<br>U<br>P<br>E<br>R<br>I<br>O<br>R | L<br>A<br>R<br>Ë<br>O<br>R | M<br>E<br>S<br>T<br>E | E<br>U<br>L<br>T | Sh<br>Q<br>I<br>P<br>T<br>A<br>R | S<br>E<br>R<br>b | T<br>U<br>R<br>q | Te<br>T<br>J<br>E<br>R | M  | F |
|-------------|----------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------------------|----------------------------|-----------------------|------------------|----------------------------------|------------------|------------------|------------------------|----|---|
| 1.          | Zyra e<br>komuniteteve                 | 24                                  | 4                                    | 3                          | 14                    | 3                | -                                | 24               | -                | -                      | 18 | 6 |
|             | Gjithsej                               | 24                                  | 4                                    | 3                          | 14                    | 3                | -                                | 24               | -                | -                      | 18 | 6 |

#### b) Byroteknika

Realizimi i detyrave në Shërbimin e byroteknikës gjatë periudhës raportuese, ka qenë:

- shumëzimi dhe fotokopjimi i materialeve për shërbyesit civilë të caktuar në zyra - sektorë, drejtori, Avokaturën Publike komunale dhe në trupat ndihmëse -komitetet e Kuvendit të Komunës.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet numri i materialit të shumzuar:

| Nr. rend. | KOMUNA                                               | Nr. i<br>kopjeve | Nr. i risave të shpenzuar |
|-----------|------------------------------------------------------|------------------|---------------------------|
| 1.        | Drejtoria e Administratës së Përgjithshme            | 303512           | 607                       |
| 2.        | Drejtoria e Financave dhe e Pronës                   | 45831            | 91                        |
| 3.        | Drejtoria e Ekonomisë                                | 2125             | 4                         |
| 4.        | Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe e Ndërtimit | 645              | 1                         |
| 5.        | Drejtoria e Kulturës dhe e Gjinisë                   | 1520             | 3                         |
| 6.        | Drejtoria e SHPTATN-së                               | 440              | 1                         |
| 7.        | Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe e Bujqësisë         | 1790             | 3.5                       |
|           |                                                      |                  |                           |

|     |                                                |               |            |
|-----|------------------------------------------------|---------------|------------|
| 8.  | Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe e Emergjencës | 7114          | 14.5       |
| 9.  | Drejtoria e Shëndetësisë                       | 10270         | 20.5       |
| 10. | Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës             | 14191         | 28         |
| 11. | Drejtoria e Inspeksionit                       | 6235          | 12.5       |
| 12. | Drejtoria e Kadastrit dhe e Gjeodezisë         | 1778          | 3.5        |
|     |                                                |               |            |
| 13. | Zyra e prokurimit                              | 38650         | 77         |
| 14. | Sektori për punë të Kuvendit të Komunës        | 44474         | 88         |
| 15. | Të tjera                                       | 14631         | 28         |
|     |                                                |               |            |
|     | <b>Gjithsej</b>                                | <b>484006</b> | <b>950</b> |

Nga tabela e prezentuar më lart shihet se shumëzimi i kopjeve është më i lartë në krahasim me vitin paraprak, numri i kopjeve ishte 464 684, ndërsa nr. i risave të shpenzuar 929.

### **Sektori për punë të Kuvendit dhe të Bordit të drejtorëve**

Për periudhën raportuese është përgatitur materiali për mbajtjen e mbledhjeve:

- Kuvendi i Komunës ka mbajtur 6 (10) mbledhje të rregullta,
- Bordi i drejtorëve ka mbajtur 20 (21) mbledhje,
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 7 (10) mbledhje,
- Komiteti për Komunitete ka mbajtur 30 (36) mbledhje,
- Komiteti për Ndërmjetësim ka mbajtur 30 (36) mbledhje,
- Komiteti për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim, ka mbajtur 7 (8) mbledhje,
- Komisioni për ankesa, peticione dhe kontroll të përgjithshëm, 12 (12) mbledhje,
- Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim, ka mbajtur 22 (24) mbledhje,
- Komiteti për Arsim dhe Shkencë, ka mbajtur 20 (24) mbledhje,
- Komiteti për Zhvillim Rural, ka mbajtur 30 (36) mbledhje,
- Komiteti për Shërbime Publike, ka mbajtur 24 (26) mbledhje,
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur 28 (29) mbledhje,
- Komiteti për Pronë ka mbajtur 20 (24) mbledhje,
- Komiteti komunal për Banim dhe Rindërtim, ka mbajtur 20 (24) mbledhje,
- Grupi komunal për kthim, ka mbajtur 6 (7) mbledhje,
- Komuna ka mbajtur 1 (një) (2) takim - obligativ me qytetarë.

Numri më i vogel i mbajtur i takimeve, arsye ka pasur mbajtjen e zgjedhjeve lokale të dt. 17 nëntorit 2007.

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës ka miratuar :

- 1 (një) (6) rregullore komunale, në pajtim me dispozitat ligjore, që janë nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës dhe janë fuqizuar nga PSSP-ja, dhe ka nxjerrë
- 58 (68) vendime nga kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Komuna.

Numri më i vogel i nxjerrjes së akteve krahasuar me vitin paraprak, është si pasojë e asaj se Komuna me kohë ka bërë harmonizimin e dispozitave të Rregulloreve dhe vendimeve me ligjet që janë në fuqi.

### **Sektori teknik**

Ky sektor ka zhvilluar aktivitetin e tij në mbështetje të Rregullores mbi organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës. Gjatë kësaj periudhe është punuar në:

- sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës,
- mirëmbajtjen e pajisjeve në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,
- furnizimin dhe mirëmbajtja e bufësë,
- mirëmbajtjen e rrjetit telefonik dhe të ngrohjes qendror - vetanake,
- ngjyrosjen e disa zyrave brenda objektit të Komunës, disa zyrave të BL-ve dhe zyrave të vendit,
- kryerjen e punëve teknike rreth regjistrimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Komunës,
- mbikëqyrjen për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të Komunës,
- udhëheqjen e llogarisë mbi shpenzimet e karburanteve nga automjetet gjatë kryerjes së punëve zyrtare - janë hargjuar 72402 (73.330) litra karburante për gjithsej 567 241 (535 180) km. të kaluara. Pra, krahasur me vitin paraprak, kemi shtim të numrit të kilometrave të kaluara për 32 061 km, ndërsa zbritje të derivateve të naftës për 928 litra.

### **Sektori i bashkësive lokale**

Me qëllim të përmbushjes së punëve dhe detyrave që burojnë nga akti individual i organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, në kuadri të këtij sektori:

- është bërë përgatitja për mbajtjen e takimeve të rregullt me kryetarët e bashkësive lokale, me këshillat e BL-ve për gjithsej 9 takime të rregullta;
- në bazë të evidencës që ka në dispozicion, janë lëshuar vërtetime nga kompetencat e tij;
- është zhvilluar bashkëpunim i kënaqshëm me këshillat e bashkësive lokale, me komitetet dhe drejtoritë përkatëse, përkitazi me implementimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës.

Gjatë periudhes raportuese në bazë të evidencës që kanë bashkësitë lokale, dhe sipas kërkesave të personave fizikë, juridikë dhe të tjerëve, në kuadër të këtij sektori janë lëshuar akte nga kompetenca që ka:

|                                                                                                                                      |      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| -vërtetime për rregullimin e së drejtës në asistencë sociale.....                                                                    | 2472 |
| -vërtetime për të punësuarit në diasporë, që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjarëve të tyre në Kosovë.....                          | 654  |
| -dëshmi për vendbanimin, si provë për regjistrim në QKRC.....                                                                        | 1039 |
| -vërtetime për paraqitje në Zyrën Rajonale të Punësimit.....                                                                         | 133  |
| -vërtetime si dëshmi për vendbanim si provë pranë QRP.....                                                                           | 154  |
| -vërtetime si dëshmi për kalim tranzit të qytetarëve me punësim në botën e jashtme nëpër territorin e Republikës së Serbisë.....     | 411  |
| -vërtetime për dëshminë e vendbanimit, më qëllim të regjistrimit të nxënësve në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe superior. |      |

Si çështje që duhet shtruar në formë të rekomandimit, është nevoja e përcjelljes së kompetencave që do të kënë në të ardhmen këto njësi, në pajtim me dispozitat e Ligjit për pushtetin lokal.

## Sektori i gjendjes civile

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- ka vazhduar puna rreth rikonstruktimit të librave amzë,
- janë zgjidhur kërkesat, të cilat kryhen në mbështetje të dispozitave të procedurës administrative,
- janë lëshuar certifikata nga libri amzë i të lindurve, i të vdekurve dhe i të kurorëzuarve, mbështetur në evidencën që ka ky sektor,
- është bërë formatizimi, ruajtja e të dhënave, instalimi, konfigurimi dhe kyçja në rrjet i kompjuterëve të Shërbimit të ofiqarisë me serverin kryesor, që mundëson punën në programin bazë të të dhënave për lëshimin e certifikatave të reja me nr. serik, në bashkëpunim me Zyrën e teknologjisë informative,
- është bërë hapja e Zyrës së ofiqarisë në QKU - Klinikën e Gjinekologjisë për regjistrimin e të porsalindurve. Në gusht të vitit 2007 është vënë në funksion aneksi i Shërbimit të ofiqarisë, ku dukshëm janë përmirësuar kushtet e punës.

Në vazhdim të këtij raporti paraqitet pasqyra tabelare e punëve të kryera në kuadër të këtij sektori:

|                                                           |       |
|-----------------------------------------------------------|-------|
| - regjistrime në librin amzë të të lindurve .....         | 10534 |
| - regjistrime të mëvonshme në LAL .....                   | 12295 |
| - regjistrime në librin amzë të të martuarve .....        | 1310  |
| - regjistrime të mëvonshme në LAM.....                    | 1172  |
| - regjistrime të reja në librin amzë të të vdekurve ..... | 2046  |
| - regjistrime të mëvonshme në LAV.....                    | 692   |

Gjatë periudhës raportuese, lindje, martesë dhe vdekje, që kanë të bëjnë me qytetarët tanë jashtë territorit të Kosovës, janë regjistruar si më poshtë:

|                                    |      |
|------------------------------------|------|
| - regjistrime speciale në LAL..... | 1327 |
| - regjistrime speciale në LAM..... | 167  |
| - regjistrime speciale në LAV..... | 53   |
| - certifikata lindjeje.....        | 3444 |
| - certifikata martese.....         | 274  |

|                             |    |
|-----------------------------|----|
| - certifikata vdekjeje..... | 93 |
|-----------------------------|----|

Sipas kërkesave të palëve, gjatë periudhës raportuese janë lëshuar :

|                                                    |       |
|----------------------------------------------------|-------|
| -certifikata lindjeje.....                         | 49886 |
| -certifikata martese.....                          | 7516  |
| -certifikata vdekjeje.....                         | 4708  |
| -certifikata të statusit martesor.....             | 3438  |
| -vërtetime – dëshmi se personi është i gjallë..... | 2354  |
| -deklarata mbi bashkësinë familjare.....           | 4097  |
| -deklarata me dy dëshmitarë.....                   | 28    |
| -vërtetimi i fotokopjeve (përshkrimi) .....        | 53835 |

Në procedurë administrative është vendosur për kërkesat:

|                                                       |     |
|-------------------------------------------------------|-----|
| - ndërrim emri personal (individ - familjar).....     | 54  |
| - korrigjim emri personal (individ - familjar).....   | 627 |
| - përmirësim emri personal dhe shënime të tjera.....  | 733 |
| - regjistrime të mëvonshme në LAL.....                | 135 |
| - regjistrime në LAV.....                             | 3   |
| - aktvendime lidhur me anulimin e regjistrimeve ..... | 1   |

Për kërkesat e paraqitura, mënyra e vendosjes është:

|                              |      |
|------------------------------|------|
| - kërkesa të miratuara ..... | 1553 |
| - kërkesa të refuzuara.....  | 2    |
| - kërkesa të hedhura .....   | 11   |

Në krahasim me vitin 2006, gjatë vitit raportues në Sektorin e regjistrimit civil - Ofiqarisë është shënuar rritje e vogël sa i përket kërkesave të palëve, përjashtuar këtu kërkesat për deklaratat familjare dhe ato për vërtetimin e kopjeve të dokumenteve, të cilat kanë shënuar rritje të madhe.

## II. DREJTORATI I EKONOMISË

Gjatë vitit raportues është vazhduar me zbatimin e projektit “softwerik” lidhur me procedurat, evidencat, ngarkesat, lëshimin dhe vazhdimin e lejeve të punës, të cila kanë rezultuar me azhurimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara komunitetit të biznesit.

Në të njëjtën periudhë kohore janë lëshuar vendime për shoqëritë tregtare, në bazë të procesverbaleve të hartuara nga kontrollet e bëra nga komisionet mikste të Drejtoratit të Ekonomisë, Drejtoratit të Inspektionit dhe të Drejtoratit të Financave dhe të Pronës.

Sipas shënimeve të marra nga MTI-ja, numri i përgjithshëm i bizneseve në komunë është në rritje, gjithashtu edhe numri i të punësuarëve në këto biznese është në rritje, sipas evidencës së marrë nga Trusti Pensional i Kosoves me seli në Prishtinë.

Nga numri i bizneseve të cekura më lart janë inkasuar 382 338. 00 €, respektivisht 38.23% të mjeteve të planifikuara për vitin 2007. Për mospërmbushjen në tërësi të këtij zëri

buxhetor kanë ndikuar mospërgjegjshmëria e obliguesve për kryerjen e obligimeve ndaj Komunës, rënia ekonomike, numri i vogël i inspektorëve të tregut - lejeve për punë, mospërputhshmëria e adresave të biznesit, si dhe lëshimet tjera administrative dhe procedurale që janë bërë gjatë fazës së regjistrimit të shoqërive tregtare në MTI - Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve.

Drejtorja ka bashkëpunuar me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë përmes takimeve konsultative, pjesëmarrje edhe në projekte tjera të organizuara në kuadër të MTI-së, siç është: "Projekti i ndihmës për NVM - të sistemi „Voucher“", "Projekt lidhur me dhënien e konsultimeve dhe mbajtjen e trajnimeve për bizneset e vogla" financuar nga BE-ja. Drejtori i drejtorisë ka marrë pjesë në përzgjedhjen e 10 (dhjetë) kompanive më të suksesshme në Kosovë, në cilësinë e jurisë profesionale të emëruar nga ministri i Tregtisë dhe i Industrisë.

Në bashkëpunim me institutin "Riinvest", i cili është përfitues i projektit në përkrahjen teknike dhe shkencore për përpilimin e "Strategjisë zhvillimore 2007-2011", ka vazhduar puna me Riinvestit dhe nga të punësuarit në drejtori, janë vënë kontaktet me komunitetin e biznesit, Odën Ekonomike të Kosovës, Klubin e Biznesit, Aleancën Kosovare të Biznesit dhe me Shoqërinë civile.

Realizmi i projektit të 4 (katert) në bashkëpunim me KFOR-in finlandez. Janë investuar 50 000, 00 €. Kompanitë fillestare dhe individët, shumën e përfituar e kanë realizuar për blerjen e makinave të nevojshme për fillimin e punës. Motoja e projektit ka qenë përkrahja e të rinjve dhe e gjinisë femërore, për zvogëlimin e papunësisë, duke krijuar vende të reja të punës.

Në vazhden e projekteve për zvogëlimin e papunësisë, Drejtoria, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe Zyrën Rajonale për Trajnime me seli në Prishtinë, ka realizuar projektin "Trajnimi i të rinjve të papunë në ndërmarrësi". Qëllimi kryesor i këtij projekti ka qenë aftësimi i të rinjve për të filluar biznesin vetanë, si një mundësi reale e vetëpunësimit, duke u ofruar trajnime profesionale nga lëmenjtë e menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla, bazat e kontabilitetit financiar, marketingut, hartimit të biznesplanit, si dhe të planit strategjik. Projekti ka zgjatur 36 ditë pune dhe janë aftësuar 60 pjesëmarrës. Përzgjedhja e tyre është bërë nga një numër i madh i kërkesave.

Pjesëmarrja aktive në Grupin konsultativ qeveritar për hartimin e Strategjisë zhvillimore të Kosovës 2007-2013.

Pas miratimit të "Strategjisë zhvillimore të Prishtinës 2007-2011", paralelisht do të përgatiten mekanizmat që do të bëjnë të mundur zbatimin sa më të suksesshëm të strategjisë përmes kontrollit dhe raportimeve, duke gjetur format e reja të bashkëpunimit me investitorët vendorë dhe të huaj për realizimin e një mori projektesh, të cilat drejtpërdrejt do të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe ngritjen e perspektivës në zhvillimin më të hovshëm ekonomik, në mënyrë që kryeqendra e Kosovës, Prishtina, të bëhet një qendër e respektuar në aspektin zhvillimor dhe me një perspektivë të qartë për të ardhmen.

### III. DREJTORATI I FINANCAVE DHE PRONËS

#### 1. SEKTORI I BUXHETIT

Në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, puna dhe aktiviteti që ka zhvilluar sektori ,do të përmblihet më sa vijon:

- regjistrimi i pagesave dhe faturave nëpërmjet arkës kryesore,
- nënshkrimi i të gjitha pagesave ditore,
- plotësimi dhe pagesa e CPO-ve, periudha janar – dhjetor 2007,
- regjistrimi i të dhënave në “ Akces”, xhirollogaria e rregullt, periudha 3.1.2007- 31.12.2007,
- kontimi në xhirollogarinë kryesore, janar-dhjetor 2007 ,
- regjistrimi i të dhënave në “ Akces” – Prona, periudha 3.1.2007 - 31.12.2007,
- të tjera (shkuarja në MEF, MSHP, bankë etj.),
- regjistrimi i faturave, janar - dhjetor 2007,
- kontimi i të gjitha CPO-ve ,
- evidencimi në “Free Balance” prej 3.1.2007 – 31.12.2007,
- raportet e inkasimit - dorëzimit të kuponave nga inkasantët,
- kontimi i xhirollogarisë së Pronës, janar-dhjetor 2007,
- kontimi i xhirollogarisë së Arsimit dhe qerdheve, janar- dhjetor 2007,
- kontimi i arkës kryesore, janar-dhjetor 2007,
- kontimi i xhirollogarisë së Shëndetësisë, janar-dhjetor 2007,
- kontimi i xhirollogarisë së participimeve të qytetarëve, sipas evidencimit të të hyrave,
- kontimi i arkës së taksave, janar-dhjetor 2007,
- punë me Komisionin për nivelimin e pagave,
- përgatitja e raportit të shpenzimeve 3,6,9 m. dhe vjetor,
- regjistrimi i listës së pagave, janar – dhjetor 2007,
- prezantimi i të dhënave për auditor,
- përpilimi i raportit të të hyrave vetanake, janar-dhjetor 2007,
- përpilimi i të hyrave vetanake për vitin 2007 – MEF-it,
- përpilimi i raportit të shpenzimeve për vitin 2007 - MEF-it,
- përpilimi i raportit buxhetor për Arsim dhe Shëndetësi – 2007,
- pagesa e faturave për kompani të shërbimeve publike të obligimeve të Kuvendit të Komunës,
- pagesat e faturave për Drejtoratin e Arsimit,
- përgatitja e projekteve kapitale buxhetore për vitin 2007 – MEF-it,
- regjistrimi i punëtorëve në programin e pagave,
- ofrimi i të dhënave për palën e tretë,
- planifikimi, përgatitja e formularëve për buxhet, mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale dhe subvencione dhe transfere,
- të tjera sipas kërkesës...

## 2. SEKTORI I PRONËS

Në kuadër të këtij sektori gjatë periudhës raportuese, janë kryer punë dhe detyra të punës nga fushëveprimtaria e tij, si:

- shqyrtimin dhe vendosjen sipas kërkesave të personave fizikë dhe juridikë në procedurën administrative nga lëmi i rregullimit të marrëdhënieve pronësoro - juridike në çështjet lidhur me pronën komunale, dhe
- zhvillimin e veprimeve procedurale dhe administrative sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal.

### a. Vendosja sipas kërkesave

Nga personat fizikë dhe juridikë, me përmbajtje kryesisht për deeksprijimin e paluajtshmërive të ekspropriuara në bazë të aktvendimeve të ish-organeve komunale për çështje pronësore, apo kompensimin e paluajtshmërive të ekspropriuara sipas atyre vendimeve, ofertat për prioritetin e Komunës për blerjen e paluajtshmërive, kërkesat për caktimin e kufijve të rrugëve publike, kërkesa për përcaktimin e lokacioneve për objekte të interesit të përgjithëshëm, kërkesa për kompensimin e paluajtshmërive në pronësi private dhe kërkesa tjera me përmbajtje të ngjashme, si dhe propozime për eksproprijimin apo rregullimin e marrëdhënieve pronësoro - juridike, në bazë të vendimeve apo programeve tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Numër i konsiderueshëm i kërkesave në periudhën raportuese në këtë sektor, ka arritur nga Gjykata Komunale, avokati komunal dhe personat fizikë, për gjetjen e konkluzioneve përfundimtare, apo shkresave tjera të lëndëve të vendosura në periudhën para vitit '99-të.

Numri i kërkesave të arritura për shqyrtim dhe vendosje dhe zgjidhja e tyre, në mënyrë tabelare, do të dukej si më poshtë:

| Nr. i kërkesave të arritura gjatë vitit 2007 | Gjithsej për punë gjatë vitit 2007 | Të miratuara | Të refuzuara | Të bartura në vitin 2008 |
|----------------------------------------------|------------------------------------|--------------|--------------|--------------------------|
| 131                                          | 73                                 | 73           | -            | 58                       |

Po ashtu, në numrin e këtyre lëndëve janë paraqitur edhe propozimet për eksproprijime dhe rregullim të marrëdhënieve tjera pronësore, me qëllim të realizimit të programeve komunale, si dhe kërkesa nga personat fizikë për kompensimin dhe rregullimin e marrëdhënieve pronësoro- juridike për pronat e paluajtshme, të planifikuara për rrugë publike dhe destinime tjera të intersit të përgjithëshëm, me plane rregulluese dhe projekte tjera të rrugëve unazore të qytetit, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Në kolonën e katërt të tabelës së dhënë në këtë raport, lëndë të paraqitura si të zgjidhura meritorë, pos numrit të lëndëve të paraqitura e të zgjidhura, përkatësisht të përfunduara, me lëshim të vërtetimit përkatës, janë paraqitur edhe lëndët e zgjidhura pa nevojën e nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar, por vetëm në formën e përgjigjes me shkrim, apo informacionit përkatës lidhur me përmbajtjen e kërkesës, si dhe për inkompetencën e këtij sektori.

Lëndë të paraqitura si të vendosura meritore në kolonën e tabelës në fjalë, janë përshirë edhe vendosja sipas propozimeve për realizimin e programeve komunale, me të cilat ka qenë i nevojshëm zhvillimi i procedurës për eksproprijimin e paluejtshmërive në pronësinë private, kështu që gjatë periudhës raportuese janë nxjerrë tri aktvendime për eksproprijime, me të cilat janë shpronësuar pesë pronarë, dy nga këto aktvendime janë bërë të plotëfuqishme pasi që është arritur marrëveshja për kompensimin e tyre.

Lëndë të paraqitura në procedurë, janë kryesisht lëndët sipas kërkesave për deeksproprijime dhe ato për kompensimin e pronave të paluajtshme, të eksproprijuara me vendimet e ish-organeve komunale, për të cilat është e nevojshme që para vendosjes, përkatësisht nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar, të gjenden dosjet ekzistuese në origjinale, në mënyrë që të vërtetohet vërtetësia e përmbajtjeve të kërkesave, gjë që në shumicën e rasteve këto dosje mungojnë pjesërisht apo tërësisht.

Për zgjidhjen e kësaj kategorie të kërkesave, pos vështirësive të përmendura për vendosje të drejtë sipas tyre, pengesë serioze ka qenë edhe mungesa e infrastrukturës së re ligjore, që do të rregullonte këtë çështje dhe kolezioni i dispozitave të Ligjit mbi eksproprijim dhe Ligjit mbi tokën ndërtimore, të cilat rregullojnë çështjen e deeksproprijimit dhe kthimit të tokës ish-pronarit.

Po ashtu, lëndë në procedurë janë paraqitur edhe ato të cilat gjatë këtij viti raportues, në bazë të propozimeve, janë zhvilluar procedura të parapara ligjore për eksproprijimin e paluajtshmërisë në pronësinë private të dhjetë pronarëve, në kuadër të lokacionit të planifikuar për ndërtimin e shkollës fillore në lagjen " Mati 1" në Prishtinë, si dhe propozimi për rregullimin e marrëdhënieve pronësoro- juridike, me qëllim të realizimit të projektit sipas planit rregullues të lagjës " Qendra-Ulpiana" në Prishtinë, por për të njëjtat ende nuk janë nxjerrë konkluzionet përfundimtare.

## **b) Veprimet procedurale sipas detyrës zyrtare**

Nga veprimet sipas detyrës zyrtare, do të ishte e rëndësishë të përmenden komunikimet zyrtare me AKM-në dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave – Administratën tatimor, për ndikimet në marrëdhëniet pronësoro - juridike të paluajtshmërive - tokave të shitura nga këto institucione në aspektin: ish-pronar – komunë- pronar i ri, si dhe kërkesa dërguar Gjykatës Komunale të Prishtinës, që t'i dërgojë avokatit komunal dhe kësaj drejtorie, kopjet e të gjitha kontratave mbi shit-blerjen e paluajtshmërive të vërtetuara nga kjo gjykatë, me qëllim të ruajtjes së pronës dhe interesit të komunës.

## **b) Vështirësitë dhe pengesat tjera në punën dhe rezultatet e Sektorit**

Në rezultatet e punës nga përgjegjësia e sektorit, ndikim vendimtar ka pasur dhe ka:

- mungesa e vazhdueshme e kuadrit profesional, si nga lëmi juridik ashtu edhe nga ai i gjeodezisë,
- mungesa e infrastrukturës së re ligjore, që rregullon çështjet nga përgjegjësia e sektorit,

- kolezioni i dispozitave ligjore ekzistuese të Ligjit mbi eksproprijimet dhe Ligjit mbi tokën ndërtimore, lidhur me nxjerrjen e konkluzionit përfundimtar gjat shqyrtimit të kërkesave të personave fizikë për deeksprijime,
- mungesa e bazës juridike dhe planeve gjeodezike origjinale të ndryshimeve në operativin kadastral,
- hyrja në posedim të Komunës e pronave private gjatë realizimit të programeve pa procedurën e shpalljes së interesit të përgjithëshëm të asjë prone, dhe pa zhvillimin e procedurës për shpronësim, si dhe
- vështirësitë tjera të natyrës objektive, si pengesa nga persona të tretë në terren, e të ngjashme.

### **Propozimi i masave**

Për të qenë të kënaqshme rezultatet e punës nga fushëveprimi i sektorit, është e nevojshme që:

- sektori të rritet në numër dhe të forcohet në kualifikim të nevojshëm të personelit civil, të paraparë me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të organeve të administratës;
- të formohet një njësi organizative në kuadër të Drejtorisë, e cila do të ndihmojë punën e sektorit për kryerjen e punëve sipas detyrës zyrtare, veçanërisht në konstatimin e uzurpimit të pronës komunale - publike. Për formimin e njësisë së propozuar, do të ishte i nevojshëm sigurimi i një hapësire për punë- zyre, ndërsa sigurimi i kuadrit do të mund të organizohej nga personeli civil brenda organeve të administratës;
- nga prona komunale, e fituar në bazë të kontratave mbi koncesionin, një fond i caktuar i kësaj prone të destinohet për kompensimin e pronave private të ekspropriuara për nevojat e realizimit të programeve komunale të interesit të përgjithëshëm;
- me buxhetin komunal të planifikohet një pozicion, nga i cili do të kompensohej prona private e eksproprijuar për nevojat e përshkruara në pikën 3 të këtij propozimi;
- në rastet kur ish-pronari është palë në procedurë edhe si investitor, të krijohet mundësia e kompensimit të pronës së eksproprijuar me lartësinë e llogaritur të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore, pasi që në bazë të rregulativës ligjore ekzistuese, nga ky lloj kompensimi krijohet fondi për eksproprijime.

### **3. SEKTORI I TAKSËS NË PRONË**

#### **Operimi kompjuterik**

Gjatë vitit 2007, janë kryer këto punë:

- Në bazë të evidencës që ka Sektori, janë nxjerrë 52 670 fatura të tatimit mbi pronën e paluajtshme (jo për tokë) për vitin 2007;
- Është bërë regjistrimi i pronave-objekteve të reja -755 raste;
- Është marrë raporti për pagesat e tatimit mbi pronën nga bankat komerciale;
- Janë regjistruar në kompjuterë pagesat e tatimit mbi pronën, të bëra nga tatimpaguesit 9 887 pagesa;

- Është bërë përmirësimi në kompjuterë i zonave dhe i kategorive tatimore 380 raste;
- Është bërë përmirësimi në kompjuterë i adresave (rrugëve) 220 raste;
- Janë regjistruar në kompjuterë aktvendimet sipas ankesave 854;
- Është bërë përmirësimi i gabimeve eventuale teknike në faturat e taksës për pronë, 180 raste;
- Janë lëshuar 6 800 vërtetime, si provë për kryerjen e obligimit tatimor nga obliguesit tatimorë;
- Është bërë regjistrimi i formularëve të pronave - objekteve të reja 755 raste.

### **Mbledhja e shënimeve**

- Është bërë matja dhe regjistrimi i objekteve të paregjistruara gjatë vitit paraprak në 755 raste;
- Janë reregjistruar objekte banesore, afariste, industriale dhe garazhe, gjithsej 12 300 sosh.
- Është bërë kontrollimi i objekteve në terren, në bazë të ankesave të tatimpaguesve në 854 raste.

### **Zyra e shpërndarjes së faturave**

- Janë përgatitur dhe sistemuar për shpërndarje 52 670 fatura taimore;
- Janë shpërndarë në terren 50 750 fatura tatimore;
- Kanë mbetur të pashpërndara 1 120 fatura, kryesisht nëpër enklava, dhe problemeve me adresa ;
- Janë shpërndarë 19 500 letërkujtesa për tatimin në pronë.

### **Bordi i ankesave**

- Ka pasur 854 ankesa të obliguesve tatimorë;
- Janë shqyrtuar 854 ankesa. Në procedurën e vendosjes, Bordi i ankesave ka pasur bashkëpunim me komisionet e terrenit për vërtetimin e gjendjes faktike.
- Ka bërë përcjelljen e vendimeve për regjistrim në evidencën që mban Drejtoria.

### **Transakcioni në pronë**

Gjatë vitit 2007, Shërbimi i transakcionit i kanë arritur 3 667 kërkesa për transakcion të paluajtshmërive. Lëndët janë kryer në afatin e caktuar. Janë vendosur 3 607 kërkesa, dhe shërbimi për këtë ka arkëtuar 685 198, 50 €, për dallim nga viti i kaluar ku kemi arkëtuar 561 105, 00 €.

### **OFERTAT- QARKULLIMI I PALUAJTSHMËRISË**

Gjate kësaj periudhe janë paraqitur 1 159 kërkesa (oferta për blerjen ose mosblerjen e tokës urbane-rurale, të objekteve të banimit - kolektive apo individuale, të lokaleve afariste, të garazheve etj.). Prej tyre , janë vendosur, gjegjësisht janë lëshuar gjithsej 1 140 vërtetime, që tregojnë se Komuna nuk është e interesuar për blerjen e paluajtshmërisë së ofruara me oferta përkatëse. Në procedurë kanë mbetur gjithsej 19 kërkesa të pashqyrtuara. Janë inkasuar 3 477 € krahasuar me vitin paraprak, ku janë inkasuar 3357 €.

#### IV. DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Me fillimin e vitit 2008, në takim me punëtorët e drejtorisë, e pastaj edhe me drejtues të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe të Entit për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore (ENSHM) në Prishtinë, është analizuar në tërësi puna e bërë gjatë vitit paraprak. Është vlerësim i përgjithshëm se drejtoria ka realizuar me sukses detyrat dhe punët e parashtruara.

Drejtorati i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale, veprimtarinë e vet e ka ushtruar përmes tre sektorëve; Sektorit për shëndetësi, Sektorit për shëndet publik dhe Sektorit për mirëqenie dhe strehim social.

##### 1. Sektori i shëndetësisë

Shërbimet shëndetësore në mjekësinë parësore ofrohen përmes 10 qendrave të mjekësisë familjare që funksionojnë në qytet, në 14 ambulanca shëndetësore që funksionojnë në vendbanimet rurale, në Poliklinikën e Stomatologjisë, në Dispanserin e Sëmundjeve të Mushkërive, në 10 ordnanca stomatologjike në shkollat fillore të qytetit të Prishtinës, si dhe përmes Entit të Ndihmës së Shpejtë Mjekësore në Prishtinë. Gjatë vitit kalendarik 2007, është arritur përparim në furnizim me barna, material sanitar, karburante, si dhe material tjetër të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sa më cilësore.

**Projektet:** Në muajt e parë të vitit 2007, është vazhduar punët për përfundimin e projekteve të parapara për vitin 2007:

- Dezinsektimi hapësinor i Prishtinës 2007;
- Deratizimi vjeshtor i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës;
- Deratizimi vjeshtor i gar. dhe pod. publike të Prishtinës;
- Rregullimi i rrethojës dhe oborit të QMF-së në lagjen “Kodra e Trimave” dhe të QMF-së në lagjen “Kalabria” dhe rregullimi i oborit në QKMF në Prishtinë;
- Ndërtimi i QMF-së në fshatin Rimanishtë dhe në fshatin Shkabaj;
- Riparimi i Shërbimit higjieno – epidemiologjik në QKMF në Prishtinë;
- Furnizimi me aparat biokimik – laboratorik;
- Furnizimi me dy gjeneratorë në QMF-të nël. “Kodra e Trimave” dhe “Kalabria”;
- Rregullimi i Qendrës për Mirëqenie Sociale të Gruas dhe
- Furnizimi me 9 karrige stomatologjike.

Mosrealizimi i disa projekteve të parapara, siç janë: ndërtimi i QMF-së në fshatin Sofali, i QMF-së në Lagjen e Spitalit, i QMF-së në Lgjen e Muhaxhirëve, i QMF-së në lagjen “Vreshtat” dhe i QMF-së në lagjen “Arbëria”, është si rezultat i vonësës së DPUN-së së Komunës në mosaktimin e lokacionit për shkak të mungesës së Planit detal rregullues urban, në bazë të të cilit bëhet definimin e ndërtimeve në këto lagje, si dhe rezultat i vonësës së mjeteve të alokura nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës. Këto mjete financiare, të cilat janë vonuar për alokim, kanë qenë të ardhurat vetanake të Komunës, dhe Ministria në fjalë ka paraparë alokimin e këtyre mjeteve muajin e parë të vitit 2008 për t’u realizuar projektet.

## **2. Sektori për mirëqenie sociale**

Punën dhe aktivitetin e vet e ka zhvilluar në përputhje me planin e punës së sektorit për vitin 2007, dhe konform kompetencave të përcaktuara me aktet normative të Komunës. Veprimet dhe aktivitetet thelbësore të Sektorit për mirëqenie sociale në periudhën raportuese, mund të klasifikohen me sa vijon:

- pranimi, seleksionimi, shqyrtimi dhe vendosja e kërkesave të palëve drejtuar sektorit,
- ofrimi i shërbimeve cilësore qytetarëve që i drejtohen këtij sektori,
- verifikimi i gjendjes së përgjithshme sociale të familjeve në varfëri ekstreme në komunë,
- kontaktet dhe takimet e ndryshme me sektorët e drejtorive të Komunës, institucionet e Kosovës, OJQ-të dhe organizatat qeveritare dhe
- hartimi i projekteve të nevojshme për sektorë.

Gjatë vitit 2007, këtij sektori iu kanë parashtruar 183 kërkesa, nga të cilat 136 kanë marrë përgjigje pozitiv dhe 47 përgjigje negative.

Janë ndihmuar financiarisht 8 shoqata të personave me aftësi të kufizuara, me vlerë prej 22 000,00 €.

Janë ndihmuar me ushqime 34 familje me gjendje të rëndë sociale, në vlerë 50 – 100 €.

## **3. Shërbimi i strehimit**

Në Shërbimin e strehimit social janë parashtruar 115 kërkesa, prej tyre 40 kërkesa për rindërtim të shtëpive dhe 75 kërkesa për banim social. Janë lëshuar 51 rekomandime për AKP. Shërbimi për strehim social një kujdes të veçantë i ka kushtuar përkujdesjes dhe mbikëqyrjes së familjeve të strehuara përkohësisht në lagjen “ Fusha e Pajtit” në Prishtinë.

## **V. DREJTORATI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS**

Objektivat kryesore të punës së Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, kanë qenë:

- Angazhimi për realizimin e projekteve të ndryshme të ndërtimit, rindërtimit dhe meremetimit të objekteve të ndryshme shkollore të komunës së Prishtinës;
- Sigurimi dhe plotësimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës për vitin shkollor 2007/2008, në bazë të nevojave dhe të kërkesave nga drejtoritë e institucioneve arsimore dhe mbështetja për trajnimin e kuadrit udhëheqës dhe arsimor të institucioneve arsimore nga MASHT-i dhe organet tjera joqeveritare, KEC-i, etj.,
- Realizimi i aksionit tradicional “Garat e diturisë” në nivel komunal;
- Organizimi dhe realizimi i manifestimit “Garat e recitatorëve” në nivel komunal;
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit “Maturiada e Prishtinës 2007”;
- Sigurimi i udhëtimit për nxënësit e kl. IX dhe arsimtarët nga viset rurale;
- Sigurimi i lëndëve djegëse për sezonin dimëror, me anë të tenderëve të shpallur për dru, qymyr dhe naftë për nevojat e ngrohjes për objektet shkollore dhe punë të tjera të përditshme të kësaj drejtorie.

Realizimi i këtyre objektivave është bërë nga tri shërbime të veçanta, që veprojnë në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës, dhe nga stafi menaxhues i kësaj drejtorie.

## Ndërtimet dhe meremetimet

Gjatë vitit 2007, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës është angazhuar që t'i përmbushë objektivat, të cilat i ka përcaktuar me prioritet në planin operacional:

Renovimet e ndryshme

Projektet e realizuara:

1. Gëlqerosja e disa shkollove në komunën e Prishtinës – pjesa e parë.....337 442, 42 €
2. Gëlqerosja e disa shkollave në komunën e Prishtinës- pjesa e dytë.....28 015, 50 €
3. Renovimi i kulmeve dhe nyjave sanitare në disa shkolla të komunës së Prishtinës – pjesa e parë.....57 868, 30 €
4. Renovimi i kulmeve dhe nyjave sanitare në disa shkolla të komunës së Prishtinës – pjesa e dytë .....62 144, 25 €
5. Rregullimi i terrenit sportiv të gjimnazit “Sami Frashëri” .....20 189, 96 €
6. Fillimi i ndërtimit të shkollës fillore në Lagjen e Spitalit(përfundimi 2008)...512 874, 16 €
7. Fillimi i ndërtimit në lagjen “Vreshta” (përfundimi 2008).....290 750, 00 €
8. Ndërtimi i kulmit në ferracën e institucionit parashkollor “Gëzimi ynë” .....23 937, 00 €

## Zbatimi i reformës në arsim

Drejtoria ka vazhduar edhe më tej me punët për realizimin e reformës në arsim, duke i mbështetur dhe përkrahur nismat për reformat edhe në fushën e arsimit, përmes trajnimeve të ndryshme të arsimtarëve të të gjitha niveleve të arsimit. Në trajnime gjithnjë kanë marrë pjesë edhe një numër i zyrtarëve të arsimit të të gjitha niveleve.

Për sigurimin e kushteve sa më të mira për klasat: I, II, III,IV, VI, VII, VIII, X dhe XI, XII, XIII, Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, në bashkëpunim me MASHT-in, është angazhuar edhe për furnizimin e këtyre shkollave me inventar dhe mjete mësimore të konkretizimit.

## Mbikëqyrja e tërë sistemit arsimor komunal

Gjatë vitit kalendarik 2007 është bërë mbikëqyrja e zhvillimit të tërë sistemit arsimor komunal, në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtori me personelin e vet, Shërbimi për punë të përgjithshme administrative dhe Shërbimi i zyrtarëve arsimorë:

Sistemin arsimor të Komunës së Prishtinës e përbëjnë:

| Institu-<br>cionet | Num<br>ri | Mësimdhënës | Personeli<br>administrat<br>iv | Personeli<br>ndihmës | Gjithsej    | Numri i nxënësve |             |              |
|--------------------|-----------|-------------|--------------------------------|----------------------|-------------|------------------|-------------|--------------|
|                    |           |             |                                |                      |             | Shqip.           | Min.        | Gjithsej     |
| Parash<br>kolllore | 09        | 169         | 22                             | 100                  | 291         | 1504             | 373         | 1877         |
| Fillore            | 42        | 1597        | 89                             | 283                  | 1969        | 33250            | 1522        | 34772        |
| Të<br>mesme        | 12        | 864         | 43                             | 173                  | 1080        | 12295            | 1753        | 14048        |
| <b>Gjithsej</b>    | <b>63</b> | <b>2630</b> | <b>154</b>                     | <b>556</b>           | <b>3340</b> | <b>47049</b>     | <b>3648</b> | <b>50697</b> |

Gjatë vitit 2007 janë mbajtur 14 mbledhje me drejtorët e institucioneve edukativo - arsimore, në të cilat janë trajtuar çështje të ndryshme për mbarëvajtjen menaxhuese të punës edukativo-arsimore, në të gjitha nivelet e punës edukativo-arsimore, dhe janë dhënë udhëzime të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe obligimeve konkrete, në harmoni me trendin zhvillimor të arsimit në komunën e Prishtinës.

Nga drejtori i Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës dhe shefat e sektorëve, janë bërë mbi 200 vizita me karakter pune, në të gjitha institucionet shkollore të komunës së Prishtinës, të nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

### **Shërbimi i zyrtarëve arsimorë**

Zyrtarët e Arsimit të komunës së Prishtinës kanë bërë vizita të rregullta, të veçanta e kontrolluese në nëntë drejtoritë e institucionieve parashkollore, në 38 shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe, bashkë edhe me 23 paralele, në një shkollë speciale dhe në 12 shkolla të mesme.

Vizitat kanë qenë të fokusuara në mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke e kontrolluar në tërësi punën edukativo-arsimore me nxënës, vlerësimin e tyre, vijimin e mësimi, masat edukative, procedurën e pranimit të kuadrit mësimor, disiplina në punë, realizimi i planit dhe programit mësimor etj. Kujdes të veçantë i është kushtuar aplikimit të klasave I, II, III, IV, VI, VII, VIII, X, XI, XII dhe XIII dhe mënyrës së organizimit të procesit mësimor me këto klasa.

Përveç vizitave të rregullta, zyrtarët arsimorë kanë bërë edhe kontrollime të veçanta (50), 43 vizita kontrolluese dhe 54 kontrollime në bazë të ankesave të nxënësve, arsimtarëve, punëtorëve dhe të tjerëve.

Janë bërë edhe 18 vizita informative në shkollat fillore, 12 vizita informative në shkollat e mesme dhe shtatë vizita informative në nëntë drejtoritë e institucionit parashkollor.

Nga zyrtarët arsimorë janë përcjellë punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga MASHT-i dhe nga organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, për aftësimin e kuadrit dhe për realizimin e reformës shkollore.

### **Shërbimi i përgjithshëm administrativ**

Gjatë vitit 2007, Shërbimi i përgjithshëm administrativ ka kryer këto detyra dhe punë:

- shpërndarjen e listave të pagave për të gjitha institucionet edukativo - arsimore: parashkollore, fillore dhe të mesme,
- plotësimin dhe shpërndarjen e formularëve të ndryshëm për pagat e arsimtarëve dhe të punëtorëve të tjerë arsimorë,
- pranimin e faturave të ndryshme për shpenzime materiale dhe pagesa të tyre,
- takime pune me zyrtarët e UNMIK - ut lidhur me nevojat e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse për sezonin dimëror,
- përpilimin e planit financiar afatmesëm për vitin shkollor 2007/2008, për të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës,
- shpërndarjen dhe pranimin e aplikacioneve për vendet e lira të punës, në bazë të kërkesave të Drejtoratit të Arsimit dhe Shkencës,
- përpilimin e shkresave të ndryshme,
- shtypjen e materialeve të ndryshme dhe punën me palë.

### Shërbimi financiar për mallra dhe shërbime

Rekapitulim:

Fondi burimior 10

| <b>Lloji i shpenzimeve</b> | <b>Alokimet</b>     | <b>Shpenzimet</b>   | <b>Salldo</b>    |
|----------------------------|---------------------|---------------------|------------------|
| Pagat                      | 8.099.06,17         | 8.044.449,58        | 54.612,59        |
| M&SH                       | 578.444,98          | 577.135,60          | 1.309,38         |
| Komunalitë                 | 652.699,00          | 651.334,92          | 1.364,08         |
| <b>Gjithsej:</b>           | <b>9.330.206,15</b> | <b>9.272.920,10</b> | <b>57.286,05</b> |

Fondi burimor 21

| <b>Lloji i shpenzimeve</b> | <b>Alokimet</b>   | <b>Shpenzimet</b> | <b>Salldo</b>    |
|----------------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| M&SH                       | 825.000,00        | 741.238,41        | 83.761,59        |
| Komunalitë                 | 25.000,00         | 24.947,38         | 52,62            |
| <b>Gjithsej:</b>           | <b>850.000,00</b> | <b>766.185,79</b> | <b>83.814,21</b> |

Fondi burimor 22

| <b>Lloji i shpenzimeve</b> | <b>Alokimet</b> | <b>Shpenzimet</b> | <b>Salldo</b> |
|----------------------------|-----------------|-------------------|---------------|
| M&SH                       | 265.020,53      | 265.019,58        | 0,95          |

Fondi burimor 21 Investime kapitale

| <b>Lloji i shpenzimeve</b> | <b>Alokimet</b> | <b>Shpenzimet</b> | <b>Salldo</b> |
|----------------------------|-----------------|-------------------|---------------|
| Investime kapitale         | 1.426.000,00    | 1.054.688,42      | 371.311,58    |
| Të paalokuara              | 274.000         |                   |               |

### **Shërbimi financiar për mallra dhe shërbime**

- Është përpiluar raporti financiar për të gjitha nivelet e institucioneve shkollore dhe parashkollore të komunës së Prishtinës dhe ai u është ofruar të gjitha drejtorive të shkollave.
- Është menaxhuar me buxhetin e Drejtoratit të Arsimit dhe Shkencës të Komunës së Prishtinës.
- Janë mbajtur shënime dhe janë përcjellë të gjitha faturat për shpenzimet (përveç atyre kapitale), të mjeteve financiare për të gjitha shkollat dhe për institucionet parashkollore.

- Janë mbajtur shënime për të hyrat vetanake të shkollave dhe të institucioneve parashkollore.
- Është bërë zotimi i mjeteve financiare dhe është nxjerr gjendja e buxhetit të Drejtoratit të Arsimit dhe Shkencës.
- Organet kompetente komunale dhe të MEF-it, me kohë janë njoftuar me shkrim për problemet me të cilat po ballafaqohet Arsimi i Prishtinës.
- Me organet e lartshënuara janë mbajtur takime me qëllim të zgjidhjes së këtyre vështirësive.
- Është përpiluar “Propozimplani për buxhetin e Arsimit për vitin 2008”.
- Është përcjellë buxheti për paga të punëtorve të Arsimit.
- Janë marrë masa për largimin nga lista e pagave të gjithë punëtorët e Arsimit (punëtorët e arsimit të minoritetit serb), të cilët kanë realizuar të ardhura në kundërshtim me ligjin.
- Është sistemuar tërë dokumentacioni i nevojshëm dhe është ruajtur edhe në kompjuter.
- Janë përpiluar dhe janë plotësuar tabelat për analizën mujore të shpenzimeve .
- Është organizuar transporti për arsimtarë dhe nxënës të klasave të nënta nga qendrat lokale për në Prishtinë dhe anasjelltas.
- Është bashkëpunuar me kontrollin financiar të MEF-it.
- Kemi marrë pjesë në kontrollin financiar të disa shkollave dhe të institucionit parashkollor.
- Është proceduar për tenderim në Zyrën e prokurimit, për furnizimin e shkollave me material higjienik, material për ujë, material elektrik, material didaktik, rekuizita sportive etj.

Mënyra e inkasimit të mjeteve vetanake të institucionit parashkollor dhe të shkollave që realizojnë mjete nga qiraja, ka qenë në mbikëqyrje financiare të Sektorit të shërbimit financiar.

- Janë vizituar dhe është biseduar me njerëzit kompetentë (të ndërmarrjeve, të cilët i kryejnë shërbimet komunale), me qëllim që, eventualisht, një pjesë e borxheve të vjetra të shlyhen ose pagesa e tyre të bëhet me këste.
- Janë kryer edhe shumë punë të tjera, ku vlen të theksohet se bashkëpunimi me organet kompetente financiare të Komunës dhe me ato të MEF-it është në nivel.

### **Sigurimi i kuadrit mësimor dhe mbështetës**

Në bashkëpunim me MASHT-in dhe me drejtoritë e shkollave, pos me konkurse të rregullta, kuadrin edukativo-mësimor dhe mbështetës, për të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Prishtinës, e kemi siguruar edhe përmes pranimi për zëvendësime.

Problemet me të cilat është ballafaquar ky sektor:

Mungesa e kuadrit të kualifikuar në shkollat fillore, për lëndët mësimore: gjuhë angleze dhe kulturë muzikore, si edhe mungesa e kuadrit arsimor për shkollat e mesme për lëndën e matematikës dhe për lëndët profesionale, si inxhinierë të profileve të ndryshme, etj. Gjendja më e vështirë me kuadër të kualifikuar është në shkollat e fshatrave, sidomos të atyre të largëta në Malësinë e Gollakut, ku është dashur të angazhojmë personel arsimor të pakualifikuar të vendit.

Tani, kur kemi siguruar transportimin e nxënësve nga pothuajse të gjitha vendbanimet rurale, është krijuar mundësia për transportimin e arsimtarëve nga Prishtina në shkollat rurale, me çka shpresojmë se do të përmirësohet struktura kualifikuese e kuadrit arsimor. Probleme të veçanta na paraqiten me rastin e zëvendësimit të punëtorëve, të cilët shkojnë në pushime mjekësore të shkurtra, p.sh. për një ose dy javë, nga se punëtorët arsimorë që kërkojnë punësim, nuk tregojnë interesim për t'u angazhuar për kohë të shkurtër. Një gjë e tillë krijon vështirësi edhe për futjen e punëtorëve të tillë në sistemin e pagesave. Këto janë reflektuar drejtpërdrejt në çrregullimin e procesit normal edukativo-arsimor.

### **Mbështetja e trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor**

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe trajnimit të kuadrit udhëheqës dhe arsimor, i cili është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, në frymën e reformave arsimore që po bëhen në Kosovë.

Gjatë periudhës prill-maj-qershor, gjatë sezonit veror, por edhe gjatë muajve shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2007, janë mbajtur seminare për trajnim të arsimtarëve dhe të stafit udhëheqës të shkollave, të udhëhequra nga MASHT-i, e të mbështetura nga Drejtorati i Arsimit dhe i Shkencës, në realizim të KEDP-së dhe të KEC-it.

Seminare për trajnimin e arsimtarëve ka organizuar edhe Shoqata finlandeze për punë me fëmijë me nevoja të veçanta.

### **Realizimi i "Garave të recitatorëve", "Garave të diturisë" në nivel komunal**

Në kuadër të planit të punës që ka bërë drejtoria, janë realizuar edhe këto aktivitete: "Gara e recitatorëve", "Gara e diturisë" (në tetë lëndë mësimore), në 35 shkolla fillore; zgjedhja e nxënësit, paraleles, mësuesit, arsimtarit, profesorit dhe edukatores më të mirë të të gjitha niveleve edukativo-arsimore komunale. "Gara e diturisë" dhe "Garat e

Recitatoreve" janë mbajtur në muajin maj 2007. Këtë vit, për dallim nga vitet tjera, është mbajtur "Gara e diturisë" për klasat X të shkollave të mesme, në lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe informatikë.

Shpallja e rezultateve, ndarja e diplomave, e mirnjohjeve dhe e dhuratave modeste është bërë me rastin e Ditës së Çlirimit të Prishtinës, më 11.6.2007. Me rastin e kremtimit, në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike të Komunës së Prishtinës, janë organizuar gara sportive në nivel të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës, në: futboll, basketboll, hendboll, tenis dhe atletikë. Finalet janë mbajtur me rastin e kremtimit dhe më të mirët janë shpërblyer me kupa, medalje dhe diploma. Gjatë muajit shtator nga drejtoria është bërë organizimi dhe realizimi i ekskursioneve në Shqipëri me maturanët e shkollave të mesme, dhe organizimi i ekskursioneve të shkollave fillore dhe të mesme në territorin e Kosovës.

Pos kësaj, drejtoria ka mbështetur bashkëpunimin e disa shkollave fillore dhe të mesme, të binjakëzuara me shkollat simotra të Shqipërisë dhe të vendeve tjera evropiane.

Kemi pasur bashkëpunim me OQ-të dhe OJQ-të për realizimin e projekteve të tyre nëpër shkolla. Drejtoria ka bashkëpunuar me organizatat qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e projekteve të ndryshme për parandalimin e dukurive negative të nxënësve, si me Departamentin e të Drejtave të Njeriut, Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës, Sektorin për të Drejtat e Fëmijëve, Klubin për të Drejtat e Njeriut "Fëmijët për të Drejtat e Tyre", Teatrin e të Rinjve të Prishtinës, Qendrën e Pionierëve etj.

## **Organizimi - përvoja dhe perspektiva**

Është bërë edhe organizimi i brendshëm profesional dhe kadrovik në kuadër të Drejtoratit të Arsimit dhe të Shkencës.

Pas miratimit të Ligjit mbi shkollimin fillor dhe të mesëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë më të qartësuara, ndonëse ka vend për koment lidhur me atë se çka është ekskluzivisht kompetencë dhe përgjegjësi e Komunës, e çka e MASHT-it. Disa çështje të cilat nuk janë përkufizuar krejtësisht me ligj, rregullohen me udhëzime administrative nga MASHT-i.

Do theksuar, veçanërisht për përgjegjësitë dhe kompetencat në relacion MASHT – Zyrë Rajonale – DKA.

Problem në vete ishte edhe mungesa e rregullave, të cilat do të kishin përkufizuar të drejtat, detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe të nxënësve në institucionet arsimore, sidomos Rregullorja mbi disiplinën dhe masat disiplinore ndaj punëtorëve arsimorë, administrativë, dhe Rregullorja për masat disiplinore ndaj nxënësve. Shumë prej këtyre rregulloreve janë përpiluar dhe janë vënë në zbatim.

Kërkohej që në të ardhmen, të shtohet angazhimi dhe efikasiteti në procesin e prokurimit për çështje të ngutshme të intervenimeve në sanimin e avarive të ndryshme të sistemit të ngrohjes, sanitarisë, kanalizimit, e të tjera.

Një problem që po manifestohet në praktikë, është mospërkufizimi institucional i përgjegjësiave të drejtorëve të shkollave, me që sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga MASHT-i, kurse pagat merren nga Komuna, së bashku me të gjithë punëtorët tjerë arsimorë, kështu që ka neglizhim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me ligj. Prandaj, është me interes që të përcaktohet më mirë, me amandamente ligjore, statusi i drejtorëve të shkollave.

## **VI. DREJTORATIT I KULTURËS DHE GJINISË**

Të gjitha projektet e realizuara gjatë vitit 2007, nga Drejtoria i ka të konceptuara në Sektorin për kulturë, dhe atë për çështjet sociokulturore apo gjinore, siç është e caktuar me rregulloret e UNMIK-ut.

### **1. SEKTORI I KULTURËS**

Në Sektorin e kulturë i kemi kategorizuar të gjitha projektet kulturo-artistike të cilat i ka realizuar vet drejtoria, projektet kulturo-artistike që janë realizuar në bashkëpunim me institucionet dhe OJQ-të dhe projektet kulturo-artistike të cilat janë realizuar në institucionet varëse të Komunës së Prishtinës, të cilat i subvencionon dhe i kontrollon drejtoria, si: Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, TFKR “DODONA”, Arkivi i Qytetit, Instituti i Monumenteve, Biblioteka “Hivzi Sylejmani” dhe Shtëpia e Kulturës në Graçanicë.

Projektet e drejtorisë nga Sektori i kulturës, duken sa vijon :

- investimet kapitale,
- veprimtaria botuese ,
- përkrahja financiare e institucioneve të kulturës dhe grupeve artistike të Prishtinës,

- përkrahja finasiare e shoqatave dhe asociacioneve tjera kulturore: veprimtari letrare, filmike, teatrore, artet pamore etj.,
- promovimet artistike dhe shënimi i datave të rëndësishme historike dhe kulturore.

Projektet e realizuara nga institucionet e kulturës, që kanë punuar dhe vepruar në kuader të Drejtoratit të Kulturës dhe Gjinisë:

- Teatri "DODONA",
- Biblioteka Publike e Qytetit " Hivzi Sylejmani",
- Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës,
- Arkivi i Historik i Qytetit
- Instituti i monumenteve dhe
- Shtëpia e Kulturës në Graçanicë.

Investime kapitale janë bërë në:

- Qendrën kulturore dhe rekreative të fëmijëve në Parkun e Gërmisë, në vlerë prej ..... 235 000, 00 €
- Hamamin e Madh të Prishtinës, me vlerë prej ..... 87 000, 00 €
- Arkivin Historik të Prishtinës, një donacion nga Agjencioni Evropian për Rindertim, në vlerë prej..... 600 000 €

Në kuadër të veprimtarisë botuese janë përkrahur 30 projekte për botimin e 30 titujve të rinj dhe Panairi i librit KOSOVA 2007.

U përkrahën të gjitha institucionet e kulturës që veprojnë në Prishtinë: Teatri "Dodona", Biblioteka e qytetit "Hivzi Sylejmani", Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës , Arkivi Historik i Qytetit, Instituti i Monumenteve, SHKA "Bajram Curri", SHKA "Minatori i ri", SHKA " Qamili i Vogël", Shoqata e rapsodve "Hivzi Sylejmani", SHKA "Malësia e Gollakut", Kori "Xixëllonjat", Teatri i të Rinjve të Qytetit, SHKA "Gerçek", SHKA "Svetlujuqi Biseri", studio e baletit "Mjellmat", Studio e baletit "Rudina" , etj.

Drejtoria ka përkrahur Shoqatën e Artistëve Figurativë dhe Aplikativë të Kosovës, Artqendren e Prishtinës, Teatrin Kombëtar (Festivalin Ndërkombëtar "Kosova Infest"), Teatrin "ODA", OJQ "Qendra e Re e Muzikës Bashkëkohore", OJQ "Ars-Kosova", OJQ "Rok për Rok", OJQ "Kamerfest", "Skena UP", Koalicioni i Grave të Kosovës etj.

Janë shënuar të gjitha datat e rëndësishme historike, kulturore dhe janë bërë disa promovime artistike: Dita e Prishtinës, 2 Korriku, Dita e Dëshmorëve të Prishtinës, festat e fundëvitit, Ylberi i Prishtinës, Dita e Pavarësisë së SHBA-së, Dita e Flamurit , Ditëlindja e ish-kryetarit të SHBA-së, Bill Clinton, 20-vjetori i vdekjes së kryetarit më të suksesëshëm të Prishtinës, z. Nazmi Mustafa etj.

Institucionet e kulturës i kanë realizuar të gjitha projektet e veta të parapara për vitin 2007.

Teatri "Dodona" gjatë vitit 2007, ka realizuar 4 premiera në skenën për të rinj dhe atë: "Burrat e dëshpruar", janar 2007, "Të paftuarit", shkurt 2007, "Në terr po, në dritë jo", prill 2007, "Zbutja e Kryeneqës", nëntor 2007 dhe 190 repriza.

Skena e kukullave dhe fëmijëve ka realizuar tri premiera dhe atë: "Vjollca magjike" nga Rifat Kukaj, "Vëllezërit dhe motrat" nga Melihate Qena, "Korbi i zi, korbi i bardhë" nga Hivzi Sylejmani dhe mbi 130 repriza të këtyre shfaqjeve.

Teatri "Dodona", pos premierave, ka reprizuar edhe shfaqjet nga viti 2006, "Sekretet e dashurisë", "Kush vjedhë një këmbë ka fat në dashuri", "Vdekja troket", "Malli i kurbetit" etj. Sipas statistikave të dhëna gjatë vitit 2007, shfaqjet i kanë përcjellur mbi 11 354 shikues. Ky teatër ka marrë pjesë në pesë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës ka bërë mbi 20 promovime të ndryshme, si koncerte, pjesëmarrje në festivale, organizime të ekspozitave dhe manifestime tjera.

Veprimtaria e Qendrës vlenë të dallohet, sidomos me organizimin e përkujtimeve për personalitetet të shquara nga historia dhe kultura jonë, kremtimi i datave të ndryshme historike dhe organizimi i Festivalit ndërkombëtar për fëmijë "Ylberi i Prishtinës".

Instituti i Monumenteve ka realizuar 2 projekte nga trashëgimia arkeologjike dhe një nga trashëgimia ndërtimore historike. Ka përcjellë me kujdes fillimin e konsolidimit të Hamamit të Madh.

Instituti punon në kushte jashtëzakonisht të veshtira, sepse objekti ku është i vendosur ky institut, është shumë i vjetëruar.

Arkivi i Qytetit e ka realizuar programin e vetë 87%.

Është përpunuar lënda arkivore e Gjyqit të Qarkut të Prishtinës 1945 - 63, lëndët kontestimore (46 kuti me 6 467 lëndë), Gjykata Komunale e Prishtinës, 1964 -1983, (143 kuti me 7572 lëndë), KNI "Ramiz Sadiku", 2 787 lëndë, Gjykata e Rrethit të Prishtinës, 1945-1963 (47 kuti me 4 443 lëndë jokontestimore).

Biblioteka "Hivzi Sylejmani" gjatë kësaj periudhe, ka përmbush objektivat e veta nga të gjitha veprimtaritë e parapara për vitin 2007. Ka bërë klasifikimin, katalogizimin dhe revizionin në bibliotekën e Slivovës, të Hajvalisë dhe të Bardhoshit. Në menyrë të rregullt ka koordinuar punët me bibliotekat tjera komunale në Kastriot, Fushë Kosovë, Drenas, Lipjan dhe Podjevë. Ka organizuar trajnime dhe seminare të ndryshme në Prishtinë dhe jashtë saj.

Kaplinë e veçantë është pasurimi i fondit të librit .

Me përkrahjen financiare të KK-së së Prishtinës, përkatësisht të Drejtoratit të Kulturës dhe Gjinisë, janë blerë 665 tituj librash me 2 376 ekzemplarë, ndërsa nga donatorët apo dhuruesit ka ardhur edhe një sasi e konsiderueshme titujsh. Biblioteka ka kryer edhe këto shërbime: ka bërë inventarizimin në 2 728 ekzemplarë, i ka klasifikuar 726 tituj, ka bërë katalogizimin e 405 titujve, ka regjistruar 4 845 anëtarë të rinjë, gjatë vitit janë lexuar 7 779 libra, janë regjistruar 8 1421 shfrytëzues të sallave të leximit. Biblioteka ka organizuar 8 takime me krijues , 29 ekspozita dhe 968 komentime.

Gjatë vitit të kaluar në sallat e Bibliotekes “Hivzi Sylejmani”, janë realizuar edhe shumë aktivitete kulturore, takime me shkrimtar, orë letrare, promovime, ekspozita, etj. Duhet theksuar se drejtoria vitin e kaluar ka furnizuar me libra edhe dy biblioteka shkollore. Shkolla fillore “Dardania” ka përfituar 3 000 €, të njëjtën shumë ka përfituar edhe Shkolla fillore në Besi.

Shtëpia e Kulturës në Graçanicë ka zhvilluar një aktivitet të konsiderueshëm. Të gjithë sektorët që funksionojnë, duke filluar nga bibliotekat, grupet artistike, ekspozitat, manifestimet dhe promovimet e ndryshme me karakter kulturor dhe artistik, kanë lënë gjurmë në këtë drejtim. Kjo ishte deri atëherë kur organet shtetërore të Sërbisë i kanë urdhëruar punëtorët e kësaj qendre kulturore që të ndërpresin bashkëpunimin dhe të refuzojnë pagat nga Komuna e Prishtinës.

## 2. SEKTORI I GJINISË

Në këtë sektor janë realizuar parametrat e paraparë për vitin 2007, duke realizuar projekte të natyrave të ndryshme, që kishin për qëllim avansimin e femrës në shoqërinë bashkëkohore. Me projektet e realizuara është synuar që të bëhet ngritja, integrimi dhe fuqizimi i saj në strukturat vendimmarrëse, të cilat mundë të realizohen nëse nëpunësit civilë kanë njohuri dhe shprehje specifike për të bërë analiza në një këndvështrim gjinor. Njohuritë dhe shprehjet e tilla mundë të ndërtohen përmes trajnimeve specifike, duke kombinuar teorinë me praktikën, e që përqojnë njohuritë e reja të projektuara nga nëpunësit civilë, me qëllim të ndërmarrjes së analizave dhe politikave nga këndvështrimi gjinor. Mu për këtë, ky sektor ka realizuar dhjetë projekte shumë efektive me temat që vijnë:

*“SA I NJIHNI TË DREJTAT E NJERIUT, NË VEÇANTI TË FEMRAVE”, “FMIJËT QË PUNOJNË PUNË FIZIKE” (HULUMTIM) “STOP DUKURIVE DEVIJANTE”, “UDHËHEQJA E BAZUAR NË VLERA”, “FESTIVALI I ARTIZANATEVE TË KOSOVËS”, “FUQIZIMI I GRUAS NË SHOQËRI”, “DHUNA NË BAZA GJINORE”, “ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË VAJZAVE NË QEPJE DHE QËNDISJE”, “TI NDIHMOJMË GRATË KRYEFAMILJARE”.*

Këto janë dhjetë projekte të organizuara dhe të realizuara nga Drejtorati i Kulturës dhe Gjinisë, në bashkëpunime me dhjetë organizata joqeveritare që veprojnë në Prishtinë.

Në vazhdim po paraqesim projektet e realizuara dhe shumën e mjeteve të shpenzuara për jetësimin e tyre.

### Investimet kapitale

|                                                          |              |
|----------------------------------------------------------|--------------|
| Qendra Kulturore dhe Rekreative e Fëmijëve në Gërmi..... | 235 000,00 € |
| Hamami i madh .....                                      | 88 000,00 €  |

### Projektet tjera

|                                      |             |
|--------------------------------------|-------------|
| Pasurimi i fondit të librit .....    | 13 000,00 € |
| Veprimtaria botuese (30 tituj).....  | 22 320,00 € |
| Veprimtaria filmike .....            | 16 500,00 € |
| Grupet artistike .....               | 9 800,00 €  |
| Artet pamore .....                   | 11 500,00 € |
| Projektet nga Sektori i gjinisë..... | 7 200,00 €  |

|                                                                        |              |
|------------------------------------------------------------------------|--------------|
| Festivalet, promovimet, datat historike, festat e fundëvitit, etj..... | 132 952,00 € |
|------------------------------------------------------------------------|--------------|

---

Gjithsej      536 272,00 €

## VII. DREJTORATI I RINISË DHE SPORTIT

Sektori për Rini dhe Sport gjatë vitit 2007, ka punuar në realizimin e politikave programore të Drejtirisë, ku në tërësi janë respektuar procedurat e bashkëpunimit me Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera komunale.

Në vitin 2007 të gjitha projektet rinore – sportive, kanë pasur përkrahje të nevojshme buxhetore dhe me kohë janë rumbullakuar procedurat financiare. Në vitin raportues ka pasur përparim në zhvillimin e aktiviteteve tona, sepse është ngritur një infrastrukturë e qëndrueshme ligjore në Sport dhe Rini. Është funksionalizuar Ligji për sport dhe janë mbajtur shumë debate dhe tryeza për zhvillimin e plotë shoqëror të rinisë të artikuluar në “Planin Kosovar të Veprimit për Rini në periudhën 2007 – 2010”. Bashkëpunimi ynë me institucione sportive dhe rinore të sektorëve qeveritarë dhe atyre joqeveritarë, ka qenë i hapur dhe konstruktiv, gjë që ka ndikuar në thellimin e punës së përbashkët dhe kreative me të gjithë faktorët relevantë në zhvillimin e sportit dhe çështjeve rinore.

Në vazhdim do të jepet pasqyra kryesore e punës, e ndarë në sektorë:

### a) SEKTORI I SPORTIT

Deri në fund të vitit 2007, janë evidencuar 67 klube publike: 17 klube të karatesë, 7 klube të futbollit, 2 klube të ping-pongut, 1 klub i hendbollit, 3 klube të basketbollit, 3 klube të shenëjtarisë, 2 klube të notit, 2 klube të mundjes, 2 klube të shahut, 3 klube të çiklistëve, 1 klub i bodibildingut, fitnesit dhe i aerobisë, 1 klub i boksit, 2 klube të “kick”-boksit, 2 aeroklube, 1 klub i skitarisë, 1 klub i atletikës, 3 klube të xhudos, 1 klub i “tekvandos”, 1 shoqatë për kultivimin dhe mbrojtjen e pëllumbave dhe 1 shoqatë e peshkatarëve, 3 klube sportive private – shoqëri aksionare : klubi i futbollit “Prishtina”, klubi i basketbollit “AS-Prishtina” dhe klubi i volejbollit “Mabetex”, i cili ka ndërruar statusin e regjistrimit të tij si klub publik, 2 shkolla të basketbollit “Prishtina Pro Basket” dhe “Eurobasket”. Klubet e Prishtinës në të gjitha degët sportive, kanë rezultate të konsiderueshme, në garat kampionale dhe për kupë, janë vazhdimisht fitues, ose janë në pozita të larta klasifikuese. Përkundër faktit se Pallati i Rinisë dhe i Sporteve nuk është në kompetencë të Komunës, falë raporteve të mira me Bordin udhëheqës të Pallatit, është arritur që shumë klube sportive t’i zhvillojnë stërvitjet dhe garat në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve.

Sektori i sportit ka punuar sipas kriterëve profesionale, për të thelluar dhe ndihmuar punën profesionale dhe organizative të klubeve dhe shoqatave të ndryshme sportive. Këto kriterë kanë qenë të harmonizuara me politikat tona programore, të cilat janë fokusuar në:

- masivizimin e sportit,
- organizimin e klubeve, bazuar në ligjin për sport,
- ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive,
- ndërkombëtarizimin e sportit,
- bashkëpunimin me MKRS dhe ÇJR – Departamenti i Sportit,
- organizimin e manifestimeve tradicionale sportive për data të rëndësishme dhe ndihma klubeve sportive publike,
- zhvillimin e sportit për minoritete,
- integrimin e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive,
- zhvillimin e sportit për femra dhe
- ngritjen profesionale të kuadrove sportive dhe begatimin me literaturë profesionale – shkencore nga lëmi i sportit.

Periudha raportuese karakterizohet me investime të konsiderueshme në ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive. Këtu përfshihet finalizimi i ndërtimit të dy fushave sportive në fshatin Mramuer dhe Grashticë dhe ndërtimi i fushës së lodrave për fëmijë në lagjen “Ulpiana”, si dhe fillimi i ndërtimit të terrenit sportiv në fshatin Llukar.

## **b) SEKTORI I RINISË**

Në bashkëpunim me OJQ-të rinore dhe të rinjtë e Prishtinës, Sektori i rinisë ka nxjerrë planin e punës për vitin 2007. Këto politika pasqyrojnë kahet e punës së përbashkët të drejtorisë dhe të rinjve të qytetit, për të potencuar dhe ngritur vetëdijen institucionale për angazhimin e të rinjve në të gjitha sferat shoqërore. Gjatë implementimit të projekteve të dobishme për të rinj, kemi bashkëpunuar me MKRS-në – Departamenti i Rinisë, organizata rinore dhe strukturat tjera institucionale dhe shoqërinë civile, të cilat në programet e tyre kanë punën me të rinj. Ndër projektet e shumta të realizuara me të rinj, veçojmë : shënimin e “Ditës Ndërkombëtare të të Rinjve” – 12 gusht, administrimin e “SIP – Fondit” për rajonin e Prishtinës - fond i ndarë nga OJQ gjermane “GTZ”, dhe përkrah projektet e grupeve të marginalizuara të të rinjve, që ka karakter rajonal, debatin me të rinjtë e qytetit në temat “Vetëdijesimi i të rinjve mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore”, “Vetëdijesimi i të rinjve kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, “Luftimi i dukurive devijuese ndër të rinj”. Në këtë vit puna profesionale në Sektorin e rinisë, më shumë është vërejtur në projektin “Muaji i Rinisë 2007”, i cili është tradicional dhe përfshinë aktivitete rinore njëmuore në të gjitha komunat e Kosovës, dhe realizohet në bashkëpunim me MKRS-në - Departamentin e Rinisë. Ky projekt në Prishtinë manifestohet me promovim dhe prezantim të punës së OJQ-ve rinore dhe sensibilizon opinionin për përkujdesje më të madhe ndaj vlerave dhe problemeve, të cilat preokupojnë rininë e qytetit tonë. Drejtoria e Rinisë dhe e Sportit ka arritur që të angazhojë në tërësi potencialin e madh kreativ të rinisë së Prishtinës dhe për këtë qëllim është shpërblyer nga MKRS-ja.

Në Sektorin e rinisë politikat programore në përgjithësi janë të përmbledhura në :

- Promovimin e vullnetarizmit;
- Integrimin e grupeve të marginalizuara të të rinjve;
- Fuqizimin e organizatave rinore – rrjetet rinore, qendrat rinore dhe OJQ-të rinore;
- Ndërtimin dhe renovimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- Luftimin e dukurive devijuese ndër të rinj dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Buxheti i drejtorisë për vitin 2007 është shpenzuar për ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sportive, mbështetjen financiare të klubeve sportive dhe të OJQ-ve rinore, dhe mbajtjen e aktiviteteve tradicionale të sportit dhe të rinisë. Projektet të cilat janë realizuar financiarisht nga Drejtoria e Rinisë dhe e Sportit, janë:

1. Projektimi dhe ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Llukar dhe i fushës së lodrave në lagjen “Ulpiana” në Prishtinë..... 108 967,00 €
2. Organizimi i aktiviteteve sportive - rinore për “Ditën e Prishtinës 2007” ..... 5 350,00 €
3. Realizimi i projektit tradicional për të rinj “Muaji i Rinisë 2007” .....8 260,00 €
4. Përkrahje 30 klubeve sportive - publike të komunës me mjete financiare .....56 450,00 €

- |                                                                                                                                                                  |             |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
| 5. Realizimi i projekteve për të rinj.....                                                                                                                       | 11 985,00 € |
| 6. Turneu në futboll të vogël “Dita e Flamurit 2007” dhe organizimi i garave sportive për persona me aftësi të kufizuar në kuadër të “Olimpiadës speciale” ..... | 1 500,00 €  |
| 7. Gjysmëmaratona në atletikë “Prishtina 2007” .....                                                                                                             | 2 500,00 €  |

## **VIII. DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE I NDËRTIMTARISË**

### **I.SEKTORI I PLANIFIKIMIT**

Punët dhe detyrat në aspektin e planifikimit, Sektori i ka përqëndruar kryesisht në:

1. Përgatitjen dhe hartimin e planeve të reja rregulluese;
2. Realizimin e planeve të miratuara;
3. Caktimin e lokacioneve për komplekse dhe objekte të natyrave të ndryshme;
4. Përpilimin dhe lëshimin e lejeve urbane sipas kërkesave.

#### **1.Përgatitja dhe hartimin i planeve të reja rregulluese**

- Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues për lagjen “Sofali”,
- Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues për lagjen “Lakërishta”,
- Vendimi për miratimin e Planit rregullues “Mati 3”,
- Vendimi për miratimin e Planit rregullues për lagjen “Sofalia” dhe
- Vendimi për miratimin e Planit rregullues për lagjen “Lakërishta”.

#### **Plani rregullues “Sofalia”**

Kjo lagje kufizohet në veri me Unazen e mbrendshme, në perendim me lagjen “Vreshta”, në jug me lagjen e “Matit” dhe në lindje me unazen e ardhshme të brendshme, parkun e Prishtinës dhe pishinën e Prishtinës, me një sipërfaqe prej 250 ha.

#### **Plani rregullues “Lakërishta”**

Lagja shtrihet në pjesën verilindore të qytetit të Prishtinës, nga ana veriore kufizohet me lagjen “Qafa”, në anën lindore me lagjen “Pejton”, në anën veriperëndimore me hekurudhën dhe në anën Juglindore me lagjen “Dardania”, me një sipërfaqe prej 58.5 ha.

Kjo lagje karakterizohet me llojllojshmërinë e objekteve ekzistuese, siç janë: Pallati i Shtypit, Pallati i Rinis dhe i Sporteve, Stadiumi i Qytetit, Objekti i Pavarësisë. Bazë për zhvillimin e këtij plani rregullues do të jetë Plani strategjik zhvillimor i qytetit të Prishtinës.

#### **Plani rregullues “Mati 3”**

Kjo hapësirë shtrihet në lindje të lagjes “Mati 1”, respektivisht vazhdim i fshatit Matëçan dhe do të quhet Lagja “Mati 3”, me një sipërfaqe prej 42.95.60 ha, e destinuar kryesisht për banim individual dhe me përmbajtje tjera përcjellëse, me një standard të lartë të banimit dhe me mundësi të shfrytëzimit të etazhitetit përdhës për afarizëm. Duke pasur parasysh konfiguracionin e terrenit, është hartuar edhe projekti për infrastrukturën

rrugore, ndarje në 17 blloqe të banimit dhe 2 blloqe me përmbajtje të nevojshme për fshatin Mat (gjelbërim, terrene sportive dhe sipërfaqe tjetër publike).

## **2. Plotësimi dhe ndryshimi i vendimeve që kanë të bëjnë me planet rregulluese.**

- Vendimi i plotësimit të dispozitave lidhur me realizimin e Planit rregullues të lagjes “Tophane”,
- Vendimi për ndryshimin e Vendimit për fillimin e Planit rregullues të lagjes “Dukagjini dhe Muhagjirët”,
- Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore,
- Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komnale 01. nr. 413 -523, të dt. 2.4.2002 – pjesa për rregullimin e tokës ndërtimore, 01 nr. 413 – 317, të dt. 30.6.2006,
- Propozimvendimi për caktimin e kriterëve dhe procedurat për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim.

## **3). Caktimi i lokacioneve**

Për objekte me destinime të caktuara, e në bazë të kërkesave dhe programeve urbane - arkitektonike, janë hulumtuar dhe përcaktuar lokacione adekuate, janë kryer incizime në terren, janë konsultuar planet ekzistuese urbanistike dhe organet ekzekutive kompetente të Komunës lidhur me statusin pronësor-juridik të atyre lokacioneve, janë përgatitur prezantimet grafike, në bazë të të cilave janë nxjerrë propozimvendimet të cilat janë prezantuar për shqyrtim në Bordin e drejtorëve, Komitetin për Planifikim Urbanizëm dhe Ndërtim, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal.

Në bazë të këtyre vendimeve dhe kërkesave, drejtorja ka përgatitur kushtet urbanistiko - teknike për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, të domosdoshëm për procedurë të mëtejme.

Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve, për të cilat ka qenë investitor Komuna, janë përgatitur materialet, detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tendereve, me pjesëmarrje në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe është bërë menaxhimi i realizimit - ndërtimit të këtyre objekteve nga personeli -shërbyesit civilë profesionalë të kësaj drejtorie.

Propozimvendimi për caktimin e lokacioneve:

- o për vendosjen e trafos 10 KV;
- o për Qendrën për Arsim në Graçanicë;
- o për “Sheshin e Pavarësisë - Ibrahim Rugova”;
- o për “Sheshin e Lirisë - Adem Jashari”;
- o për Shoqatën Ndërkomunale të të Verbërve;
- o për shkollën fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit “Preng Jakova” në Prishtinë;
- o për Shkollën Speciale në lagjen “ Kalabria”;
- o për Shërbimin Policor të Kosovës;
- o për Selinë e LDK-së;
- o për QMF-në në fshatin Hajvali;
- o për ngritjen e lapidarit të ish-presidentit të SHBA –së, Bill Clinton;
- o Hulumtimi i lokacionit për Zyrën amerikane;
- o Hulumtimi i lokacionit për Zyrën angleze;
- o për caktimin e lokacionit për Zyrën turke.

## II. URBANIZMI

Gjatë periudhës raportuese, drejtorisë i kanë arritur 818 kërkesa , dhe të bartura nga viti paraprak kanë qenë 55 kërkesa, nga rezulton se gjatë vitit raportues kanë qenë 873 kërkesa, te ushtruara nga persona fizikë dhe juridikë.

Përmbajtja e kërkesave ka qenë kryesisht:

- Caktimi i lokacioneve, lëshimi i lejeve urbanistike për caktimin e kushteve urbanistiko - teknike, leje ndërtimore, vendosja e objekteve të përkohshme, informacione për destinimet e sipërfaqeve në planet përkatëse urbanistike, për rrënimin e objekteve ekzistuese, lëshimin e vërtetimeve për dëmet e shkaktuara nga lufta, ndërrimin e destinimit të përdorimit të objekteve ekzistuese, kompetnce që buron nga Ligji për ndërtimet.

Vendosja e kërkesave është bërë në bazë të vendimeve, konkluzioneve përfundimtare e disa të tjera, janë vendosur në bazë të informacioneve, përgjigjeve, lëshimit të vërtetimeve, si mundësi e paraparë në procedurën administrative.

Numri i kërkesave të arritura, mënyra e zgjidhjes së tyre dhe atyre në procedurë, në mënyrë tabelare duket si më poshtë.

| 1                                      | 2                                 | 3                                        | 4            | 5            |
|----------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------------|--------------|--------------|
| Të arritura gjatë periudhës raportuese | Të bartura nga periudha paraprake | Gjithësej për punë gjatë vitit raportues | Të zgjidhura | Në procedurë |
| 818                                    | 55                                | 873                                      | 753          | 120          |

| 1            | 2                       | 3               | 4                                  | 5             | 6        |
|--------------|-------------------------|-----------------|------------------------------------|---------------|----------|
| Të zgjidhura | Leje,kushte urbanistike | Leje ndërtimore | Informacione Konkluzione vërtetime | Hedhur poshtë | Refuzuar |
| 753          | 91                      | 59              | 256                                | 6             | 176      |

## III. NDËRTIMI

### a). Detyrat projektuese dhe përciellja e projekteve

Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur detyrat dhe programet projektuese për hapjen e tenderëve nga përgjegjësia e kësaj drejtorie, si p.sh.

Përciellja e projektit të rrugës unazore “Unaza e jashtme”

Detyrat projektuese për rrugët e qytetit dhe rrugët rurale:

- vlerësim i tenderit për lagjen “Dukagjini”,
- hapja e tenderit për Planin rregullues të lagjes “Dardania”,
- hapja e tenderit për fasadimin e objektit të Kuvendit të Komunës në lagjen “Arbëria”,
- vlerësimi i Planit rregullues të lagjes “Dardania”,
- renovimi i kulmeve dhe nyjave sanitare të disa shkollave të komunës së Prishtinës,
- punimi i paramasës për asfaltim të rrugës në Keqekollë,
- takim me zyrtarët e KEK-ut për gjendjen ekzistuese të lagjeve, të cilat janë duke u punuar planet rregulluese,
- takim në MTPT për “Unazën e jashtme”,
- mbajtja e disa takimeve zyrtare me përfaqësuesit me palë për informime dhe
- janë mbajtur disa takime me hartuesit e blloqeve urbane: “Kalabri” , “Arbëri “ etj.

**b). Vendosja sipas kërkesave për pranimin teknik të objekteve dhe lejimi i tyre për shfrytëzim**

Në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi, pas përfundimit të ndërtimit, investitori është i obliguar që të pajiset me leje përdorimi dhe shfrytëzimi, e cila leje mund të lëshohet vetëm pas kontrollimit teknik nga komisioni profesional, i formuar nga organi që ka lëshuar lejen për ndërtim, kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe i janë paraqitur kërkesa për caktimin e komisionit profesional për kontrollim teknik të objekteve të përfunduara së ndërtuari dhe kërkesa për leje përdorimi dhe shfrytëzimi.

**c). Menaxhimi dhe kontrollimi teknik i objekteve:**

- në QMF-në në fshatin Shkabaj,
- në QMF-në në fshatin Rimanishtë,
- gëlqerosja e disa shkollave në Komunën e Prishtinës,
- rregullimi i pasarelës në platonë e Kurrizit në lagjen “Dardania” ,
- ndërtimi i rrugëve “ Mbreti Bardhyl” dhe “Maliq Pashë Gjinolli”,
- rrethoja e objektit të QMF-së në fshatin Shkabaj,
- rrethoja e objektit në QMF në lagjen “Kodra e Diellit”,
- mbikëqyrja e fasadimit të objekteve në bulevardin “Nënë Tereza”,
- mbikëqyrja gjatë vënies së pllakave në bulevardin “Nëna Tereza”,
- mbikëqyrja e objektit të Komunës,
- ura në rrugën “Vëllezërit Fazliu”,
- mbikëqyrja e objektit të pionierëve,
- pjesëmarrja në komisionin për pranimin teknik për disa objekte Parashkollore dhe shkollave fillore në Komunën e Prishtinës,
- menaxhimi në ndërtimin e aneksit të objektit të Sherbimit të ofiqarisë,
- përpilimi i tenderit për zhvillimin e punimeve në ndërtimin e aneksit të çerdhes “Gëzimi Ynë” në Prishtinë,
- terrenet sportive në fshatrat Grashticë dhe Mramor dhe
- kanalizimi në fshatin Barilevë.

### **c). Vërtetime për dëme lufte**

Gjatë vitit raportues, drejtoria ka shqyrtuar 29 kërkesa për dëme lufte, prej të cilave ka lëshuar 19 vërtetime dhe 10 informime.

### **IV. Mënyra e vendosjes sipas kërkesave**

Zgjidhja e kërkesave është bërë në bazë të vendimeve, konkluzioneve, përgjigjeve dhe vërtetimeve, si dhe në bazë të propozimvendimeve për Kuvendin e Komunës.

#### **a). Arsytet kryesore për refuzimin e kërkesave**

Arsyet për refuzimin e kërkesave kanë qenë:

- çështja pronësoro juridike e pazgjidhur për tokën apo hapësirën, për të cilin lokacion është kërkuar lejimi i ndërtimit,
- sipërfaqja në të cilën është kërkuar leja e ndërtimit, sipas planit urbanistik, ka pasur destinim tjetër nga ai që ka bërë kërkesën, si dhe nga arsyeja e qasjes së programeve komunale për nxjerrjen e Planeve Rregulluese,
- kërkesat për lejimin e ndërtimit jashtë kufijve të fshatrave, përkatësisht në tokën bujqësore, ose në afërsi të rrugëve magjistrale, hekurudhore dhe rrugëve të tjera,
- kërkesa për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirave banesore, kërkesat për lejimin e ndërrimit të destinimit të hapësirave në objektet banesore (kolektive), për të cilat nuk është argumentuar e drejta pronësore e kërkesave në ato hapësira, si dhe ato të cilave nuk ka mundur t'iu ndërrohet destinimi pa ndërhyrje me punë ndërtimore dhe pamundësi të shfrytëzimit të qasjeve ekzistuese, si dhe mungesën e bazës juridike të mjaftuar.

Dukuri tjetër e shpeshtë, e cila ka ndikuar në marrjen e konkluzionit për refuzimin e kërkesave, ka qenë se kërkesat për caktimin e kushteve urbanistike - teknike dhe për lejimin e ndërtimit, janë paraqitur pas përfundimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore, me qëllim ndërtimi, ndërrimi i destinimit, apo pas kryerjes së punëve të konsiderueshme, gjë që është konstatuar gjatë shqyrtimit të kërkesave e në procedurën e daljes në vendshikim. Andaj, kjo drejtori, konform rregullativës ligjore në fuqi, këto kërkesa i ka refuzuar, me arsyetim se janë zhvilluar punimet ndërtimore pa u caktuar kushtet urbanistiko - teknike dhe pa u lejuar ndërtimi.

#### **b. Kërkesat e miratuar dhe ato në procedurë**

Në numrin e kërkesave të paraqitura si të miratuara, është paraqitur numri i akteve mbi caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, lejet ndërtimore, konkluzionet me të cilat është lejuar zhvillimi i punimeve ndërtimore, të cilat nuk kanë ndryshuar projektin e objektit ekzistues, përkatësisht punët të cilat, komform rregullativës ligjore, nuk janë trajtuar ndërtim dhe as rikonstruktiv; si dhe konkluzionet tjera me të cilat është zgjidhur çështja pa qenë e domosdoshme të nxirret vendim i veçantë, të cilat janë zgjidhur në favor të kërkuësve, propozimvendimet e miratuara nga Kuvendi për caktimin e lokacionit, lëshimi i vërtetimeve mbi shkallën e dëmtimit nga pasojat e luftës, si dhe kërkesat tjera të ngjashme në favor të palëve.

### **c. Punët tjera nga përgjegjësia e drejtorisë**

Gjatë vitit raportues, nga Drejtorati është kërkuar që të bëhen vlerësimet profesionale mbi paramasat dhe parallogaritë për shpalljen e tenderëve për ndërtimin dhe rikonstruimin e objekteve, për të cilat Komuna ka qenë investitor, përkatësisht për objektet me të cilat qeveris Komuna. Për këtë kategori të objekteve është kërkuar që të caktojë persona profesionist për mbikëqyrjen e zhvillimit të punimeve ndërtimore, si dhe caktimin e komisionit profesional për kontrollimin teknik të këtyre objekteve pas përfundimit të ndërtimit, përkatësisht rikonstruktimin dhe analiza tjera për investime:

- sigurimi i planeve, pronësia dhe identifikimi i tyre në terren për të gjitha planet rregulluese;
- sigurimi dhe verifikimi i shënimeve kadastrale për të gjitha kërkesat në lidhje me lejen urbanistike dhe lejen ndërtimore;
- caktimi i vijave ndërtimore – piketimit për investitorët e pajisur me leje ndërtimore,
- fotografimi i lokacioneve dhe objekteve gjatë ndërtimit dhe pas ndërtimit.

### **V. Dhënia e informacioneve dhe vlerësimi i dëmeve nga pasojat e luftës për objektet e dëmtuara nga lufta**

Gjatë vitit raportues, drejtoria ka caktuar komisionet përkatëse për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekte nga pasojat e luftës dhe ate për 19 raste, sipas kërkesave të palëve.

### **VI. Realizimi i të hyrave buxhetore**

Gjatë vitit raportues, drejtoria ka arkëtuar të hyra buxhetore nga këto burime:

- kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore dhe
- taksa për paraqitjen e kërkesave për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, lejeve ndërtimore, leje përdorimi dhe shfrytëzimi dhe kërkesa për lëshimin e vërtetimeve nga përgjegjësia e kësaj drejtorie.

Të hyrat buxhetore nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore gjatë periudhës raportuese, në bazë të shënimeve që ka drejtoria, janë inkasuar **3 316 096, 09 €**, sipas shërbimit të financave **4 426 578, 96 €**, derisa nga taksat administrative për paraqitjen e kërkesave, zgjidhja e të cilave bie në përgjegjësinë e kësaj drejtorie, nuk kemi mundësi t'i sigurojmë, pasi që ato nuk janë evidencuar në organin kompetent komunal, këto të hyra evidencohen pranë drejtorisë përkatëse.

### **VII. Punët juridike**

Gjatë periudhës raportuese është punuar në:

- përgatitjen e të gjitha propozimvendimeve, me arsyetimet përkatëse, të përmendura në këtë raport pune,
- harmonizimin e të gjitha akteve për nxjerrje e vendimeve me Ligjin për planifikim hapësinor dhe Ligjin për ndërtim, si dhe me aktet tjera nënligjore të nxjerra në bazë të tyre,

- dhënien e udhëzimeve profesionale për zbatimin e rregulativës ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve nga përgjegjësia e kësaj drejtorie,
- pjesëmarrje në vendosjen e kërkesave më të ndërlikuara nga lëmi i planifikimit dhe i ndërtimit,
- revokimin e tri lejeve ndërtimore (me të cilat investitorët nuk i kanë pranuar vendimet, me arsyetimin - adresë e panjohur),
- përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore për punën e drejtorisë,
- përgatitjen e informatave për trupat e Kuvendit të Komunës, për administratën ndërkombëtare, pushtetin qendror, si dhe përgjigje sipas pyetjeve të delegatëve të KK-së së Prishtinës.
- pjesëmarrje në komisionet e formuara nga ana e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të ndërtimit dhe atij të planifikimit hapësinor, dhe punë të tjera.

## **VIII. VËSHTIRËSITË DHE PENGESAT E PARAQITURA NË REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIFIKUARA**

Mungesa e planeve rregulluese për disa lagje, ka sjellë vështirësi në përgjigje pozitive të kërkesave në ato lagje.

- Ndarja në blloqe me sipërfaqe të mëdha dhe pamundësia e parcelimit.
- Pengesë serioze në aspektin e planifikimit hapësinor ka qenë atakimi enorm i hapësirave të lira me ndërtime ilegale, si brenda kufijve të planit të përgjithshëm urbanistik ashtu edhe jashtë tij.
- Mungesa e IT-harta digjitale lidhja në rrjet.
- Numri i vogël i stafit dhe
- Problemet teknike me kompanitë që menaxhojnë infrastrukturën.

Po ashtu, ndikim vendimtar dhe pengesë serioze në realizimin e shumë vendimeve komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie, ka qenë kufizimi i të drejtës së administrimit të Komunës në tokën në pronësi të saj me Rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, si dhe mosdefinimi adekuat i pronësisë shoqërore, publike apo komunale.

## **IX. PROPOZIMI I MASAVE**

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësi që ka, drejtoria propozon që:

- me një akt të veçantë, të bëhet ndarja e kompetencave në mes të drejtorive në mënyrë recidive, sepse me Statut dhe me Rregulloren për organizimin e brendshëm të organeve ekzekutive të Komunës, këto kompetenca janë dukshëm të ngatërruara;
- të rritet numri i personelit civil profesional, veçanërisht ai nga lëmi i arkitekturës;
- të propozohet që Kuvendi i Kosovës të nxjerrë rregullativë ligjore mbi definimin e të drejtës pronësore dhe administrimin në hapësira të përbashkëta në objektet banesore të tërësisë së përbashkët (kolektive);
- mjetet e llogaritura dhe të inkasuara në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore dhe ato në emër të shfrytëzimit të tokës ndërtimore, të orientohen në llogari të veçantë të Komunës dhe ato të përdoren ekskluzivisht sipas destinimit për të cilin llogariten dhe paguhen.

## IX. DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Aktiviteti i Drejtoratit të Inspektionit për prridhën raportuese, është orientuar në punët e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, rregulloreve, vendimeve dhe urdhëresave të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e që kanë të bëjnë me lëmin e:

- tregtisë ,
- ndërtimtarisë,
- bujqësisë,
- veterinarisë, sanitarisë dhe
- veprimtarive komunale dhe të komunikacionit.

Punët e të gjithë sektorëve në kuadër të Drejtoratit të Inspektionit, janë bazuar dhe koordinuar në bazë të planprogramit për vitin fiskal 2007, kërkesave të palëve në bazë të urdhëresave të organeve kompetente, organizatave komunale shërbyese, të policisë e të tjera.

Punët e kryera gjatë vitit 2007 janë:

|                                                                                                                       |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| -Kontrollime .....                                                                                                    | 28625        |
| -Procesverbale.....                                                                                                   | 9427         |
| -Aktvendime.....                                                                                                      | 10796        |
| -Fl. për kundërvajtje.....                                                                                            | 1214         |
| -Pëlqime për kushte teknike sanitare.....                                                                             | 615          |
| -Shuma në euro- €.....                                                                                                | 70473        |
| -Mjete të pa inkasuara.....                                                                                           | 3950         |
| -Urdhërndalesa me shkrim.....                                                                                         | 2160         |
| -Mbyllje të objekteve afariste.....                                                                                   | 19           |
| -Largim të shitësve nga rruga.. ..                                                                                    | 1062         |
| -Konfiskim i mallit në vlerë prej.....                                                                                | 6295 €       |
| -Ankesa të qytetarëve për shqyrtim.....                                                                               | 440          |
| -Rekomandime sanitare.....                                                                                            | 63           |
| -Kontrollimi i mostrave të ujit.....                                                                                  | 24           |
| -Kontrollimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore.....                                                              | 75           |
| -Kontrollimi i DDD dhe i strishave.....                                                                               | 49           |
| -Asgjësimi i ushqimit me afat të skaduar në vlerë prej .....                                                          | 152.225,00 € |
| -Njoftime paleve.....                                                                                                 | 324          |
| -Aksione të përbashkëta me SHPK-në.....                                                                               | 168          |
| -Aksione lidhur me zbatimin e Urdhëresës për kufizimin e ujit të pijshëm.....                                         | 178          |
| -Evidencimi i objekteve të ndërtuara pa lejen e organit kompetent të Komunës.....                                     | 440          |
| -Largimi i rrethojave për të cilat jepet leja e ndërtimit, platove dhe objekteve tjera montuese pa leje ndërtimi..... | 478          |
| -Objekte të rrënuara.....                                                                                             | 61           |
| -Objekte të rrethuara.....                                                                                            | 18           |
| -Objekte me leje të ndërtimit.....                                                                                    | 35           |
| -Objekte pa leje ndërtimi.....                                                                                        | 109          |

Në aktivitetin e përgjithshëm të kësaj drejtorie, përpos punëve të parapara me planprogram, janë përfshirë edhe një varg aktivitetesh tjera me rëndësi për këtë drejtori, që tani do t'i japim paksa më të detajizuar në kuadër të të gjithë sektorëve.

- Aksioni i përbashkët i Inspektionit me SHPK-në për largimin e stërshitësve ambulantë nga trotualet dhe rrugët e qytetit, në veçanti para tregjeve në Ulpianë dhe Tregut të Gjelbër, me ç'rast, disa herë është bërë edhe konfiskimi i mallrave të ekspozuara .
- Inspektorët e tregut kanë kontrolluar shoqëritë tregtare për respektimin e ligjshmërisë, siç janë : leja e punës dhe dokumenatacioni përkatës .
- Sektori sanitar ka bërë kontrollimin e objekteve hoteliere, kuzhinave publike, mishtoreve, pishinave dhe objekteve shkollore për kushtet higjienike .
- Sektori i bujqësisë, kryesisht ka bërë përcjelljen e fushatës së korrje - shirjeve , mbikëqyrjen e masave agroteknike, si në sektorin shoqëror ashtu edhe në në atë privat, barnatoret bujqësore, furrat në pronësi private për prodhimin e bukës dhe të pjekurinave të ndryshme - prodhimet dhe finalizimet, mbikëqyrjen e artikujve ushqimorë me prejardhje bimore, të pijeve alkoolike dhe joalkoolike, prodhimin dhe qarkullimin e tyre, afatin dhe kualitetin etj.
- Sektori i ndërtimit ka vazhduar me punën e përditshme në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe ushtrimin e masave të parapara me dispozitat e Ligjit për ndërtim.
- Sektori komunal dhe ai i komunikacionit, kanë qenë të anagazhuar në zbatimin e planit të punës në kuadër të kompetencave përkatëse rreth zbatimit të ligjshmërisë dhe pengimit të dukurive negative të hasura në terren. Me ritëm të vazhduar ka bërë kontrollimin e subjekteve afariste për ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste, dhe ka ndërmarrë masa të duhura ligjore ndaj tyre. Po ashtu, ky sektor, përkatësisht inspektorët e komunikacionit, në bashkëpunim me SHPK-në , policinë e trafikut, kanë kontrolluar auto-taxit dhe kombibusët lidhur me respektimin e rregullave dhe linjave përkatëse, duke shqiptuar fletëparaqitje, dhe janë ndërmarrë masat e duhura ligjore ndaj kundërvajtësve .
- Drejtorati i Inspektionit pati një bashkëpunim të mirëfilltë me ndërmarrjet shërbyese dhe komunale dhe bashkërishtë u zgjodhën shumë probleme të paraqitura në terren.
- Drejtorati i Inspektionit, gjatë periudhës raportuese, ashtu si edhe më parë, pati një bashkëpunim të sinqertë dhe mjaft të suksesshëm me SHPK-në në realizimin e detyrave të përbashkëta .
- Drejtorati i Inspektionit edhe gjatë ditëve të fundjavëve (uikendeve), kanë mbajtur kujdestari të rregulltë për pengimin e dukurive negative të hasura në terren.

Drejtoria për zhvillimin e procesit të punës, ka bashkëpunuar me të gjitha drejtoritë e Komunës, inspektionet e komunave tjera të Kosovës, me UNMIK-un, Policinë e UNMIK-ut, SHPK – në, ndërmarrjet komunale, mediat etj.

## KËRKESAT DHE NEVOJAT E NGUTSHME

1. Harmonizimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me kompetencat e sakta të secilit sektor të inspektionit, veç e veç;
2. Krijimi i një "taks-forc"-e (policisë komunale të ndërtimit), apo i një sektori të veçantë në kuadër të SHPK-së, i cili do të merrej ekskluzivisht me zbatimin dhe mbikëqyrjen e urdhërndalesës së inspektorit ;
3. Plotësimi i kuadrit profesional me inspektorë të ndërtimit dhe inspektorë të tjerë të sektorëve përkatës, konform vëllimit të punëve;
4. Plotësimi i nevojave të Inspektoratit me pajimet e nevojshme për punë.

## X. DREJTORATI I ZHVILLIMIT RURAL

Drejtoria e Zhvillimit Rural përkujdeset për krijimin e një infrastrukture më të mirë në zonat rurale dhe përkrahjen e zhvillimit të bujqësisë.

Prioritetet e kësaj drejtorie janë: infrastruktura rrugore, zhvillimi i bujqësisë, si dhe përmirësimi i kushteve të jetës dhe punës në zonat rurale.

Të gjitha prioritetet për vitin 2007, janë caktuar sipas kërkesave të përfaqësuesve të BL-ve, me një seleksionim të bërë nga përfaqësuesit e drejtorisë dhe të Komitetit për zhvillim rural, gjithmonë duke pasur parasysh mundësitë financiare.

### 1. SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL

Gjatë vitit 2007, ky sektor ka zhvilluar aktivitete në mirëmbajtjen e punëve rreth projekteve të zhvillimit rural me vlerë prej 1 005 575, 64 €.

#### 1. Projektet e realizuara:

| Sektori për zhvillim rural |                                                                                    |    |               |                 |
|----------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|----|---------------|-----------------|
| Nr.                        | Projektet                                                                          | km | K.K.Prishtinë | Periudha kohore |
| 1.                         | Kanalizimi fekal në fshatin Prugoc                                                 | -  | 60.691,64 €   | -               |
| 2.                         | Kanalizimi në fshatin Bardhosh                                                     | -  | 49.865,65 €   | -               |
| 3.                         | Asfaltimi i rrugës në fshatin Drenoc                                               | -  | 63.988,00 €   | -               |
| 4.                         | Asfaltimi i rrugës Slivovë - Mramor                                                |    | 134.345,00 €  | -               |
| 5.                         | Kanalizimi fekal në fshatin Prugoc (krahu i majtë)                                 |    | 9.701,20 €    | -               |
| 6.                         | Asfaltimi i rrugës në fshatin Hajvali - L.e Byqmeteve                              | -  | 22.617,00 €   | -               |
| 7.                         | Furnizimi dhe montimi i gypave dhe pjesëve tjera të kan. fekal në fshatin Barilevë | -  | 2.686,08 €    | -               |

#### 2. Në procedurë janë projektet:

| Nr. | Projektet                                          | km | K.K.Prishtinë | Periudha kohore |
|-----|----------------------------------------------------|----|---------------|-----------------|
| 1.  | Asfaltimi i rrugës Ballaban - Keqekollë            |    | 444.283,25 €  |                 |
| 2.  | Riparimi i rrugës së kategorisë IV, Kaqote - Qelaj |    | 20.550,00 €   |                 |
| 3.  | Sanimi i rrugëve të kategorisë IV                  |    | 66.600,00 €   |                 |
| 4.  | Kanalizimi fekal në fshatin Vranidoll              |    | 37.897,48 €   |                 |
| 5.  | Kanalizim në fshatin Lebanë dhe Prugoc             |    | 75.565, 72 €  |                 |
| 6.  | Mirëmbajtja dimërore (Lloto I +II)                 |    | 16.784,80 €   |                 |

## 2. SEKTORI BUJQËSISË

Në vitin 2007, në Sektorin e bujqësisë, përveç projekteve të realizuara, është zhvilluar një aktivitet që kishte për bazë përcjelljen e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore. Përcjellja dhe organizimi i korrje-shirjeve, vlerësimi i gjendjes, si dhe dëmet e shkaktuara në pyjet e komunës së Prishtinës dhe parkun rajonal “ Gërmia”.

### Projektet e realizuara:

| Nr. | Projektet                                                                                                                                   | Vlera €          |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|
| 1.  | Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale                                                                                                 | 9.967,50         |
| 2.  | Eliminimi i qenve endacakë                                                                                                                  | 9.800,00         |
| 3.  | Regjistrimi i dëmeve të shkaktuara nga zjarri në K.Prishtinës                                                                               |                  |
| 4.  | Raporti mbi realizimin e planprogramit për mbjelljet pranverore 2007                                                                        |                  |
| 5.  | Pjesëmarrja në inventarizimin (vlerësimin) e dëmeve të shkaktuara në rajonin e Prishtinës, si dhe në parkun rajonal “Gërmia” për vitin 2007 |                  |
| 6.  | Rrjedhat e punës në parkun rajonal “Gërmia”                                                                                                 |                  |
| 7.  | Realizimi i projektit “Pastrimi fito - sanitar i parkut r. “Gërmia”                                                                         |                  |
| 8.  | Përcjellja e projektit në mirëmbajtjen e gjelbërimit në Parkun e Qytetit ,Tauk-Bahçe dhe Arbëri për vitin 2007                              |                  |
| 9.  | Raport mbi realizimin e planprogramit të mbjelljeve vjeshtore dhe punëve në procesin e korrje-shirjeve 2007                                 |                  |
| 10. | Furnizimi me farë gruri dhe plehra minerale                                                                                                 | 15.076,00        |
| 11. | Veterina mobile (realizim sipër)                                                                                                            | 9.396,60         |
| 12. |                                                                                                                                             |                  |
| 13. |                                                                                                                                             |                  |
| 14. |                                                                                                                                             |                  |
| 15. | <b>Gjithsej</b>                                                                                                                             | <b>44.239,11</b> |

Bujqësia është një degë mjaft e rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, si dhe për përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Gjatë vitit 2007, në lëmin e lavërtarisë, kemi bërë realizimin e këtyre punëve dhe projekteve:

### Planprogrami dhe realizimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore

Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2007, në komunën e Prishtinës janë planifikuar të mbillen gjithsej 2.570 ha me kultura pranverore. Ky planifikim është realizuar në tërësi.

Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore/ha. tërshërë – 58 ha, misër - 1982 ha, bimë foragjere – 170 ha, perime - 67 ha, patate – 241 ha, fasule si monokulturë - 9 ha dhe elb pranveror 43 ha. Do theksuar se vetëm te mbjellja e fasules kemi rritje, kurse te kulturat tjera zbritje.

Projekti "Furnizimi me farë misri dhe plehra minerale"

Projekti është realizuar në periudhën kohore 13 -16 prill 2007, dhe 16 -18 tetor 2007, janë ndihmuar gjithsej 150 familje me nga 10 kg farë misri, 150 kg pleh mineral (NPK). Me realizimin e këtij projekti nga ana e drejtorisë, janë mbjellë gjithsej 75 ha me misër.

Në vitin 2007 me kultura vjeshtore janë mbjellë 2.665 ha.

**Sipërfaqet e mbjella me kultura vjeshtore / ha :** grurë - 2.530 ha, elb vjeshtor - 120 ha, bimë foragjere - 15 ha.

Nga të dhënat e lartpërmendura shihet se kemi një zvogëlim të konsiderueshëm të sipërfaqeve të mbjella me kultura lavërtarie, krahasuar me vitet e mëparshme, dhe në raport me sipërfaqet e përgjithshme të tokës punuese.

Faktorët që më së shumti kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqeve të mbjella me kultura lavërtarie, janë:

- mungesa e mbështetjes dhe stimulimit institucional, subvencioneve etj.,
- hyrja e produkteve bujqësore nga vendet fqinje me lehtësi fiskale, që krijon një konkurrencë jo lojale në raport me prodhuesit vendor,
- çmimi i lartë i inputeve bujqësore (farërave, plehrave, derivateve të naftës etj.),
- mungesa e kredive me kamatë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë.

### **Raport rreth procesit të korrje-shirjeve**

Procesi i korrje-shirjeve ka filluar më 25.6.2007 dhe ka përfunduar më 26.7.2007.

Çmimi i korrjes sillet prej 80 €/ha.

Rendimentet e grurit ishin mjaft të mira (4.500 kg/ha) dhe, krahasuar me vitin e kaluar, janë përafërsisht 100% më të larta.

Në procesin e korrje-shirjeve kanë marrë pjesë 20 kombajna.

**Blegtoria** – është një degë e rëndësishme e bujqësisë, zhvillimi i së cilës do të ndikonte në përmirësimin e kushteve jetësore në fshatra. Komuna e Prishtinës i ka të gjitha kushtet natyrore (livadhe dhe kullosa) për zhvillimin e këtij sektori, vetëm se duhet një përkrahje financiare e fermerëve, mirëpo për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore, nuk kemi pasur mundësi të realizojmë ndonjë projekt, që do ndikonte në përmirësimin e ndjeshëm në këtë sektor. Në bashkëpunim me shoqatën "Heifer International Kosova", është realizuar projekti "Mbarshtimi i dhive në rajonin e Gollakut". Fermerët e këtij rajoni kanë përfituar gjithsej 76 krerë dhi, si dhe ushqim të koncentruar dhe shërbime veterinarë.

### **- Projekti "Eliminimi i qenve endacakë"**

Gjatë këtij aksioni janë eliminuar gjithsej 700 qen endacakë, ku është përfshirë tërë qyteti, dhe ky aksion ka rezultuar të jetë i suksesshëm, pa shkaktuar asnjë aksident. Realizimin e këtij projekti e ka bërë NPK "Hortikutltura".

Eliminimi i qenve endacakë ka filluar më 4.7.2007 dhe ka përfunduar më 31.8.2007.

## Pylltaria

Pas nënshkrimit të Memorandumit të mirëkuptimit nga sfera e pylltarisë, bashkëpunimi në mes të APK-së - Njësia e Prishtinës dhe DZHR-së Prishtinë, që ka ndodhur gjatë vitit 2006, ka qenë në nivel dhe kemi marrë pjesë në vlerësimin e kërkesave të qytetarëve për nevojat e furnizimit me dru për djegie. Komisioni i përbashkët ka punuar në inventarizimin e dëmeve pyjore në Sektorin shtetëror. Punët i ka filluar me 20.11.2007 dhe i ka perfunduar më 14.12.2007. Nga shënimet e grumbulluara rezulton se gjatë periudhës janar – dhjetor 2007, janë shkaktuar dëme prej 32.960 m<sup>2</sup> masë drurore.

## Parku rajonal “Gërmia”

Sipas Strategjisë së zhvillimit afatgjatë të Gërmisë dhe Planit vjetor NPK “Hortikultura”, është realizuar projekti: “Pastrimi fito-sanitar i parkut rajonal “Gërmia””, në zonën kadastrale nr. 153 në “Sofali”, ngastra kadastrale 214, në sipërfaqe prej 249.54.94 ha, me mase drurore sipas projektit me vëllim të përgjithshëm 352.969 m<sup>3</sup>. Punët fito-sanitare NPK “Hortikultura” i ka filluar më 19.9.2007 dhe janë në vazhdimsi.

|    |                             |                |
|----|-----------------------------|----------------|
| 1. | Spektori për zhvillim rural | 1.005575,64 €  |
| 2. | Spektori për bujqësi        | 44240.10 €     |
| 3. | Gjithsej                    | 1.049.815,74 € |

## XI. DREJTORATI I KADASTRIT DHE I GJEODEZISË

Gjatë periudhës raportuese, angazhimi i drejtorisë ka qenë në përmbushjen e detyrave dhe punëve, të cilat janë të parapara me dispozitat që kanë të bëjnë me kadastrin dhe gjeodezinë.

Miratimi i kërkesave të personave juridikë: Kuvendi i Komunës dhe organet e administratës, organet e pushtetit qendror dhe Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit në përgatitjen e dokumentacionit për privatizim, për nevojat e Komunës, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me kompetencë të saj: për nevojat e infrastrukturës, planifikimit dhe të shërbimit pronësor.

- Vazhdimi i zbatimit të projektit për regjistrimin e kadastrit etazher;  
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të paraqitura nga personat fizikë: kërkesat për certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, kërkesat për kopje plani, kërkesat për certifikata për ndihmë sociale, për rregullimin e vizës, për rregullimin e dok. për bursat e studentëve, për rregullimin e dok. për banim në konvikt dhe për nevoja personale, kërkesat për regjistrimin (bartjen) e pronave sipas kontratave, aktvendimeve dhe aktgjykimeve, të gjitha të vërtetuara në gjykata, kërkesa për regjistrimin e ndarjeve të ngastrave, kërkesa për intabulim të hipotekës, kërkesa për çregjistrim të intabulimit të hipotekës, kërkesa për barrë tatimore, kërkesa për matjen dhe ndarjen e ngastrave kadastrale, kërkesa për rilevimin e gjendjes faktike, identifikimin e objekteve apo indentifikimin e ngastrave, ndërrimin e kulturës në ngastër, ripërtirja e kufijve të ngastrave, dhe të gjitha punët tjera gjeodezike. Edhe në mungesë të tërë elaboratit kadastral, si juridik ashtu edhe teknik (original) , me angazhimin maksimal të personelit, janë kryer me kohë obligimet ndaj qytetarëve, ndërmarrjeve dhe institucioneve tjera.

## **Pasqyra e realizimit të punëve sipas kërkesave, për periudhën janar – dhjetor 2007**

### **Lëndë të terrenit janë pranuar:**

|                                            |     |
|--------------------------------------------|-----|
| - gjithsej.....                            | 684 |
| - të miratuara – të kryera (private) ..... | 565 |
| - në procedurë .....                       | 119 |

### **Në bazë të dokumentacionit juridik dhe teknik për nevojat e ndërrimeve në operatin kadastror, janë pranuar:**

|                      |      |
|----------------------|------|
| - gjithsej.....      | 3224 |
| - janë kryer.....    | 3013 |
| - në procedurë.....  | 31   |
| - janë refuzuar..... | 7    |

### **Lëndët e intabulimit – hipotekave, janë pranuar dhe miratuar:**

|                        |     |
|------------------------|-----|
| - gjithsej.....        | 864 |
| - për regjistrim.....  | 781 |
| - për çregjistrim..... | 83  |

### **Zyra për certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe kopje plani, certifikata për ndarjen e ngastrave, për rreg. e dokumentacionit të ndihmës sociale etj., janë pranuar dhe miratuar:**

|                                                             |       |
|-------------------------------------------------------------|-------|
| - gjithsej (kërkesa).....                                   | 13965 |
| - certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme .....  | 7110  |
| - kopje plani.....                                          | 6732  |
| - certifikata për ndarjen e ngastrave.....                  | 123   |
| - certifikata për rreg. e dok. të ndihmës sociale etj. .... | 3342  |

Vlen të theksohet se, përkundër të gjitha vështirësive objektive, në mungesë të të dhënave teknike dhe juridike, të cilat nuk janë kthyer ende nga Serbia, ashtu edhe të vështirësive subjektive, Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë ka arritur t'i kryejë të gjitha punët në afatet e caktuara, edhe pse është rritur vëllimi i punëve mbi 30%, krahasuar me vitin paraprak.

## **XII. DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT, MBROJTJES SË AMBIENTIT DHE TOKËS NDËRTIMORE**

Fushëveprimi i drejtorisë është realizimi dhe mbikëqyerja e shërbimeve publike, avancimi i tyre përmes planifikimeve, monitorimeve, ndërtimi i strategjisë për investime në lëmin e shërbimeve publike dhe harmonizimi i veprimtarive të subjekteve tjera, të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi merren me këto shërbime.

Poashtu, kjo drejtori bënë mbikëqyerjen e zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore, me të cilat rregullohet lëmi i shërbimeve publike, dhënia e lejeve për

shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosja e objekteve të përkohshme, mbikqyerja e pastrimit të qytetit, bartja e mbeturinave, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, zgjerimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, funksionimi i transportit publik urban të udhëtarëve dhe parkingjet publike me pagesë.

## SHËRBIMI I ADMINISTRATËS SË DREJTORATIT

Gjatë periudhës së vitit 2007 është vazhduar puna në hartimin e akteve juridike nga fushëveprimi i tij.

Janë nxjerrë vendime në bazë të kërkesave të palëve fizike, juridike dhe subjekteve tjera, lidhur me realizimin e të drejtave apo përgjigjësi të tyre nga kompetencat e drejtorisë, siç janë dhënia e lejeve për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike për parkim në rrugët dhe hapësirat e qytetit, për rregullimin e sipërfaqeve të gjelbëruara.

### Kërkesa të pranuar dhe të zgjidhura gjatë periudhës raportuese:

|                            |     |
|----------------------------|-----|
| • kërkesa të pranuar ..... | 782 |
| • të zgjidhura .....       | 764 |
| • në procedurë .....       | 18  |

## SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Gjatë vitit 2007, Sektori i shërbimeve publike aktivitetet e veta i ka zhvilluar në bazë të planit të punës, i cili kryesisht ka të bëjë me dhënien e lejeve për objektet individuale të banimit dhe të atyre shoqërore, për kycje në rrjetin kryesor të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe të sistemit të ngrohjes në qytet. Me qëllim të përmirësimit të kushteve elementare të jetës së qytetarëve, ky sektor është angazhuar, në bashkëpunim me kompanitë përgjegjëse, ku ka zgjidhur problemet në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, problemin e ujërave të zeza, furnizimin me energji elektrike dhe mirëmbajtjen e higjienës në qytet. Është hartuar dokumentacioni për tenderimin e infrastrukturës rrugore në qytet, në bazë të projekteve të hartuara nga shtëpitë projektuese; kemi marrë pjesë në hapjen, vlerësimin e ofertuesve, gjithashtu është bërë monitorimi gjatë ekzekutimit të punimeve nga fituesit e tenderëve, si dhe është bërë pranimi teknik për punët e kryera.

Gjithsej janë pranuar **34** kërkesa, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me lëshimin e vendimeve për kycjen e objekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Të gjitha kërkesat janë zgjidhur brenda afatit të paraparë ligjor.

### 1. Kanalizimi

- Është bërë sanimi emergjent i përroit në lagjen “Kodrën e Diellit II”, realizuar me kontratën nr. 616 07 178 521, të dt. 14.9.2007, në vlerë prej **9 580.00 €**.

### 2. Ngrohja

- Është bërë sanimi i rrjetit të ngrohjes në disa rrugë të qytetit (investimi i Ngrohtores),

### 3. Higjiena publike në qytet:

#### a. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuarve gjatë sezonës së dimrit .

**VZ “ Company ”** loto – I – 37 rrugë dhe loto - II – 29 rrugë.

Kontrata nr. 616 06 174 521, dt. 6.11.2006.

Totali i kontratës është: .....66.860,00 €

Faturat e lëshuara për pagesë ..... 41.225,96 €

**NR “Pastrimi”** loto - III - 53 rrugë

Kontrata nr. 616 06 174 521, dt. 6.11.2006.

Totali i kontratës është: ..... 44.100,00 €

Faturat e lëshuara për pagesë ..... 31.613,95 €

#### b. NSHT. “Zahiri”- Pastrimi i rrjetit të kan. atmosferik - Prishtinë pjesa - I

Kontrata nr. 616 06 173 521, dt. 23.11.2006.

Totali i kontratës është: .....11.857,00 €

Faturat e lëshuara për pagesë .....11.857,00 €

#### c. NPN “Dardania “ Grumbullimi dhe bartja e dheut dhe mbeturinave ndërtimore nga qyteti për në deponi.

Kontrata nr. 616 07 010 531, dt. 29.3.2007.

Totali i kontratës është: .....1.940,00 €

Faturat e lëshuara për pagesë .....1.940,00 €

#### d. NR “ Pastrimi “ mirëmbajtja e rrugëve – trotuareve gjatë sezonit veror

Kontrata nr. 616 07 045 525, dt. 06.4.2007.

Pastrimi javore është: .....9.074,06 € x 32 javë = 290.369, 92 €

Faturat e lëshuara për pagesë ..... 283.819,71 €

#### e. Larja e busteve – përmendoreve

Kontrata nr. 616 07 045 525, dt. 06.4.2007

Totali javor është:.....15 larje x 210,00 € = 3.150,00 €

Fatura e lëshuar për pagesë është:.....1.890,00 €

#### f. NNP “ Noti “ Bartja e materialit të fortë ndërtimor

Kontrata nr. 616 07 092 521, dt. 20.10.2007.

Totali i kontratës është:.....7.500,00 €

Punët janë duke u zhvilluar dhe deri më tani nuk është lëshuar asnjë faturë për pagesë.

#### g. SHPK “ Toifor “ loto - I 38 rrugë, loto – II 30 rrugë.

Kontrata nr. 616 07 251 521, dt. 15.11.2007.

Totali i kontratës është: loto – I dhe loto – II ....57.600,00 €

Punët janë duke u zhvilluar dhe deri më tani nuk është lëshuar asnjë faturë për pagesë.

**NR “ Pastrimi ” loto – III – 53 rrugë.**

Kontrata nr. 616 07 251 521, dt. 15.11.2007.

Totali i kontratës është: loto – III ..... **31.300,00 €**

Punët janë duke u zhvilluar dhe deri më tani nuk është lëshuar asnjë faturë për pagesë.

## **SHËRBIMI ELEKTRO-ENERGJETIK**

Gjatë vitit 2007 në shërbimin elektro-energjetik gjithsej kanë arritur 94 kërkesa. Prej tyre 88 janë zgjidhë, ndërsa 6 kërkesa janë në procedurë e sipër. Kërkesat kanë të bëjnë me dhënien e lejes për ndërtimin e objekteve elektro - energjetike PTK, TV, informata, lajmprime, pëlqime dhe fatura .

### **Mirëmbajtja dhe sanimi i ndriçimit publik**

Në bazë të kontratës nr. 067-014-121, të dt. 7.5.2007, punët për mirëmbajtjen e ndriçimit publik i janë besuar NP “Monten” nga Prishtina. Për ndriçimin e 207 rrugëve dhe mirëmbajtjen e tyre, janë shpenzuar mjetet në shumë prej.....150.000,00 €.

### **Mirëmbajtja e semaforëve**

Për mirëmbajtjen e semaforëve për vitin 2007, nuk janë siguruar mjetet nga buxheti i Komunës së Prishtinës, për arsye se gjatë vitit 2006 nuk janë shpenzuar të gjitha mjetet, andaj shuma e mjeteve të parealizuar ka kaluar në vitin 2007, në bazë të së cilës është përpiluar kontrata plotësuese për mirëmbajtjen e semaforëve për vitin 2007, nr. 616 – 07 - 14 -121, të dt. 07.05.2007, punët në mirëmbajtjen e semaforëve i janë besuar DPZ “Jame” nga Prishtina.

Shpenzimet e energjisë elektrike

Për shpenzimet e energjisë elektrike të ndriçimit publik dhe të semaforëve, prej të cilave janë 109 grupe matëse të aktivizuara, nga buxheti i Komunës së Prishtinës janë ndarë mjetet në shumën prej .....**250.000,00 €**

Mbikëqyerja e ndriçimit publik dhe e kanalizimit kabllor

- Ndërtimi - dislokimi i rrjetit elektrik 0,4kV me ndriçimi publik prej shtyllave të drunjtë në shtylla të betonit, në rrugën “Vëllezërit Fazliu”, me nr. të kontratës 616-07-175-521, të dt. 30.10.2007, nga NPE “Monten” nga Prishtina.

Vlera e kontraktuar .....**93.045,85 €**

Vlera e realizuar.....**46.522,92 € rreth: 50%**

Punët janë në përfundim e sipër, kanë ngecur për shkak të kushteve atmosferike.

- Ndërtimi i rrugës dhe dislokimi i rrjetit 0,4 kV, i rrugës “Mbretëresha Teutë” faza e dytë, me nr. të kontratës: 616 07 107 521, të dt. 13.07.2007, nga NNP “NOTI” nga Prishtina, në kuadër të së cilës është punuar ndriçimi publik në shtylla të betonit me dislokim.  
Vlera e kontraktuar e pjesës elektrike.....20.449,62 €  
Vlera e punëve të kryera:.....15.000,00 €  
Punët elektrike kanë përfunduar.
- Ndërtimi i rrugës, kanalizimit kabllor energjetik dhe ndriçimi publik në shtylla të hekurta në rrugën “ Kukësi”, faza e dytë, nr. i kontratës 616 07 107 521, të dt. 13.7.2007 nga NNP “NOTI” nga Prishtina.  
Vlera e kontraktuar e pjesës elektrike.....20.449,62 €  
Vlera e punëve të kryera.....15.000,00 €  
Punët rreth elektrikes kanë përfunduar.
- Ndërtimi i rrugës dhe dislokimi i shtyllave të tensionit të ulët 0,4kV në rrugën “Agron Rrahmani”, nr. i Kontratës 616 06 172 521, të dt. 23.3.2007 nga NTP “Albaniku” nga Prishtina.  
Vlera e kontraktuar .....4.200,00 €  
Vlera e punëve të kryera .....4.200,00 €

Në këtë periudhë raportuese është punuar në mbikqyerjen e ndriçimit publik dhe kanalizimit kabllor në ndërtimin e rrugëve të reja në qytet.

### **Shfrytëzimi i hapësirave publike**

Gjatë kësaj periudhe kanë arritur gjithsej 290 kërkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve, stendave lëvizëse dhe panove. Prej tyre 280 janë zgjidhur, 10 kërkesa janë në procedurë të zgjidhjes.

### **Të hyrat nga shfrytëzimi i hapësirave publike:**

- Për lokale, stenda, reklama dhe gjeneratorë.....131.916,99 €
- Nga kompania AMM.....121.684 ,18 €

Të hyrat e realizuara nga Sektori për transport dhe ambient:

- Nga parkingjet me koncesion .....52.000,00 €
- Nga parkingu në oborrin e shkollës “Xhevdet Doda” .....6.485,00 €
- Nga parkingjet e rezervuara.....14.620,00 €
- Nga kompanitë “merimangë” .....69.379,15 €
- Nga parku rajonal “Gërmia” .....81.814,58 €

Gjithsej të hyra.....224.298,73 €

## SEKTORI I TOKËS NDËRTIMORE

Gjatë periudhës raportuese, Sektori i tokës ndërtimore ka pas aktivitete në realizimin e kërkesave të qytetarëve, bashkësive lokale dhe programit, investim të Kuvendit të Komunës, për rregullimin e rrugëve me infrastrukturë .

Ekipi teknik pas incizimeve të duhura në terren, ka përgatitur këto materiale për ofertim dërguar Zyrës së prokurimit, për ndërtimin e këtyre 55 rrugëve: “Janë Kukuzeli”, “Tahir Meha”, “Mehmet Beci”, “Ibrahim Kelmendi”, Shpati në Mat, hyrja te shkolla fillore “Emin Duraku”, rruga lidhëse “Isa Kastrati”, “Luigj Gurakuqi”, “Selman Kadria” , “Xhemë Elezi”, muri mbrojtës në rr. “Gazmend Zajmi”, “Eqrem Çabej”, riparimi i rrugës Shkolla Normale-Sofali, Përroj i Njelmët (krah të kanalizimit fekal), “Zenel Bajraktari”, “Aleksandër Mojsiu”, “Mbretëresha Teutë” (pjesa e dytë), “Burim Graiçefci”, “Adem Keqekolla”, Lagja e Sofali, “Eduard Liri”, “Bajram Curri”, “Ekrem Rexha”, “Selim Berisha”, “Mbreti Bardhyl”, “Maliq Pashë Gjinolli”, Mati 2 (lidhja me rrugën “Isa Kastrati” që del te xhamia ), “Hollgen Pedesen” (krah i majtë ), “Kapiten Hysni Rudi”, “Janina”, “Shaip Spahiu”, “Kaçaniku”, “Abdyl Frashëri”, “Rexhep Xheli”, “Ismet Derguti”, “Ndue Përlleshi”, “Holgen Pedersen” (krah i djathtë), “Sadik Rama”, “Vehbi Ibrahim”, “Andrea Gropa”, “Bedri Pejani”, “Fazli Graiçefci, bulevardi “Nënë Tereza”, Bulevardi i Dëshmorëve, “Kruja”, “Rrahim Murati”, “Rifat Krasniqi”, “Afrim Krasniqi”, “Hamdi Mramori”, “Vasil Antoni”, “Ylfete Humolli”, “Ilaz Agushi”, “Zija Prishtina”, “Hernik Bariqi” dhe “Gjergj Fishta”.

Përveç përgatitjes së dokumentacionit ofertues, Sektori i tokës ndërtimore ka shqyrtuar 86 lëndë të palëve që i janë dërguar këtij sektori dhe, pas përpunimit të lëndëve, në afatin ligjor u është përgjigjur me shkresë palëve.

Poashtu, ky sektor ka bërë monitorimin gjatë ekzekutimit të punimeve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Ka qenë pjesëmarrës në hapjen dhe vlerësimin e ofertuesve, në takimet me komunitete rreth zgjidhjes së problemeve në infrastrukturë, në takimet me Komitetin e Shërbimeve Publike dhe në pranimet teknike të punëve të kryera.

Rrugët

**Realizimi i projekteve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (të realizuara - në realizim e sipër ) janë dhënë në formë tabelore.**

| N r | Emëri i rrugës                                                              | Punëkryesi         | Fillimi i punimeve | Përfundim i punimeve | Afa ti | Vlera      | Pranimi teknik |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|----------------------|--------|------------|----------------|
| 1   | "Agron Rrahmani"<br>"Ramë Bllaca"<br>kanalizimi fekal<br>kanalizimi atmosf. | "Albaniku"         | 23.04.07           | 07.11.07             | 60     | 118,018.33 | 23.11.07       |
| 2   | Kanalizimi në rrugën „Holgen Pedersen"                                      | NNT„ABC"           | 30.03.07           | 17.04.07             | 30     | 18,319.00  | 15.05.07       |
| 3   | "Eqrem Çabej"                                                               | N.N.P<br>"Viadukt" | 16.05.07           | 14.07.07             | 60     | 157,486.53 | 16.07.07       |
| 4   | Ndërtimi i rrugëve lidhëse„Dëshmorët e Marevcit"                            | NPT<br>"Labi"      | 07.05.07           | 21.09.07             | 60     | 96,566.10  | 16.11.07       |
| 5   | Riparimi i rrugëve në QKUK                                                  | "Eskavatori"       | 29.05.07           | 22.09.07             | 60     | 87,520.55  | 16.10.07       |
| 6   | Riparimi i gropave në qytet                                                 | "Plan-Kos"         | 20.06.2007         | 17.10.2007           | 120    | 54,684.76  | 17.10.07       |
| 7   | "Selim Berisha"<br>"Metush Krasniqi"                                        | "Labi"             | 26.06.07           | 03.11.07             | 30     | 39,812.30  | 22.11.07       |
| 8   | Nërtimi i rrugës „Shpati"                                                   | "Labi"             | 02.07.07           |                      | 30     | 42,667.52  |                |
| 9   | Rregullimi i pasarelës                                                      | "Viadukt"          | 04.07.07           |                      | 60     | 166,450.99 |                |
| 10  | Ujësjetllësi „Agron Rrahmani"                                               | "Albaniku"         | 29.06.07           | 24.07.07             | 28     | 8,499.99   | 26.10.07       |
| 11  | Kanalizimi fekal Përroi i Njelmët                                           | "Gashi-Ing"        | 06.07.07           |                      |        | 66,632.46  | 07.11.07       |
| 12  | Ndër. i kanalizimit fekal në rrugën „Avdyl Lahu"                            | "Labi"             | 06.07.07           | 27.07.07             | 30     | 14,814.69  | 27.07.07       |
| 13  | Rregullimi i varrezave të dëshmorëve                                        | "Pro-Ing"          |                    |                      |        | 33,676.00  |                |
| 14  | Ndërtimi i rrugës<br>"Nënë Tereza"<br>"Eqrem Çabej"                         | "Viktoria-Invest"  | 13.07.07           |                      | 60     | 169,034.80 |                |
| 15  | " V. Fazliu"                                                                | "Gashi-Ing"        | 21.08.07           |                      | 90     |            |                |

|    |                                                                                                             |                            |          |           |    |            |          |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|----------|-----------|----|------------|----------|
|    | (Pjesa e Parë)                                                                                              |                            |          |           |    | 426,540.98 |          |
| 16 | “Mbretër. Teutë”                                                                                            |                            |          |           |    |            |          |
|    | Rruga<br>k. atmosferik<br>Ndriçimi                                                                          | “Noti”                     | 06.08.07 |           | 60 | 133,240.82 |          |
| 17 | “Kaqaniku”<br>“Abdyl Frashëri”<br><br>“Shaip Spahiu”<br>“Ali Kelmendi”<br>“Latif Berisha”<br>“Lordi Bajron” | NNP<br>„Dia-Co”            | 18.07.07 | 17.09.07  | 60 | 71,444.67  | 29.11.07 |
| 18 | Rrugët te Tregu<br>“Mehmet Kaquri”<br>“Taip Krasniqi”<br>“Vasil Andoni”<br>“Ylfete Humolli”                 | “Albaniku”                 | 30.08.07 |           | 60 | 154,986.09 |          |
|    | “Henrik Bariq”<br>“Zija Prishtina”<br>“Iljaz Agushi”<br>“Hamdi Mramori”                                     |                            |          |           |    |            |          |
| 19 | “Tahir Meha”<br>“Jan Kukuzeli”                                                                              | “Albaniku”                 | 30.08.07 |           | 60 | 81,106.59  |          |
| 20 | “Kukësi”                                                                                                    | “Labi”                     | 29.08.07 |           | 60 | 187,216.03 |          |
| 21 | “V. Fazliu”<br>(Pjesa e dytë)                                                                               | “Eskavator”                | 21.08.07 |           | 90 | 605,826.67 |          |
| 22 | “Eduard Lir”<br>“Bajram Curri”                                                                              | “Strasen Tibau”            | 06.08.07 |           | 60 | 183,052.15 |          |
| 23 | “Shefqet Shkupi”                                                                                            | Kolgeci                    | 16.08.07 | 20.11.07  | 60 | 79,536.00  |          |
| 24 | Bulevardi i<br>Dëshmorëve                                                                                   | “Euro Garten”              |          |           | 90 | 365,462.25 |          |
| 25 | “Mbreti Bardhyl”<br>“Maliq Pashë<br>Gjinolli”                                                               | “Euro Garten”              | 27.08.07 |           | 60 | 171,881.62 |          |
| 26 | Janjevë Sushicë                                                                                             | NPSH<br>“Bageri”           | 26.08.07 |           | 75 | 189,580.45 |          |
| 27 | Ndërtimi i rrugëve<br>lidhëse me<br>rrugën „Dëshmoret<br>e Marevcit”                                        | NNP<br>“Noti”              | 20.06.07 | 18.08.07  | 60 | 70,115.19  | 21.09.07 |
| 28 | “Muharre Fejzaz II”                                                                                         | “Kastrioti”<br>“Caraleva”  | 26.09.07 |           | 60 | 113,947.84 |          |
| 29 | “Ramë Govori”                                                                                               | “Labi”                     | 01.10.07 |           | 60 | 78,167.53  |          |
| 30 | “Kamer Loshi”                                                                                               | “ABC”                      | 06.08.07 | 20.11. 07 | 60 | 93,538.38  |          |
| 31 | Rruga kryesore në<br>Sofali                                                                                 | NNP „Strassen+Tief<br>bau” | 02.10.07 |           | 30 | 50,606.00  |          |

|          |                  |               |                       |  |    |              |  |
|----------|------------------|---------------|-----------------------|--|----|--------------|--|
| 32       | "Isa Kastrati"   | NNP           | 5.11.07               |  | 58 | 199,564.24   |  |
|          |                  | "Noti"        |                       |  |    |              |  |
| 33       | "Ismail Ismajli" | NTP<br>„Noti" | Nuk ëshë hapur ditari |  | 45 | 43,483.60    |  |
| Gjithsej |                  |               |                       |  |    | 4,373,481.12 |  |

### INVESTIMET E BARTURA NGA VITI 2007-2008

| Nr  | Emri i Projektit                                                                                                                                                    | Punëkryesi           | Kontrata<br>Nr.                 | Vlera e<br>punimeve € | Pagesa deri<br>më tani | Mbetja për<br>pagesë |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|---------------------------------|-----------------------|------------------------|----------------------|
| 1.  | Ndërtimi i rrugës "Shpati"                                                                                                                                          | "Labi"               | 616 07 050 521                  | 42,667.52             | 19,572.52              | 23,095.00            |
| 2.  | Rruga "Nëna Tereza" prej<br>hotelit "Grand" deri te<br>rruga "Eqrem Çabej"                                                                                          | "Viktoria<br>Invest" | 616 07 098 521<br>Dt.06.07.2007 | 169,034.80            | 84,517.00              | 84,517.80            |
| 3.  | "Vëllezërit Fazliu" (pjesa e<br>parë)                                                                                                                               | "Gashi Ing"          | 616 07 125 511<br>dt.13.07.2007 | 426,540.98            | 127,962.29             | 298,578.69           |
| 4.  | "Vëllezërit Fazliu" (pjesa e<br>dytë)                                                                                                                               | "Eskavatori<br>"     | 616 07 126 521<br>dt.13.07.2007 | 605,826.67            | 212,039.10             | 393,787.57           |
| 5.  | Te tregu rr.<br>"Mehmet Kaquri"<br>"Taip Krasniqi"<br>"Vasil Andoni"<br>"Ylfete Humolli"<br>"Henrik Bariqi"<br>"Zija Prishtina"<br>"Ilaz Agushi"<br>"Hamdi Mramori" | "Albaniku"           | 616 07140 521<br>dt.16.08.2007  | 154,986.09            | 32,252.57              | 122,733.52           |
| 6.  | "Mbretëresha Teutë"                                                                                                                                                 | "Noti"               | 616 07 107 521<br>dt.13.07.2007 | 133,240.82            | 66,620.42              | 66,620.40            |
| 7.  | "Tahir Meha" "Jan Kukuzeli"                                                                                                                                         | "Albaniku"           | 616 07 141 521<br>dt.16.08.2007 | 81,106.59             | 34,360.25              | 46,746.34            |
| 8.  | "Kuësi"                                                                                                                                                             | "Labi"               | 616 07 141 521<br>dt.22.08.2007 | 187,213.03            | 59,647.32              | 127,565.71           |
| 9.  | "Eduard Lir" "Bajram Curri"                                                                                                                                         | "Shtrasen<br>Tifbau" | 616 07 115 521                  | 183,052.15            | 91,526.07              | 91,526.08            |
| 10. | Bulevardi i Dëshmorëve                                                                                                                                              | "Euro<br>Garten"     | 616 07 150 521                  | 365,462.25            | 139,231.97             | 226,230.28           |
| 11. | "Mbreti Bardhyl" "Maliq<br>Pashë Gjinolli"                                                                                                                          | "Euro<br>Garten"     | 616 07 145 521                  | 171,881.62            | 85,940.81              | 85,940.81            |
| 12. | Janjevë - Sushicë                                                                                                                                                   | "Bageri"             | 616 07 096 521                  | 189,580.45            |                        | 189,580.45           |
| 13. | "Muharrem Fejza -II "                                                                                                                                               | "Kastrioti"          | 616 07 170 521                  | 113,947.84            | 80,000.00              | 33,947.84            |
| 14. | "Ramë Govori"                                                                                                                                                       | "Labi"               | 616 07 096 521<br>24.09.2007    | 78,167.53             | 39,083.73              | 39,083.80            |
| 15. | Rruga për Sofali                                                                                                                                                    | "Shtrasen<br>Tifbau" | 616 07 146 521<br>26.09.2007    | 50,606.00             | 19,892.50              | 30,713.50            |
| 16. | "Isa Kastrati"                                                                                                                                                      | "Noti"               | 616 07 183 521<br>dt.30.10.2007 | 199,564.24            | 0.00                   | 199,564.24           |
| 17. | "Vëllezërit Fazliu"-Elektrika                                                                                                                                       |                      | 616 07 175 521                  | 93,045.85             | 46,522.92              | 46,522.93            |

|     |                                         |             |                                 |                     |                     |                     |
|-----|-----------------------------------------|-------------|---------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
|     |                                         | Monten      | dt.30.10.2007                   |                     |                     |                     |
| 18. | "Metush Krasniqi"                       | "Noti"      | 616 07 184 521                  | 14,721.40           | 0.00                | 14,721.40           |
| 19. | Muri mbrojtës në rr."Vëllezërit Fazliu" | "Gashi Ing" | 616 07 232 521<br>dt.12.11.2007 | 87,773.76           | 43,886.88           | 43,886.88           |
|     |                                         |             |                                 | <b>3,348,419.59</b> | <b>1,183,056.35</b> | <b>2,165,363.24</b> |

Vlera e projekteve të kontraktuara për vitin 2007.....**4,373,481,12 €**  
 -Të paguara gjatë vitit 2007.....**2,208,117,88 €**  
 -Të përcjellura për vitin vijues.....**2,165,363,24 €**

Gjatësia e rrugëve ..... **1=21842,98 m**  
 Sipërfaqja e asfaltuar ..... **75092,50 m<sup>2</sup>**  
 Sipërfaqja e trotuareve me kubza ..... **27199,00 m<sup>2</sup>**  
 Rrugët e shtruara me zhavorr ..... **1.137,00 m**  
 Kanalizimi fekal ..... **3028,80 m**  
 Kanalizimi atmosferik ..... **2593.56 m**

## SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit dhe mbrojtjes së ambientit gjatë kësaj periudhe raportuese, është përqendruar në realizimin e punëve të parapara sipas Planit të punës së drejtorisë për vitin 2007. Kryesisht përqendrimi i aktiviteteve ka qenë rreth transportit publik, sinjalizimit në përgjithësi dhe parkingjeve.

### Organizimi i transportit :

Në kuadër të angazhimit të avancimit të transportit në përgjithësi, Sektori i transportit gjatë kësaj periudhe, ka kryer këto punë:

- Është përcjellë në vazhdimësi mbarëvajtja e transportit publik në territorin e komunës së Prishtinës;
- Pjesëmarrje në "workshop" njëditor për transportin publik urban të mbajtur në Shkup, më 8 qershor 2007, të organizuar nga UITP – Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Publik me seli në Bruksel;
- Është bërë vazhdimi i orarit të udhëtimit për të gjitha linjat e brenda territorit të komunës së Prishtinës;
- Është bërë vazhdimi i orareve për operimin e transportit publik me Fushë-Kosovë dhe fshatrat e saj, përderisa marrëveshja me KK-në e Obiliqit është përcjellë me mosefikasitet nga ana e KK-së së Obiliqit për zbatimin e plotë të marrëveshjes;
- Kanë vazhduar procedurat për programin e Bankës Botërore për hartimin e planit të veprimit dhe investimeve për qytetin e Prishtinës, në mënyrë që të bëhet përmirësimi i transportit, parkingjeve publike, semaforëve etj;
- Pjesëmarrje në Konferencën për Transport Publik dhe Planifikim Hapësinor në Kosovë, të mbajtur në Prishtinë, më 31 tetor 2007, të organizuar nga UN-Habitat,

- MTPT-ja dhe MMPH-ja, në të cilën konferencë Sektori i Transportit është paraqitur me një prezantim me temë “Përmirësimi i qendrës së qytetit, zhvillimi urban dhe transporti publik”.

## **Parkingjet**

- Është bërë menaxhimi i Shërbimit “merimangë” dhe parkingut në Zonën industriale, ku vendosen automjetet e konfiskuara nga policia gjatë tërë vitit.
- Janë dhënë në shfrytëzim (të rezervuara) vendëparkime për institucione shtetërore të vendit dhe të huaja pa pagesë, si dhe për subjekte fitimprurëse me pagesë.
- Vazhdimi i shfrytëzimit me koncesion i parkingjeve publike të ndara në katër loto. Kontrata për menaxhimin e parkingjeve publike me pagesë ka skaduar më 30.6.2007. Më 18.9.2007 i kemi bërë kërkesë Departamentit të Prokurimit për vazhdimin ose ndërprerjen e kontratës. Menaxhimi i parkingjeve publike në rrugë me pagesë, është përcjellë me shumë vështirësi. Disa herë është bërë heqja e një pjese të vendëparkimeve për shkak të ndryshimit të qarkullimit apo mbylljes së rrugëve, e cila është përcjellë edhe me ndryshimin e vlerës së kompensimit nga kontraktori. Kompensimet nga kontraktori janë bërë me vonesë dhe një pjesë e konsiderueshme e kompensimit nuk është bërë fare nga kontraktori. Për të gjitha këto parregullsi e kemi njoftuar Departamentin e Prokurimit.

## **Të hyrat e realizuara nga Sektori i transportit:**

|                                                            |                     |
|------------------------------------------------------------|---------------------|
| - Nga parkingjet e rezervuara.....                         | 14.620,00 €         |
| - Nga parkingjet me koncesion.....                         | 52.000,00 €         |
| - Nga parkingut në oborrin e shkollës “Xhevdet Doda” ..... | 6.485,00 €          |
| - Nga shërbimi me “merimangë” .....                        | 69.379,15 €         |
| - Nga kalimi i laurës për Gërmi .....                      | 80.406,70 €         |
| <b>Gjithsej.....</b>                                       | <b>222.890,85 €</b> |

## **Sinjalizimi horizontal dhe vertikal:**

- Kontrata e sinjalizimit është vazhduar edhe për muajt prill dhe maj 2007, dhe gjatë kësaj periudhe janë bërë plotësime në sinjalizimin e 63 rrugëve.
- Është bashkëpunuar vazhdimisht me Drejtorinë e Trafikut dhe Njësinë Rajonale të Trafikut të SHPK-së për përmirësimin e shumë çështjeve të trafikut.
- Janë hartuar skica të sinjalizimit për disa rrugë dhe lagje të Prishtinës.
- Është bërë edhe projekti i skicuar i sinjalizimit për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).
- Është përgatitur dhe përcjellur materiali tenderues për sinjalizim horizontal dhe vertikal për vitin në vijim.

## **Lëndë të shqyrtuara**

Gjatë vitit 2007 janë shqyrtuar **250 lëndë**.

## Plani strategjik zhvillimor

Hartimi i strategjisë zhvillimore afatmesme 2007-2011 të Prishtinës, në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest". Gjatë hartimit të këtij plani është paraqitur gjendja aktuale, problemet, sfidat, si dhe planet për 2008 – 2011.

### SHËRBIMI I MBROJTJES SË AMBIENTIT

Përqendrimi i aktiviteteve të Shërbimit të mbrojtjes së ambientit ka qenë rreth mirëmbajtjes së sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit, të parapara me tenderin e përgatitur nga ky shërbim dhe shqyrtimi i kërkesave (lëndëve) të komunitetit. Në tenderin e përgatitur nga Shërbimi i mbrojtjes së ambientit për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit, kanë qenë të përfshira **422 587 m<sup>2</sup>**, pra nga viti 2006 nuk ka pas ndryshim të sipërfaqes për shkak të kufizimit të mjeteve buxhetore.

Mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit i është besuar NPK "Hortikultura" dhe ka qenë e ndarë në pesë zona:

- Zona I ka përfshirë këto sipërfaqe: Varrezat e Dëshmorëve dhe Varrezat e Jahudive;
- Zona II ka përfshirë Ulpianën;
- Zona III ka përfshirë Qendrën;
- Zona IV ka përfshirë Dardaninë;
- Zona V ka përfshirë Kodrën e Diellit.

Mbikëqyrjen në realizimin e punëve rreth mirëmbajtjes e kanë kryer bashkpuntorët e Shërbimit të mbrojtjes së ambientit.

Gjatë kësaj periudhe kohore ky shërbim i ka paraqitë dy oferta Departamentit të Prokurimit:

- Ofertën për rregullimin-riparimin e rrethojave të dëmtuara në rrugët e qytetit dhe
- Ofertën për krasitjen e drurëve në qytet.

Përgatitjen e projekteve të reja, të cilat janë paraparë për vitin 2008.

Për periudhën njëvjeçare Shërbimi i mbrojtjes së ambientit ka pranuar nga komuniteti 28 kërkesa për rregullimin e sipërfaqeve gjelbëruese para objekteve të banimit.

- **21 pëlqime ,**
- **7 njoftime.**

Shërbimi ka pasur dy (2) kërkesa për intervenim në terren nga ana e Inspeksionit, 1 plotësim kërkesë dhe ka pasur 13 situacione për pagesë për ndërmarrjen e cila ka bërë mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit.

### XIII. DREJTORATI I SIGURISË CIVILE DHE EMERGJENCËS

Drejtoria e Sigurisë Civile dhe Emergjencës, detyrat dhe aktivitetet e ka realizuar në bazë të Programit të rregullt të punës për vitin 2007. Gjatë vitit ka pas edhe detyra shtesë, të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për t'u realizuar.

Programimi i punëve është bërë në bazë të dispozitave të mëposhtme:

- Statutin e Komunës,
- Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45, për veteqeverisjen e komunave të Kosovës,
- Ligjin për mbrojtje nga zjarri,
- Ligjin mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,
- Rregulloren mbi shërbimin emergjent të Kosovës,
- Referencat nga Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave,
- Programin vjetor të punës së Drejtoratit,
- Rregulloren mbi organizimin e brendshëm të Komunës dhe angazhimit të Drejtoratit konform situatave emergjente në territorin e komunës së Prishtinës dhe më gjerë.

Gjatë vitit kalendarik janar – dhjetor 2007, janë hartuar dy plane të rëndësishme:

- Plani i reagimit emergjent për ndërtesën e Kuvendit dhe
- Plani operacional për luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së shpesëve "AVIAN INFLUENZA".

Të gjitha detyrat dhe aktivitetet e programuara për këtë vit, janë realizuar në bashkëpunim – bashkëveprim me Bordin e Drejtorëve, Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave, TMK-në, SHPK-në, UNMIK-un, KFOR-in, Qendrën e Mjeksisë Familjare, Entin për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore, Kryqin e Kuq Komunal dhe atë Rajonal, komunat e rajonit të Prishtinës, ndërmarrjet publike e private, në veçanti bashkësitë lokale dhe subjektet tjera relevante komunale.

Gjatë këtij viti drejtoria prioritet të veçantë u ka kushtuar strehimoreve publike, që t'i rikthejmë në pronësi të Komunës dhe ato të përgatiten për destinimin që kanë, por kemi hasur në vështirësi të mëdha procedurale dhe nuk e kemi përfunduar me sukses këtë punë. Vëmendje të posaçme i kemi kushtuar angazhimit tonë në përgatitjen e dokumentacionit të duhur për ngritjen e Bazës së re të zjarrfikësve por pa sukses. Ekipi i caktuar nga drejtoria, në bashkëpunim me grupet tjera profesionale, kanë përgatitur me sukses Ligjin për mbrojtje nga zjarri dhe Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Kohë më parë Ligji është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Janë bërë planifikimet me kohë dhe në mënyrë profesionale të këshillimeve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme, me qëllim të ngritjes profesionale të të punësuarve në këtë drejtori, e sidomos të atyre të Brigadës së Zjarrfikësve.

Prioritet i veçant i është kushtuar punës së inspektorëve të mbrojtjes civile, të cilët gjatë vitit 2007 janë angazhuar në realizimin e programit të punës së tyre, të dizajnuar në suaza të Programit unik të drejtorisë, i cili në veçanti përfshinë:

- Përmbledhjen dhe përpunimi i të dhënave në hartimin e procesverbaleve për punën e kryer në vizitat e objekteve të banimit në Bashkësinë III, IV dhe V lokale;

- Hartimin e propozimkërkesës për inicimin e ndërmarrjes së masave në mënjanimin e keqpërdorimeve nëpër objekte banimi, të konstatuara gjatë inspektimit për secilën bashkësi lokale, veç e veç;
- Në bashkëpunim me Bashkësitë III, IV, V, VI dhe VII lokale, është hartuar shkresa me shpjegimet e duhura dhe është kërkuar dërgimi i të dhënave mbi banesat mbi katërkatëshe në territorin e secilës BL;
- Pjesëmarrja në mbledhjet e rregullta të bashkësive lokale, të organizuara nga ana e Drejtorisë së Administratës;
- Informatën mbi inspektimin e Mbrojtjes Civile të kryer nëpër objektet e banimit mbi pesë kate në territorin e Bashkësisë I, II dhe III lokale, dërguar Bordit të drejtorëve për shqyrtim dhe miratim, disa drejtorive dhe Kuvendit të Komunës. Me këtë informatë janë cekur të metat që kanosin jetën dhe pasurinë e qytetarëve nëpër objektet e banimit, si dhe keqpërdorimet dhe uzurpimet e tyre, me theks të veçantë nëpër secilën Bashkësi lokale, respektivisht objektin e banimit. Gjatë këtyre vizitave janë inspektuar mbi 90 objekte banimi, të cilat kanë më shumë se dy hyrje. Këtu vlenë të përmenden objektet C-7 dhe C-12, që kanë më shumë se 10 hyrje, ose objekti të Kurrizi, me 8 hyrje dhe me 14 kate, me mbi 3 000 banorë;
- Karakteristikat themelore të këtyre vizitave janë: uzurpimet e hapësirave të përbashkëta rrezikimi dhe pengimi i qarkullimit të lirë të banuesve nëpër objekte, mbi ndërtimet pothuaj se nëpër të gjitha objektet e vizituara, papastërtia nëpër bodrume dhe hapësira të përbashkëta, mungesa e aparateve të zjarrfikjes dhe hidranteve, mungesa e shkallëve emergjente më shumë se 95% të objekteve, instalimet e rrymës elektrike të ekspozuara rreziqeve të shumta, mungesa e liftave, kablllo të ndryshme të zvaritur nëpër hyrje të objekteve, antenat e shumta të ekspozuara nëpër kulmet e objekteve të kompanive të ndryshme pa leje dhe kriteriume të veprimtarisë;
- Janë urdhëruar 65 masa dhe urdhëresa Drejtorisë së Inspektionit;
- Pjesëmarrja në organizimin dhe zbatimin e ushtrimit teorik dhe praktik nëpër bashkësi lokale, me theks të veçantë në përgatitjen e strukturave civile të bashkësive lokale në rastet emergjente.

Detyrat dhe aktivitetet në këtë drejtori janë realizuar në kuadër të dy sektorëve: Sektori i mbrojtjes civile dhe Sektori i emergjencës. Por, gjatë realizimit të detyrave pothuajse nuk ka pasur dallime në mes sektorëve. Në kuadër të Sektorit të emergjencës ka vepruar Brigada e Zjarrfikësve (BZP-ja) me dy punktet e veta të stacionuara: i pari në Kodrën e Trimave - Prishtina II dhe i dyti në Llaple-Sellë.

Brigada me punktet e veta, është e specializuar dhe e aftësuar për fikjen e zjarrit dhe avarive tjera teknike, shpëtimin e njerëzve dhe të mirave materiale të rrezikuara nga zjarri, në fatkeqësitë elementare dhe natyrore, përmbytjet nga uji etj. Kjo Brigadë përpos në territorin e komunës së Prishtinës, fushëveprimin e vetë e ka edhe në Komunën e Fushë-Kosovës dhe të Kastriotit. Në raste të veçanta intervenon edhe në komunat e rajonit të Prishtinës (Lypjan, Podujevë, Skenderaj etj.).

Gjatë periudhës raportuese Brigada i ka kryer detyrat e veta të parapara sipas Ligjit për mbrojtjen nga zjarri me sukses të plotë.

Objektivi kryesor i BZP-së për vitn raportues ka qenë aftësimi dhe riaftësimi i punëtorëve në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të njerëzve dhe të të mirave materiale. Prioritet dhe problem kryesor për ne ende ka mbetur furnizimi me pajisje personale dhe kolektive, të cilat, në krahasim me periudhat raportuese të mëhershme, janë përmirësuar.

Trajnimet pranë Akademisë Policore në Vushtrri kanë vazhduar si në vitet e mëparshme, të cilat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen dhe do të jenë më intensive.

Kërkesat për blerje nga buxheti të cilin e posedon Brigada, planifikohet me Drejtoratin e DMCE-së të KK Prishtinës. Edhe në këtë vit është bërë shumë pak, por, krahasuar me ato të vitit të kaluar, është dukshëm më mirë. Nisma më e mbarë në furnizim është falë mirëkuptimit të përgjegjësve nga Komuna, me çka rezulton blerja e dy automjeteve për fikjen e zjarrit (një automjet “sulmues” dhe një autocisternë, që të dyjat të përdorura). Duhet theksuar se në përfundim e sipër janë tenderët për pajisje tjera të nevojshme për BZP-në.

Pos furnizimit me pajisje kolektive duhet blerë edhe ato personale, të cilat janë më se të domosdoshme.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Brigada ka pasur disa intervenime me karakteristike në krahasim me periudhat tjera. Si çdo herë, në këto raste është vërejtur mungesa e pajisjeve për fikjen e zjarrit, për të cilat ne po insistojmë në blerjen e tyre. Këto mungesa ishin më të theksuara gjatë verës, kur ishin temperaturat e larta dhe kishte shumë zjarre malore dhe fushore. Nga DME -ja e Ministrisë janë dhuruar disa pajisje për fikjen e zjarreve malore që ka ndikuar sado pak për të mirën tonë. Në këtë periudhë ishin në prishje shkallët automatike, të cilat shërbejnë për shpëtim dhe fikje nga lartësia. Kërkesa për rregullimin dhe servisimin e tyre është bërë, e cila duhet të kryhet në muajin tetor. Mungesa e ndihmës dhe bashkëpunimit nga njësitë më të afërta nuk ka munguar, por këto ndihma ishin të vonuara. Prandaj, mbetet edhe më tutje si prioritet furnizimi me pajisje kolektive bashkëkohore.

Intervenimet e paraqitura në mënyrë tabelare:

| KOMUNA       | ZJARRE | INTER-<br>VENIME<br>TEKNIKE | PJESËMARRËS |        |             | TË<br>LËNDUAR<br>ZJARRFIK. | TË<br>VDEKUR<br>ZJARRF. |
|--------------|--------|-----------------------------|-------------|--------|-------------|----------------------------|-------------------------|
|              |        |                             | ZJARRFIK.   | AUTOM. | ORË<br>PUNE |                            |                         |
| Prishtinë    | 714    | 126                         | 6730        | 1580   | 3392,45     | 6                          |                         |
| Fushë-Kosovë | 51     | 4                           | 248         | 78     | 707,22      |                            |                         |
| Kastriot     | 80     | 11                          | 243         | 150    | 511,11      |                            |                         |
| Lypjan       | 23     | 17                          | 104         | 49     | 71,48       |                            |                         |
| Drenas       | 2      | -                           | 8           | 3      | 49,35       |                            |                         |
| Vushtrri     | 2      | -                           | 8           | 2      | 22,00       |                            |                         |
| Podujevë     | 10     | -                           | 36          | 11     | 62,55       |                            |                         |
| Gjithsej:    | 882    | 158                         | 7377        | 1873   | 4816,16     | 6                          |                         |

Gjatë vitit janë bërë azhurimet e nevojshme dhe plotësuese të planeve ekzistuese të Drejtoratit dhe të shtabeve të MC-ve në BL. Kemi hartuar Marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të DMC-së dhe SHPK-së, KEK-ut, ujësjellësit rajonal "Prishtina", Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Termokosit për koordinimin dhe bashkëpunimin në mes veti gjatë intervenimeve në rast të fatkeqësive natyrore, apo fatkeqësive tjera në territorin e komunës së Prishtinës. Kjo marrëveshje nuk u nënshkrua edhe sot e kësaj dite në mungesë të mjeteve materiale, por marrëveshja është e një rëndësie të veçantë dhe do të angazhohemi që të realizohet sa më parë. Kemi organizuar trajnime të ndryshme me shtabet e MC-ve të BL-ve, kemi formuar Shtabin e Krizës me rastin e shfaqjes së temperaturave të larta që kanë mbretëruar këtë vit.

Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim ( QIAK ) ka funksionuar 24 orë pa ndërpreë, e cila luan rol të rëndësishëm në marrjen dhe shkëmbimin e informatave për raste emergjente. Në QIAK janë përgatitur : informatat ditore, raportet javore, ID kartat për shërbyes civilë. Verifikon rregullisht radiolidhjet në BL-të, në zonat rurale dhe në subjektet komunale që janë të pajisura me radiolidhje.

Përpos zjarreve, një angazhim të posaçëm ka pas në realizimin e kërkesës së Bordit të drejtorëve të KK-së së Prishtinës, në bazë të Vendimit 01. Nr.931-82, të datës 3.5.2007 për formimin e Komisionit për vlerësimin e rrezikshmërisë nga pompat e benzinës.

### **Inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit**

Ky inspektorat pas marrjes së kësaj detyre, ka kontrolluar 32 stacione të benzinës në territorin e Prishtinës dhe kanë konstatuar me sa vijon:

- a) Stacionet e benzinës në pronesi shtetërore, të ndërtuara para lufte ( të ish-INA-s së Zagrebit dhe ato të ish-Jugopetrolit), të cilat kanë pasur leje ndërtimi, tani nuk disponojnë me Licencë pune nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, gjashtë prej tyre i shfrytëzon "Kosova - Petrol", tri prej tyre janë në shfrytëzim nga kompanitë private.
- b) Nga stacionet e benzinës të ndërtuara pas lufte, leje ndërtimi ka siguruar vetëm Kompania "OTI-Group" nga QPK.
- c) Në 39 stacione të benzinës të kontrolluara, është konstatuar se edhe pse nuk disponojnë me leje ndërtimi (pranim teknik dhe projekt dokumentacion investivo-teknik), si të tilla 24 stacione të benzinës kanë siguruar Licencën e punës nga MTI-ja, (disa prej tyre me shumë mangësi teknike dhe masa mbrojtëse nga zjarri).
- d) 15 stacione të benzinës nuk kanë siguruar Licencën e punës, ndonëse disa prej tyre jenë në gjendje të mirë teknike dhe i zbatojnë masat e parandalimit nga zjarri.
- e) Gjatë kontrollit të stacioneve të benzinës dhe konstatimit të gjendjes, një numër i madh i pronarëve kanë ndërmarr masa të shpejta për evitimin e të metave teknike, një numër i konsideruar në ndërkohë ka kryer obligimet e shqyrtimeve të rregullsive teknike, gjë që kontrolli ka ndikuar pozitivisht dhe pronarët janë shprehur se do të sigurojnë të gjitha obligimet sipas Rregullorës për ndërtimin e stacionit të benzinës.

Inspektorati ka kontrolluar objektet afariste private dhe publike, ka ndërmarrë masa në parandalimin e zjarrit, për të cilat rregullisht ka informuar Drejtoratin, Bordin e drejtoreshave, Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave në kuadër të Ministrisë.

Në periudhën për të cilën po raportojmë, nga zjarri janë lënduar 6 punonjës të Brigadës së Zjarrfikës. Lëndimet kanë qenë të natyrës së lehtë, ku janë lënduar disa qytetarë dhe është shkaktuar dëm në vlerë prej 340 000 €.

Për t'i realizuar me sukses detyrat dhe objektivat e parapara me planin e punës, numri i inspektorëve të parandalimit duhet të rritet.

Gjatë vitit në, kuadër të drejtorisë është kryer me sukses inventarizimi i të gjitha mjeteve materialo-teknike, duke e përfshirë këtu edhe Brigadën e Zjarrfikësve.

Për funksionimin e drejtorisë nga buxheti i Komunës janë ndarë gjithsej 1 030 487, 00 €, prej tyre 694 262, 00 € për shpenzime kapitale dhe 336 225, 00 € për pagat e shërbyesve civilë dhe të zjarrfikësve.

Nga mjetet e caktuara për shërbime kapitale, deri më 20.12.2007 janë shpenzuar 345 572, 42 € ose 49.78 %.

Pasqyra e mjeteve të shpenzuara:

a) Shpenzimet kapitale:

|                                                           |                  |
|-----------------------------------------------------------|------------------|
| - Blerja e një autocisterne sulmuese.....                 | 124.000,00 €     |
| - Rregullimi i sinjalizimit të qytetit .....              | 49.852,00 €      |
| - Pajisja e zjarrfikësve me rroba mbrojtëse speciale..... | 58.650,00 €      |
| - Pajisja me uniformë të punës për zjarr.....             | 29.709,00 €      |
| - Riparimi i automjetit me shkallë zjarrfikëse.....       | 34.900,00 €      |
| GJITHSEJ:                                                 | ... 297.111,00 € |

b) Për shërbime e mallra

|                                                   |                   |
|---------------------------------------------------|-------------------|
| - Për derivate .....                              | 24.797,71 €       |
| - Para të gatshme .....                           | 9.829,71 €        |
| - Mirëmbajtje të zyrave, Qendrës .....            | 2.000,00 €        |
| - Shpenzime tjera .....                           | 6.214,00 €        |
| - Shpenzime materiale gjatë punës në terren ..... | 5.620,00 €        |
| GJITHSEJ:                                         | ..... 48.461,42 € |

Mjetet e parapara për paga dhe mëditje të shërbyesve civilë janë shfrytëzuar në tërësi.

#### XIV. ZYRA E KOMUNITETEVE

Zyra e Komunitete në Graçanicë është kujdesur për komunitete joshumicë në komunën e Prishtinës, në pajtim me kompetencat dhe në koordinim me udhëheqesit komunalë.

Në pjesën e administratës së përgjithshme, Zyra ka punuar në pajtim me rregullativën në fuqi, duke promovuar tolerancë dhe barazi për të gjithë ata që i janë drejtuar Zyrës së Komuniteteve.

Shfrytëzimi i mjeteve është bërë në pajtim me buxhetin e miratuar dhe rregullat e procedurave financiare të Komunës. Shpërndarja e mjeteve për investime kapitale, është mbështetur në përfaqësimin e bashkësive dhe në përfaqësimin e numrit të fshatrave, duke u kujdesur për nevojat e përbashkëta dhe nevojat momentale për disa projekte.

Zyra ka pasur aktivitete dhe kontakte të rregullta me palë, përfaqësues të fshatrave, përfaqësues të bashkësive, të organeve të administratës, të institucioneve arsimore dhe shëndëtsore të Komunës, të ndërmarrjeve komunale, të IPVQ-ve, të SHPK-së, të Policisë së UNMIK-ut, të UNHAC-së, të KFOR-it, të OJQ-ve etj.

### **Shërbimi i administratës së përgjithshme dhe i financave**

Aktivitetet e këtij shërbimi për vitin 2007, kanë pasur të bëjnë me:

- Përgatitjen dhe miratimin e planit të punës për vitin vijues dhe raportin e punës për vitin 2007 për Komitetin për Komunitete, përkatesisht aktivitetet e shërbimit financiar dhe angazhimin rreth hartimit të dokumentacionit "Fer-cher" për vitin paraprak afarist;
- Mbledhjet javore dhe mujore mbi aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së punës, punës me palë, ruajtjen e pasurisë dhe të personave të Zyrës së Komunitete në Graçanicë;
- Kontaktet e përherëshme me Drejtoratinë e Administratës së Përgjithshme në Prishtinë, si dhe me Zyrën ligjore, sipas çështjeve vijuese, lidhur me përgjegjësitë disiplinore të punëtorëve, rastet e përfaqësimit para gjykatave kompetente lidhur me paditë e personave fizikë dhe juridikë;
- Prania e përherëshme dhe aktive e shërbimit në punën e Shërbimit të ofiqarisë, sektori në Graçanicë;
- Plotësimin e dosjeve të punëtorëve me prova për personelin e Komunës së Prishtinës;
- Ka pasur bashkëpunim të përhershëm me Zyrën për Komunitetet Pakicë, me seli në Prishtinë, për shqyrtimin e problemeve të bashkësive pakicë në qytet dhe fshat.

### **Financat**

Pas miratimit të buxhetit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, udhëheqësi financiar i Zyrës së Komuniteteve, ka hartuar dinamikën e realizimit të tij për vitin raportues. Mjetet prej 4.1% (254 545, 00€) janë paraparë për investime kapitale, mallra, shërbime dhe të ardhura për 24 punëtorë të punësuar në zyrë, dhe atë:

- investime kapitale .....113.048,00 €
- mallra dhe shërbime .....77.927,00 €
- pagat e punëtorëve .....63.570,00 €

Në bazë të formularit "Fer-cher" vjetor, përkatësisht përfundimtar, realizimi i paraparë me buxhet për vitin afarist 2007 mbi shpërndarjen dhe realizimin e mjeteve financiare, ka qenë si vijon:

Për investime kapitale:

- nga buxheti i Zyrës së Komuniteteve janë realizuar.....77.321,00 €
- nga buxheti i Komunës .....52.362,00 €

Për mallra dhe shërbime janë realizuar.....85.009,00 €

Përshkrimi i mjeteve të realizuara për investime kapitale, pason nga Sektori i shërbimeve publike, ndërsa për mallra dhe shërbime janë financuar projektet me shumë më të vogël, e që janë në pajtim me rregullat e Ministrisë së Financave, si dhe mjetet nga “Paty-cesha” për nevoja të zyrës.

Për të ardhura personale të punëtorëve janë realizuar mjete në shumën prej...48.197,50€.

### **Sektori i shërbimeve publike**

Sektori i shërbimeve publike, ZKK në Graçanicë, me shërbimet-nëpunësit: Shërbimin e planifikimit urbanistik, Shërbimi i inspektionit, Shërbimi kadastral, nëpunësi për zhvillim ekonomik, nëpunësi për bujqësi – Bërnica e Poshtëme, nëpunësi për zhvillim në Slivovë. Aktivitetet kryesore kanë pasur në planifikim edhe realizimin e buxhetit të parapar financiar, përmes hartimit të dokumentacionit projektues teknik të infrastrukturës dhe problemeve komunale për bashkësinë serbe dhe për të gjitha bashkësitë tjera etnike (rome, turke, boshnjake e ashkali) të Komunës së Prishtinës.

Projektet më me rëndësi të realizuara në vitin paraprak 2007, janë:

- Punimi i rrethojës për terrenin sportiv në Graçanicë, nga punëkryesi NP “Motoja” Prugoc;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellesit Kishnicë – Sushicë, në gjatësi prej 3 km, nga punëkryesi NP “NIN” Graçanicë;
- Pastrimi i plehërave në bashkësitë serbe, nga punëkryesi NP “Pastrimi” Prishtinë;
- Projekti për zhdukjen e qëneve endacakë në pjesë të ndryshme në Graçanicë dhe fshatrat: Lapla- Sellë, Sushice, Preoc, Çagllavicë, Kishinicë;
- Projekti për ndriçimin rrugor, sanimin komplet të ndriçimit nëpër fshatra të cilat i mbulon ZKK në Graçanicë.

Përveç projekteve të cekura, janë hartuar edhe projekte më të vogla në të gjitha mjediset e komunës së Prishtinës me bashkësi shumicë serbe dhe me bashkësi tjera joshumicë-projekte me përmbajtje – përmirsimin e kushteve jetësore për të gjitha komunitetet etnike.

Në vitin paraprak 2007, në realizimin e projekteve të cekura, ka pasur ngecje lidhur me infrastrukturën në përgjithësi në bashkësinë serbe dhe në bashkësitë tjera. Arsyeja është e thjeshtë – mungesë e buxhetit. Problemet me të cilat ballafaqohet ZKK në Graçanicë janë edhe:

- moszgjidhja e çështjes së banimit për të shpërngulurit, shpërngulurit e brendshëm dhe familjet si raste sociale;
- zgjidhja e problemit të deponimë, punët e fazës së parë kanë filluar në vitin 2006 dhe në vitin e raportimit të njëjta ende nuk ka përfunduar;
- asfaltimi i rruges që lidhë Graçanicën me fshatin Lapla- Sellë.

Me kontributin që ka dhënë përfaqësuesi i bashkësisë rome në gjetjen e donatoreve, është ndërtuar Qendra Arsimore Rome në sipërfaqe prej 80 m2, realizimi i së cilës ka qenë 50%

nga ana KFOR-it, si formë e mjeteve të donatorëve dhe 50% nga ana ZKK-së në Graçanicë, punëkryesi i punëve ka qenë NP "Motoja" me seli në fshatin Prugoc. Gjithashtu, është bërë sanimi i mbulesave të puseta të kanalizimit në lagjen e romëve.

### **Shërbimi i inspektionit**

Në periudhën raportuese shërbimi i inspektionit i ka përmbushur detyrat e parapara me aktin normativ për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

### **Inspektori i ndërtimtarisë**

Ka parandaluar ndërtimet pa leje dhe ka kryer detyrat tjera. Ka bërë inspektimin e objekteve të cilat kanë filluar të ndërtohen, ka hartuar procesverbalin dhe, në rastet e ndërtimit pa leje, ka marrë masa për ndalimin e tyre deri në sigurimin e lejeve përkatëse.

### **Inspektori komunal**

Gjatë vitit raportues i ka përmbush këto detyra:

- Vizita të rregullta në terren për parandalimin e shitësve ambulantë në vendet ku ky aktivitet është i ndaluar;
- Evidencimi i njohësve të energjisë elektrike në Shtëpinë e Kuluturës;
- Evidencimi i deponive në Graçanicë dhe në fshtrat përreth;
- Puna në parandalimin e shpenzimit të ujit dhe evidencimi i problemeve lidhur me punën e rrjetit të ujesjellesit;
- Kontrollimi i higjienës dhe pastrimi i mbeturinave në Graçanicë dhe në fshatrat përreth;
- Prandalimi i shfrytëzimit të trotuareve gjatë punëve ndërtimore dhe parandalimi i lëndimeve eventuale të qytetarve në trotuare dhe rruge etj.
- Evidencimi i uzurpimit të tokës në pronësi komunale dhe i mënyrës së vendosjes së qoshqeve.

### **Shërbimi i gjeodezisë**

Gjeometri ka punuar për matjen në terren, në bazë të kërkesave të paraqitura nga palët fizike apo juridike, ka shqyrtuar kërkesat për lëshimin e certifikatave për rregullimin e të drejtës për ndihmë sociale.

### **Nëpunësi për zhvillim ekonomik**

Shërbimi për zhvillim ekonomik në Graçanicë ka realizuar projekte për bujqesinë ekzistuese, duke futur risi në procesin e prodhimit dhe duke stimuluar ekonominë e vogël dhe të mesme me anë të donacioneve, të cilat janë siguruar nga kontingjenti i KFOR-it finlandez, përmes fondit CIMIC, i cili u realizua në fillim të gjysmës së dytë të vitit 2007. Përmes fondit CIMIC janë financuar pesë projekte individuale, (3 serbë + një turk + një ashkali), në vlerën e përgjithshme prej 18 990 €.

Në kuadër të aktiviteteve të Shërbimit për zhvillim ekonomik në vitin 2007, është punuar në çështjen e furnizimit dhe rregullimin e kontejnerëve në lagjen “Vocar” dhe “Padalishte”, si dhe në sigurimin e kontejnerëve dhe vendosjen e personave të shpërngulur intern, familjeve të rrezikuara sociale dhe refugjatëve në territorin të cilin më kompetencat e veta e mbulon Zyra e Komuniteteve në Graçanicë.

Gjithashtu, ka organizuar një numër të madh të takimeve lidhur me rregullimin e hapësirës rreth kontejnerëve dhe sigurimin e kontejnerëve për krijimin e kushteve për jetë normale në qendroën kolektive “Padalishte”. Si rezultat i këtyre mbledhjeve është arritur që Ministria për Kthim dhe Komunitete, t’i ndajë 17.500 €, mjete financiare të cilat do të përdoren për ndërtimin e kulmeve, strehëve, ndriçimit dhe tamponimin e hapësirave në tokën përreth kontejnerëve.

### **Nëpunësi për bujqësi në fshatin Bërnice e Poshtme**

Nëpunësi për bujqësi ka punuar në përmirësimin e kushteve të banorëve të fshatit Bërnice e Poshtme, duke i realizuar projektet e parapara për vitin 2007.

Përmes OJQ-ve janë realizuar këto projekte: rrjeti kabllor, punëtoritë për mekanik dhe punët e shtëpiakut.

Duke marrë parasysh se ZKK-ja në Graçanicë është shumë e vogël për vendbanimet e veriut të Prishtinës: Bërnica e Poshtme, Bërnica e Epërme, ekzistojnë shumë objekte infrastrukturale komunale të pazgjidhura.

### **Nëpunësi për zhvillim – Slivovë**

Gjatë vitit 2007, në Zyrën e Komunitete në Graçanicë – Nënzyra në Slivovë, ka pasur këto aktivitete:

- Bashkëpunimi me KFOR-in suedez lidhur me çështjen e sigurisë në vendbanimet e vogla në rajonin e Slivovës dhe Dragovcit, dhe vendosja e bashkëpunimit shumetnik në mes të komuniteteve në Slivovë, pastrimi i rrugëve lokale nga bora në periudhën e dimrit;
- Bashkëpunimi me KFOR-in suedez lidhur me çështjen e ofrimit të ndihmës humanitare dhe sociale familjeve të rrezikuara në rajonin e Slivovës. Si rezultat i bashkëpunimit është shpërndarja e ndihmës humanitare në formë ushqimi, mjete higjienike, mbathje, veshje, lëndë djegëse etj;
- Bashkëpunimi me organizata NVO (“Mercy Corps”, “DRC”,) UNDP dhe UNHCR, lidhur me çështjen e ofrimit të ndihmës humanitare për banorët e Slivovës;
- Bashkëpunimi me organizatat NVO (“Mercy Corps”, “DRC”) UNDP dhe UNHCR lidhur me çështjen e kthimit të familjeve të shpërngulura në rajonin e Slivovës.

Problemet e pazgjidhura në fshatin Slivove janë:

- Numri i madh i familjeve të shpërngulura;
- Shkatërrimi i një numri të madh të shtëpive;
- Gjendja e rëndë e një numri të madh të shtëpive;
- Problemi i komunikimit të banorëve me rrethin;
- Problem i mbrojtjes shëndetësore (transporti i të sëmurve);
- Papunësia-sidomos e të rinjve;
- Mungesa e aktiviteteve për të rinjtë;
- Problemi i mungesës së hapësirës punuese për arsimim adekuat dhe mbrojtje shëndetësore.

## **Shërbimi për arsim dhe shëndetësi**

Në tremujorin e parë të vitit raportues, ka pasur aktivitete rreth furnizimit me lëndë ngrohëse për institucionet shkollore, ashtu që pas kërkesave të paraqitura nga ana e institucioneve shkollore në adresë të Zyrës së Komunitete në Graçanicë, Zyra e Komunitete kërkesat ia ka dërguar Komunës së Prishtinës dhe menjëherë ka filluar me distribuimin e lëndës për ngrohje, sipas kërkesave të paraqitura.

Në tremujorin e dytë të vitit raportues, shkolla fillore “Kralj Milutin” ka marrë ndihmë nga IOM-i për renovimin e shkollës.

Tremujori i ardhshëm ka kaluar me më pak aktivitete, duke pasur parasysh pushimet verore, përveç një kërkesës e cila është dërguar nga ana e prindërve që jetojnë në Prishtinë, ndërsa fëmijet e tyre e vijojnë mesimin në Lapla-Selë, që t’u sigurohet transporti nga Prishtina deri në Lapla-Sellë dhe anasjelltas.

Në muajin tetor është bërë hapja solemne e Qendrës Arsimore Rome, dhe më atë rast është bërë hapja publike e tenderit për ndarjen hapësirës në shfrytëzim ROC-ut , ku ka qënë vetëm një OJQ, me titullin “Balkanski Suncokret”.

Kur bëhet fjalë për Departamentin e Arsimit në Prishtinë dhe të gjitha institucionet shkollore, edhe më tej nuk ka bashkëpunim. Shpenzimet materiale për vitin 2007 u janë ofruar të gjitha shkollave, ndërkaq asnjë nga shkollat nuk kanë sjellë kërkesë për nevoja të shpenzimeve materiale.

Gjatë vitit ka ardhur deri të problemi rreth servisimit të minibusëve shkollore, me të cilët kemi pasur vështirësi, po ashtu ka ndodhur edhe me regjistrimin e tyre.

## **Kulturë**

Aktivitetet në fushën e kulturës kanë qënë të llojllojshme, pjesa e madhe e manifestimeve është organizuar në bashkëpunim me Shtëpinë e Kulturës në Graçanicë.

Gjithashtu, janë organizuar dhe sponsoruar nga ana e Zyrës shumë aktivitete sportive, turnir në ping-pong, në futboll të vogël, shah-turnir memorial, si dhe aktivitete tjera sportive.

Është hapur qendra me emrin “Dëgjoj të Rinjtë “ (“Slusaj Mlade”), për zgjidhjen e problemeve të të rinjve, projektin e realizuan Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, së bashku me Mjekët Francez Botëror dhe organizatën “Vita” nga Kosova.

Me sukses është organizuar turniri i Bashkësisë Rome, me rastin e Ditës Botërore Rome -8 Prilli, në Graçanicë dhe Lapla-Sellë, ku kanë marrë pjesë nga dhjetë ekipe.

Me rastin e festës së Pashkëve, është organizuar turniri në futboll të vogël në Badocin e Ri ku kanë marrë pjesë 23 ekipe, në mesin e tyre edhe ekipet e KFOR-it dhe të serbëve të Gorazhdecit.

Është kryer procedura rreth pagesës së qirasë së organizatave turke: Shoqata e grave “Hanimeli” dhe Shoqata e Arsimitarëve Turq, për vitin 2007, sepse ka qënë një nga prioritetet e komunitetit.

Eshtë bërë realizimi i kërkesës për blerjen e gardierobës dhe këpucëve për fëmijet e retarduar “Decja Kuca” në Graçanicë.

Me ftesë të organizatorit të manifestimit kulturor – shpirtëror në Kostollc, me emrin “Kostolacka Ziska” kemi marrë pjesë me ekspozitën e fotografive “Poet dhe Këng Popullore”.

Me ftesë të drejtorit të Departamentit të Sportit për të gjithë nëpunësit e Kosovës, kanë marrë pjesë në prezantim, i cili ka pasur tri pika:

- Investimet kapitale për infrastrukture sportive në vitin 2008;
- Menaxhimi me objekte dhe palestra sportive;
- Dhuna në sport.

Me rastin e Vidovdanit në Graçanicë është organizuar turnir në ping-pong dhe basket dhe projekti është lejuar nga ana e ministrit të Kulturës, Sportit dhe Rinisë.

Më 27.7.2007, solemnisht është hapur “Kampi i Madh Arkeologjik Multietnik”, në lokalitetin arkeologjik në Ulpianë. Në mesin e të ftuarve ishin: politikanë, përfaqësues të KFOR-it, të OSCE-së dhe përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të Kosovës.

Janë organizuar aktivitete me rastin e Muajit të Rinisë, si turniri në basketboll dhe ping-pong në Graçanicë dhe Tribuna rinore në Graçanicë.

Ka filluar realizimi i projektit “Rrethimi i fushës së futbollit në Graçanicë”. Me procesverbal është dorëzuar në shfrytëzim objekti i posandërtuar, Qendra Rome në Graçanicë, organizatave: NVO “Balkanski Suncokret” në bashkëpunim me NVO “Gratë Rome në Shekullin e Ri”.

Me organizim të NVO “Link Produkcija”, është mbajtur mbrëmje dokumentare në lokalet e radios “KIM” në Graçanicë, me prezantimin e disa filmave dokumentarë është paraqitur organizata “Digital Stil” nga Zrenjanini.

Eshtë bërë hapja solemne e objektit Qendra Rome në Graçanicë. Në solemnitet ishin të pranishëm një numër i madh i të ftuarëve, si: zëv.kryetari i Komunës së Prishtinës, përfaqësuesit e KFOR-it, të OSCE-së, të UNMIK-ut, të US Ofisa, të “Balkanski Suncokret” dhe të ZKK-së në Graçanicë.

Pjesëmarrja në manifestime të ndryshme të organizuara nga ana e institucioneve dhe organizatave tjera dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## **PASQYRA E REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2007**

Në bazë të projektpropozimit të buxhetit të paraqitur për vitin 2007, këshilltarët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, bazuar në projektprogramet e drejtorive, kanë miratuar Planifikimin e buxhetit me ndryshime dhe plotësime për vitin 2007, për:

- **Administrata e Përgjithshme;**
- **Arsim;**
- **Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;**
- **Brigadën e Zjarrfikësve;**
- **Zyrën lokale të Komuniteteve-Graçanicë dhe**
- **Zyrën për Kthim të Komuniteteve.**

Përmesë këtij raporti prezentohet realizimi i buxhetit të planifikuar për vitin 2007, për drejtoritë e lartcekura. I tërë materiali shtjellohet nga të dhënat e paraqitura në tabelë (shtojcë), si nga fondi i shfrytëzimit të grantit qendror, ashtu edhe nga të hyrat vetnake.

Përkundër vështirësive objektive, realizimi i buxhetit është përmbushur deri në 69% e mjeteve të realizuara nga granti dhe të hyrat vetnake. Gjithashtu, në kuadër të këtij realizimi të buxhetit, pjesa e mbetur – suficit, bartet në vitin 2008, mjete këto nga të hyrat vetnake. Në kontinuitet të kësaj, realizimi i buxhetit do të shpjegohet me analiza, sipas kategorive ekonomike.

## **ANALIZA EKONOMIKE E REALIZIMIT TË BUXHETIT**

Shprehur sipas kategorive ekonomike:

- 1. Paga dhe mëditje;**
- 2. Mallra dhe shërbime;**
- 3. Shpenzime komunale;**
- 4. Shpenzime kapitale dhe**
- 5. Subvencione dhe transfere.**

❖ **Paga dhe Mëditje** - Nga shuma e planifikimit, në këtë kategori ekonomike janë shpenzuar mbi 93%. Në këtë përqindje nuk përfshihen punonjësit e Arsimit, të Shëndetësisë, të Brigades së Zjarrfikësve, të Mbrojtjes Civile, të ZLK-së dhe ZKK-së.

❖ **Mallra dhe Shërbime** - Kjo kategori ekonomike përfshin shpenzimet materiale, pajimet, auto parkun, shërbimet e përgjithshme dhe shërbimet publike për mirëmbajtje. Duke pasur parasysh se kjo fushë është mbështetur nga granti po thuajse tërësisht, shpenzimi është tejkaluar rreth 3% e shumës së planifikuar.

❖ **Shpenzimet Komunale** - Është një fushë e rëndësishme, tek e cila çmimi i kostos është variabil, në rritje çdo ditë. Këto shpenzime të shërbimeve komunale, janë të lidhura ngushtë me ecurinë e zhvillimit të infrastrukturës lokale, prandaj janë kushtuese. Hargjimi në këto shërbime pothuajse është ekuivalent planifikimi me shpenzimin, ku është tejkaluar për 1%.

❖ **Shpenzimet Kapitale** - Është një ndër kategorit ekonomike më relevante, ku peshën më të madhe të buxhetit e ka pikërisht kjo fushë e investimeve kapitale me projekte të ndryshme. Mjetet, para të planifikuara në këtë kategori ekonomike, pothuajse tërësisht mbulohen nga të hyrat vetnake, ndërsa shuma tjetër nga granti qendror dhe granti stimulues i tatimit në pronë. Sipas përqindjes së realizuar 62%, këtu nuk janë përfshirë projektet nga Brigade e Zjarrfikësve, Mbrojtja Civile, ZLK dhe ZKK, sepse këto programe janë të paraqitura në tabelë bashkë me kategorin e pagave. Si të tilla mbledhen në shumën e përgjithshme.

Projektet e realizuar nga programet e drejtorive kapin shumën mbi 74%, ku përqendrimi më i madh është tek programi Shërbime publike -Infrastrukturë, me përmbushje të realizimit të projekteve mbi 55%. Gjithashtu, investimet tjera rradhiten në fushën e

Kulturës mbi 65%, të Rinisë dhe Sportit 56%, të Inspektionit mbi 39%, të Urbanizëm mbi 38%, të Administratës së Përgjithshme, Ekonomisë dhe Arsimit prej 15-20% . Tejkallim të shpenzimeve në realizim të projekteve kapitale kemi te projekti i tatimit në pronë, mbi >73% . Ky cikël i rritjes mbi, është i mbështetur nga granti stimulues i tatimit në pronë (GSTP) dhe mjetet e bartura. Investim tjetër që duhet theksuar është realizuar në fushën e agrokulturës, me projekte mikse nga sfera e zhvillimit rural, të tejkaluara mbi >16%.

Në vijim të kësaj që duhet potencuar është mosrealizimi i projekteve nga lëmi i Shëndetësisë, të cilat për shkaqe objektive kanë mbetur pa u realizuar dhe pjesa dërmuese barten për vitin vijues.

Mbrojtja Civile dhe Brigada e Zjarrfikësve, nga projektet e planifikuara, kanë realizuar tri projekte me qëllime kapitale për shërbimet e tyre gjegjëse.

Zyra e Komuniteteve – Graçanicë në programin e saj, bashkërisht me paga ka realizuar projektbuxhetin mbi 80% .

❖ **Subvencione dhe transfere** – Kjo kategori është e domosdoshme për përkrahjen e manifestimve kulturore, sportive, edukative, shëndetësore, sociale etj. Prandaj, mjetet e tërësishme të planifikuara nga të hyrat vetanake, mbështeten pikërisht për politikat e lartcekura.

## **L I T E R A T U R A**

**Raportet vjetore të prezantuara nga drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësi i Zyrës së Komunitete;**

**Ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së 4-të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 21.6.2007;**

**Raporti i Bordit të drejtoreve për vitin 2006, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, më 21.6.2007;**

**Rregujllorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë;**

**Statuti i Komunes së Prishtinës i dt. 16.3.2001;**

**Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në organet e administrates;**

**Rregujllorja e UNMIK-ut nr. 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave në Kosovë;**

**Rregulloret, urdhëresat, udhëzimet që kanë të bëjnë me pushtetin lokal .**